



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 216 Akti

Nr. 361 Vendimi
Tiranë, më 25.3.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)
Firdes Shuli
Suela Zhegu

Kryesuese
Relatore
Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Orianda Liçi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datat 23.3.2021, ora 10:00 dhe më 25.3.2021, ora 09:15, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Bari Shyti**, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Bari Shyti, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Bari Shyti është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).
2. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 15.11.2018, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit, z. Bari Shyti, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Alma Faskaj dhe Suela Zhegu. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Alma Faskaj.
3. Për këtë subjekt rivlerësimi u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.
4. Me shkresën nr. *** prot., datë 4.5.2018, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 8.6.2018, ILDKPKI-ja ka vënë në dispozicion aktin përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Bari Shyti.
5. Me shkresën nr. *** prot., datë 29.1.2019, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 29.1.2019, DSIK-ja vuri në dispozicion raportin mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, z. Bari Shyti, i deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së. Me shkresën nr. *** prot., datë 11.2.2019, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 11.2.2019, DSIK-ja vuri në dispozicion raportin nr. *** prot., datë 10.1.2019, i deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 7.2.2019, të KDZH-së.
6. Me shkresën nr. *** prot., datë 25.6.2019, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 28.6.2019, KLGJ-ja ka vënë në dispozicion raportin e analizimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Bari Shyti.
7. Me vendimin nr. 1, datë 21.11.2018, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Bari Shyti, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Genta Tafa (Bungo). Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
8. Në datën 9.1.2019 subjektit iu komunikua përmes postës elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije edhe e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti nuk është shprehur mbi gjendjen e konfliktit të interesit me ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues.
9. Me vendimin nr. 24, datë 10.4.2020, Komisioni vendosi që komisionerja Alma Faskaj, për shkaqe shëndetësore, të cilat nuk mundësonin vijimin e procedurave të rivlerësimit të subjektit, të zëvendësohet nga komisionerja Firdes Shuli.
10. Në datën 29.4.2020 subjektit iu komunikua përmes postës elektronike zëvendësimi i komisioneres Alma Faskaj nga komisionerja Firdes Shuli. Subjekti deklaroi, në po këtë datë, mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarin e trupit gjykues.

- 11.** Me vendimin nr. 2, datë 8.9.2020, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Bari Shyti, bazuar vetëm në kriterin e rivlerësimit të pasurisë, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.
- 12.** Në datën 11.9.2020, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën, jo më vonë se data 28.9.2020; si dhe (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.
- 13.** Në datën 14.9.2020, përmes postës elektronike, subjekti i rivlerësimit informoi Komisionin se ishte në kushtet e karantinës për shkak të infektimit nga COVID-19, duke kërkuar shtyrje me 2-3 javë të afatit të paraqitjes së parashtrimeve.
- 14.** Në datën 17.9.2020, Komisioni, pas verifikimeve të kryera pranë ISHP-së, përmes postës elektronike i njoftoi subjektin të rivlerësimit shtyrjen e afatit të paraqitjes së parashtrimeve, deri në datën 1.10.2020.
- 15.** Në datën 21.9.2020, Komisioni, pas administrimit të raporteve mjekësore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, e njoftoi për shtyrjen e afatit të paraqitjes së parashtrimeve, deri në datën 12.10.2020.
- 16.** Në datën 13.10.2020 subjekti i rivlerësimit dërgoi në rrugë elektronike shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, si dhe provat shkresore të dërguara në rrugë postare, në po këtë datë.
- 17.** Në datën 19.10.2020, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar në rrugë elektronike riçeljen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera, duke informuar se ishte në pritje të disa provave shkresore në lidhje me personin e lidhur, vëllain I. Sh., të cilat, për shkak të situatës së pandemisë, nuk ka mundur t'i siguronte brenda afatit të caktuar.
- 18.** Me vendimin nr. 3, datë 19.10.2020, pas analizimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vendosi riçeljen e hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e disa hetimeve shtesë për kriterin e pasurisë, si dhe përfshirjen e kriterit të kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit të aftësive profesionale në procesin e rivlerësimit të këtij subjekti.
- 19.** Në përfundim të hetimit, me vendimin nr. 4, datë 4.3.2021, trupi gjykues vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ shtesë për subjektin e rivlerësimit, z. Bari Shyti; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit; si dhe (iii) të informojë subjektin për t'u njohur me provat e administruara, të drejtat për të kërkuar marrjen e provave të reja etj., si dhe dorëzimin e prapësimeve deri më 16.3.2021.
- 20.** Në datat 16.3.2021 dhe 17.3.2021 subjekti dërgoi në rrugë elektronike parashtrimet e tij mbi rezultatet e hetimit administrativ shtesë, të cilat i ridërgoi edhe më 19.3.2021.
- 21.** Pas shqyrtimit të parashtrimeve të paraqitura nga subjekti, me vendimin nr. 5, datë 19.3.2021, trupi gjykues vendosi kalimin në seancë dëgjimore, duke e njoftuar subjektin me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 23.3.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.
- 22.** Në datën 23.3.2021 u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016 rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Bari Shyti, ka dorëzuar në ILDKPKI në datën 28.1.2017 deklaratën e pasurisë, pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit, z. Bari Shyti, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me nr. indeksi *** dhe ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private në vijim.

ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Bari Shyti, ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë dhe ka falsifikim dokumentacioni;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjekteve të rivlerësimit, referuar vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizoi një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi të kriterit pasuror për subjektin e rivlerësimit, z. Bari Shyti, i cili nuk është bazuar dhe as është detyruar nga përfundimet e paraqitura nga ILDKPKI-ja.

Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas pikës 1, të nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka hetuar të gjitha faktet dhe ka vlerësuar të gjitha rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, duke kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit, z. Bari Shyti, si dhe të personave të lidhur me të, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: (i) deklarinimet e subjektit në ILDKPKI; (ii) provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar në Komision; (iii) çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iv) komunikimet me subjektin, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarinimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarinimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin e deklarinimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Pasuri të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën Vetting

1. Apartament me sip. 57.64 m², nr. ***, shk. ***, k. ***, pallat 10-katësh, i ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k., ndodhur në Lagjen ***, ***, Durrës, me kontratë sipërmarrjeje, datë 9.8.2005 dhe kontratë shitjeje nr. ***, datë 2.4.2012. Çmimi: 2.862.000 lekë. Regjistruar në ZVRPP-në Durrës në datën 15.5.2012. Prenotuar në bashkëpronësi me vëllain I. Sh., duke paguar secili 50 % të çmimit. Aktualisht kjo pasuri është 100 % në pronësi të subjektit, për shkak të tërheqjes së bashkëpronarit I. Sh. në kohën kur po bëhej kontrata e shitjes me shoqërinë ndërtuese (viti 2012), duke marrë përsipër detyrimin e kthimit të të gjithë shumës së parapaguar nga bashkëpronari, sipas deklaratës noteriale datë 13.7.2012.

Si burim krijimi në kohën e prenotimit për pjesën takuese prej 50 % të subjektit, janë deklaruar:

- a. kursime nga pagat e tij dhe të bashkëshortes për periudhën 2003 – 2006;
- b. letër me vlerë e përfituar nga bashkëshortja si trashëgimtare e ish të dënuarit politik B. D. (babai i saj) në vlerën 650.000 lekë, shitur shoqërisë sipërmarrëse “****” sh.p.k., në vlerën 600.000 lekë, konvertuar dhe llogaritur në vlerën e kësaj pasurie;
- c. pjesa tjetër prej 50 % e çmimit të paguar nga z. I. Sh. – paratë janë dërguar dorazi nga Belgjika ku jeton prej vitit 1999.

Konstatime të ILDKPKI-së për këtë pasuri

a. Fshehje në deklaratën e interesave private të vitit 2005 të pagesës së kryer për apartamentin në Lagjen ***, ***, Durrës, sipas kontratës së sipërmarrjes datë 9.8.2005, lidhur ndërmjet subjektit Bari Shyti dhe shoqërisë “****” sh.p.k., në shumën 2.862.000 lekë.

b. Mungesë burimi të ligjshëm financiar në vitin 2005 të shumës 2.262.000 lekë, si konvertim i letrave me vlerë 650.000 lekë të nënës së bashkëshortes.

c. Deklarim i rremë në deklaratën e interesave private të vitit 2007, lidhur me deklarin e pagesës prej 1.400.000 lekësh në apartamentin në Lagjen ***, ***, Durrës, pasi sipas shoqërisë “****” sh.p.k., pagesa totale është bërë që në vitin 2005.

ç. Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për marrjen e shumave 11.500 euro dhe 18.500 euro, përkatësisht në vitet 2005 dhe 2010, nga vëllai I. Sh., banues në Belgjikë (deklaruar se janë sjellë dorazi). Pagesat e kthimit të shumave pjesore të vëllait janë bërë nëpërmjet bankës. Gjithsesi, mbetet e padokumentuar përfshirja e tij në blerjen e apartamentit në Lagjen ***, ***, Durrës.

Hetimi i Komisionit për këtë pasuri

1.1. Në lidhje me statusin aktual të kësaj pasurie, gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se:

1.1.1. ZVRPP-ja Durrës¹ konfirmoi të regjistruar në emër të subjektit Bari Shyti pasurinë apartament me sip. 57.64 m², nr. ***, Durrës. Sipas kartelës së pasurisë në datën 9.10.2012 u rivlerësua pasuria në shumën 4.296.496 lekë.

1.1.2. OSHEE-ja² nuk konfirmoi kontratë furnizimi me energji elektrike në emër të subjektit Bari Shyti, por në emër të shtetasit E. Sh. (i biri), me kontratën nr. ***, në Durrës. Subjektit i është kërkuar të japë sqarime bazuar në dokumentet shkresore lidhur me këtë kontratë. Në e-mail-in e dërguar në datën 13.10.2020, subjekti ka bërë me dije se kjo kontratë nuk i përket

¹ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 4.2.2019, nga ZVRPP-ja Durrës në dosjen e Komisionit.

² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 5.2.2019, nga OSHEE-ja, në dosjen e Komisionit.

djalit të tij E. Sh., duke vënë në dispozicion një dokument mbi detajet e pagesës së konsumatorit, që i përket një kontrate tjetër, asaj me nr. ***, në instancën Durrës, kabina “****” në emër të konsumatorit Bari Shyti, që është apartamenti objekt shqyrtimi. Siç vërehet, subjekti nuk ka vërtetuar që kontrata nr. ***, në Durrës, nuk i përket djalit të tij E. Sh.. Por, pavarësisht kësaj, Komisioni nuk mund të arrijë në përfundimin që kjo kontratë i përket një pasurie në emër të shtetasit E. Sh., referuar fakteve si vijojnë: (i) ZVRPP-ja Durrës nuk ka konfirmuar ndonjë pasuri të regjistruar në pronësi të shtetasit E. B. Sh.; (ii) nga verifikimi në sistemin e Gjendjes Civile të vitit 2014, me gjeneralitetet E. Sh. rezultojnë 6 shtetas, çka nuk përjashton mundësinë që kontrata e konfirmuar nga OSHEE-ja në emër të shtetasit E. Sh. t’i përkasë ndonjërit prej tyre. Ndërkohë, nga hetimi administrativ nuk rezultuan të dhëna nga çfarëdolloj burimi për pasuri në emër të djalit të subjektit të rivlerësimit.

1.2. Në lidhje me mënyrën e krijimit dhe likuidimin e çmimit të shitjes së kësaj pasurie, nga aktet³ në dosje rezulton se në rend kronologjik janë kryer veprimet, si vijojnë:

1.2.1. Me kontratën e sipërmarrjes, datë 9.8.2005, z. Bari Shyti ka porositur në shoqërinë sipërmarrëse “****” sh.p.k. apartament me sip. 63.82 m², me vlerë 2.862.000 lekë, në të cilën është parashikuar se likuidimi i kësaj shume do të bëhet pranë arkës së kësaj shoqërie me lidhjen e kontratës. Me kërkesë të Komisionit, shoqëria ndërtuese vuri në dispozicion dokumentet si vijojnë:

- mandatarkëtimin nr. ***, datë 9.8.2005, sipas të cilit vërtetohet se z. Bari Shyti ka paguar në datën 9.8.2005, shumën 2.862.000 lekë;

- aktдорëzimin datë 9.8.2005, për apartamentin nr. ***, me sip. 63.81m², sek ***, kati ***, nr. ***, me strukturë 1+1, sipas të cilit vërtetohet se në këtë datë z. Bari Shyti ka marrë në dorëzim apartamentin.

1.2.2. Sipas vërtetimit nga dokumentet hipotekore lëshuar nga ZVRPP-ja Durrës, në datën 16.6.2011, rezulton se pasuria nr. ***, me sip. 57.64 m², është e regjistruar në emër të shoqërisë “****” sh.p.k.

1.2.3. Me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 2.4.2012, z. Bari Shyti ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. apartament banimi me sip 57.64 m², me nr. pasurie ***, në çmimin 2.862.000 lekë, i paguar plotësisht jashtë zyrës noteriale, sipas mandatarkëtimin nr. ***, datë 9.8.2005.

1.2.4. Në datën 15.5.2012 pasuria është regjistruar në emër të subjektit në ZVRPP-në Durrës⁴.

1.2.5. Në datën 13. 7.2012 është redaktuar deklarata noteriale nr. ****⁵, nënshkruar prej subjektit dhe vëllait të tij I. Sh., në të cilën:

a. Deklaruesi I. Sh. ka deklaruar: “... në vitin 2005 kam rënë dakord me vëllain tim Bari Shyti që të blinim bashkërisht një apartament banimi në lagjen ***, Durrës, me qëllim përdorimin e saj për pushimet verore. Meqenëse unë isha emigrant në Belgjikë dhe e kisha të pamundur të vija në Shqipëri për shkak të mungesës së dokumenteve, kam porositur vëllain tim Bariun, që të bënte porosinë e apartamentit dhe unë t’i dërgoja gjysmën e çmimit. Në gusht të vitit 2005 jam njoftuar nga Bariu se ka prenotuar një apartament në Lagjen ***, Durrës, me çmim total 2.800.000 lekë të reja. Sipas kërkesës së tij i kam dërguar 11.500 euro për të paguar gjysmën e çmimit. Në vitin 2010 njoftohem nga vëllai se kërkon të shesë pjesën e tij të apartamentit, pasi kishte prenotuar një apartament tjetër në Tiranë. Pasi ramë dakord për çmimin pranova të blej pjesën e tij kundrejt vlerës 18.500 euro. Kjo rritje e çmimit nga 11.500 sipas shitësit

³ Shihni aktet në Aneksin ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴ Sipas kartelës së pasurisë bashkëlidhur shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 23.10.2017, nga ZVRPP-ja Durrës, në dosjen e Komisionit, pasuria është regjistruar në emër të subjektit në maj të vitit 2012.

⁵ Shihni shkresën kthim përgjigje protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 7.6.2019, nga noteri I. K., në dosjen e Komisionit.

Bari Shyti ka ardhur si pasojë e rritjes së vlerës së tregut të banesave. Në vitin 2010 i kam dërguar dorazi shumë prej 18.500 euro dhe apartamenti do të ishte totalisht pasuri e imja. Në mars të vitit 2012 kam ardhur në Shqipëri dhe kam parë apartamentin, pasi duhej të bëja regjistrimin e tij në emrin tim pranë ZVRPP-së Durrës, kam konstatuar se apartamenti nuk i plotësonte kërkesat e mia. Për këtë arsye bisedova me vëllain Bari Shyti dhe i kërkova që të më kthente shumë e lekëve që i kam dhënë dhe unë të heq dorë nga kjo pasuri”.

b. Deklaruesi Bari Shyti, subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar: “... në vitin 2005 kam prenotuar apartamentin kundrejt çmimit 2.800.000 lekë të reja, ku kam paguar në dorë gjysmën e çmimit prej 1.400.000 lekësh. Gjysmën tjetër prej 1.400.400 lekësh i kam paguar në vitin 2007. Kontratën e porosisë e kam bërë në emrin tim, pasi vëllai I. Sh. ndodhej jashtë shtetit dhe nuk kishte mundësi të vinte. Në vitin 2007 është paguar totalisht çmimi i apartamentit, ku gjysmën e lekëve 1.400.000 lekë e ka paguar vëllai I. Sh. dhe gjysmën tjetër e kam paguar unë. Në vitin 2010 kam prenotuar një apartament banimi në Tiranë dhe për këtë shkak kërkova nga vëllai I. të blinte pjesën time të apartamentit kundrejt vlerës 18.500 euro. Kjo bisedë është zhvilluar në telefon, ku kemi rënë dakord dhe në mars-prill të vitit 2010 kam marrë nga I. Sh. shumë prej 18.500 euro. Në vitin 2012 vëllai I. Sh. ka ardhur në Shqipëri dhe pasi ka parë apartamentin nuk ka pranuar të marrë çelësat e tij dhe të bëjë regjistrimin në emër të tij. Për sa më sipër, jam dakord që vëllai I. Sh. të heqë dorë nga pasuria apartament banimi me sip. 64 m², i cili ndodhet në Lagjen ***, Durrës dhe me heqjen dorë të tij unë marr përsipër t’i kthej shumë e paguar prej 30.000 euro. Marr përsipër detyrimin që këtë shumë t’ia kthej shtetasit I. Sh. me këste, duke i paguar në datën 31.12.2013 shumë prej 10.000 euro, në datën 31.12.2014 shumë prej 10 000 euro, dhe në datën 31.12.2015 shumë prej 10.000 euro. Pas datës 31.12.2015, nëse shuma prej 30.000 euro nuk i paguhet totalisht ose pjesërisht shtetasit I. Sh., pjesa e mbetur pa paguar do të rëndohet me interes 1.5 % për çdo muaj vonesë”.

c. Nga verifikimi i sistemit TIMS u konstatua që në datën e redaktimit të kontratës 13.7.2012, deklaruesi I. Sh. nuk ka qenë në Shqipëri, pasi ka dalë nga territori shqiptar në datën 16.3.2012 dhe ka hyrë në Shqipëri në datën 30.7.2012, fakt që e bën të dyshimtë redaktimin e aktit noterial në këtë datë.

1.2.6. Gjatë procesit të rivlerësimit subjektit iu kërkua të shpjegojë marrëdhënien me vëllain I. Sh. në lidhje me këtë pasuri, mënyrën e kalimit të shumave monetare bazuar në dokumentet provuese, dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2, në mënyrë të përmbledhur, subjekti ka konfirmuar përgjithësisht atë çka është paraqitur në deklaratën noteriale të sipërpërmendur, duke deklaruar se: “... në fillim të vitit 2005, për shkak të rrethanave të favorshme që ishin krijuar, në pamundësi për të paguar të gjithë çmimin e apartamentit të ofruar, kishte rënë dakord me vëllain për ta paguar përgjysmë atë; ka marrë shumë 11.500 euro në gjendje cash tek nëna e tij, e cila mbledhte kursimet e vëllait nga Belgjika; për pjesën e tij u ra dakord me pronarin që të llogaritej shuma prej 600.000 lekësh e letrës me vlerë; në gusht të vitit 2005 kur është lidhur kontrata e sipërmarrjes dhe u mor në dorëzim apartamenti është paguar vlera 2.000.000 lekë; diferenca e mbetur prej 880.000 lekësh është paguar brenda vitit 2007; në vitin 2010, për shkak të rezervimit të një apartamenti në Tiranë i kishte kërkuar vëllait që apartamenti në bashkëpronësi t’i mbetej atij dhe ai (vëllai) t’i paguante gjysmën e vlerës; ka marrë nga nëna e tij shumë prej 18.500 euro (diferenca mes shumës prej 11.500 euro të paguar në vitin 2005 dhe çmimit aktual të apartamentit); në vitin 2010, kur vëllai erdhi në Shqipëri, fillimisht ra dakord që kontrata e shitjes të lidhej në emër të tij, por duke qenë se firma nuk kishte kryer veprimet e regjistrimit në ZVRPP, nuk mund të regjistrohej në emër të I. Sh.; në vitin 2011, kur u kthye përsëri në Shqipëri, ngriti pretendimin se apartamenti nuk ishte i përshtatshëm; për shkak të marrëdhënieve vëllazërore u pranua që pronësia mbi apartamentin t’i kalonte e gjitha Bari Shytit; shuma totale e paguar prej 30.000 euro (11.500 euro në vitin 2005 dhe 18.500 euro në vitin 2010) është dërguar nga vëllai dorazi, të cilat grumbulloheshin nga nëna; borxhi

prej 30.000 euro është paguar pothuaj plotësisht me një mbetje të papaguar prej 1.800 euro, ku përveç pagesave cash në dorë, i është paguar nëpërmjet bankës shuma prej 3.000.000 lekësh, e ardhur nga shitja e apartamentit në Bulqizë në vitin 2014”.

1.3. Nga verifikimi i deklarimeve periodike vjetore u konstatua se:

1.3.1. Në DPV-të e viteve 2005 dhe 2006 subjekti nuk ka kryer asnjë deklaram në lidhje me këtë pasuri dhe të drejtat reale mbi të dhe as likuidimin e çmimit të shitjes apo një pjese të tij, ndërkohë që me lidhjen e kontratës së sipërmarrjes datë 9.8.2005, konfirmohet pagimi total i çmimit të blerjes në këtë datë, si dhe marrja në dorëzim e pasurisë, fakt që pranohet nga subjekti, i cili edhe në procesin e rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ndër të tjera, ka deklaruar se *në gusht të vitit 2005 u mor në dorëzim apartamenti.*

1.3.2. Në DPV-në e vitit 2007 është deklaruar vetëm 1/2 e pasurisë, si vijon: *“Me kursimet e deklaruara më parë dhe ato të vitit të deklaramit prej 300.000 lekësh është blerë ‘sipërfaqe banimi prej 32 m²’. Vendndodhja: Lagja nr. ***, ***, Durrës, e peregjistruar. Vlera: 1.400.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %”.* Ndërkohë, pasuria ishte porositur e paguar që në vitin 2005 nga subjekti i rivlerësimit, çka passjell detyrimin e tij ligjor për të deklaruar të gjithë pasurinë, sikurse edhe pjesën tjetër të çmimit të shitjes prej 11.500 euro, të pretenduar si të dhënë nga vëllai I. Sh..

1.3.3. Në DPV-në e vitit 2008, në rubrikën “të dhëna konfidenciale”, është deklaruar: *“Kontratë provizore me ‘***’ sh.p.k., për blerje shtëpie pushimi në L. ***, ***, Durrës, me sip. 32 m², (1/2 e 64 m²), shtator 2005”.* Në po këtë rubrikë, në pjesën e personave që rezultojnë të lidhur me zyrtarin deklarues, është deklaruar lidhja me vëllain I. Sh. dhe lloji i interesit privat “bashkëpronësi në banesën shtëpi pushimi me sip. 64 m², plazh”.

1.3.4. Në DPV-në e vitit 2009, në rubrikën “të dhëna konfidenciale”, është deklaruar: *“Kontratë provizore me ‘***’ sh.p.k., për blerje apartament 1+1, në plazh, Durrës (në bashkëpronësi me vëllain), shtator 2005”.* Në po këtë rubrikë të këtij deklarimi, në pjesën e personave që rezultojnë të lidhur me zyrtarin deklarues është deklaruar lidhja me vëllain I. Sh. dhe lloji i interesit privat “bashkëpronësi në apartamentin me sip. 64 m², ***, Durrës”.

1.3.5. Në DPV-në e vitit 2010 është deklaruar: *“Shitur pjesa 50 % e apartamentit në Lagjen ***, ***, Durrës. Pjesën e ka blerë vëllai I. Sh., i cili dispononte pjesën tjetër prej 50 %, me sip. 32 m², në vlerën 18.500 euro”.* Ky deklarim nuk vërtetohet me dokument shkresor.

1.3.6. Në DPV-në e vitit 2011 është deklaruar: *“Shitur pjesa 50 % e apartamentit në Lagjen ***, ***, Durrës. Pjesën e ka blerë vëllai I. Sh., i cili dispononte pjesën tjetër prej 50 % = 32 m². Vlera: 18.500 euro. Pjesa takuese: 50 %”.*

1.3.7. Në DPV-në e vitit 2012 është deklaruar: *“Apartament 1+1, vendndodhja: Lagja ***, ***, Durrës. Kjo pasuri është krijuar në vitin 2005 si pronë e përbashkët ndërmjet meje dhe shtetasit I. Sh., vëllait. Pasuria është regjistruar në ZVRPP-në Durrës në emrin tim në vitin 2012. Vlera: 2.872.000 lekë”.* Në rubrikën e detyrimeve të këtij deklarimi është deklaruar: *“Detyrim financiar i lindur në vitin 2012 ndërmjet meje dhe vëllait I. Sh. për shkak të marrjes përsipër nga ana ime të vlerës së apartamentit 1+1 në Lagjen ***, ***, të paguar më parë nga I. Afati i shlyerjes për tre vjet me këste vjetore nga 10.000 euro për çdo vit, në vlerën 27.500 euro”.* Subjekti është i paqartë në deklarim, pasi nga njëra anë deklaronte detyrimin prej tre këstesh me nga 10.000 euro, pra, shumën 30.000 euro, dhe nga ana tjetër deklaronte se detyrimi është në shumën 27.500 euro.

1.3.8. Në DPV-në e vitit 2013, në rubrikën e detyrimeve, është deklaruar: *“Detyrim financiar ndërmjet meje dhe vëllait I. Sh. i deklaruar më parë. Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm është 3.500 euro dhe gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer është 24.000 euro”.*

1.3.9. Në DPV-në e vitit 2014, në rubrikën “detyrime”, është deklaruar: “Detyrim financiar ndaj vëllait I. Sh., mbetur pa shlyer nga viti 2013, ku detyrimi ka qenë 30.000 (tridhjetë mijë) euro. Ky detyrim e ka origjinën nga marrëdhënia e bashkëpronësisë në apartamentin me sip. 64 m², në Lagjen ***, ***, Durrës. Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm është 3.000.000 (tre milionë) lekë = 21.500 (njëzet e një mijë e pesëqind) euro, gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer është 2.500 (dy mijë e pesëqind) euro”.

Siç vërehet në këtë deklaratë, shuma e detyrimit është deklaruar 30.000 euro. Nga të dhënat bankare është vërtetuar se në favor të vëllait të subjektit, z. I. Sh., gjatë vitit 2014 ka kaluar shuma 3.500.000 lekë, e kryer nëpërmjet sistemit bankar përmes tri transfertave, nga llogaria rrjedhëse e subjektit në “Raiffeisen Bank”⁶, si vijojnë: (i) transfertë e kryer në datën 13.8.2014, në shumën 500.000 lekë, me përshkrim “kthim borxhi Bari Shyti në emër të z. I. D. Sh. (përfituesi)”; (ii) transfertë e kryer më 31.10.2014, në shumën 2.500.000 lekë, me përshkrim “likuidim borxhi”; (iii) transfertë e kryer në datën 29.12.2014, në shumën 500.000 lekë, me përshkrim “shlyerje borxhi”.

Edhe pse është e paqartë përse subjekti i ka kaluar vëllait I. Sh. shumën prej 3.500.000 lekësh, ndërkohë që detyrimi i shlyer ka qenë në shumën 3.000.000 lekë, në analizën financiare të vitit 2014 shuma prej 500.000 lekësh është konsideruar si shpenzim. Në DPV-në e vitit 2014 subjekti ka deklaruar se ka përdorur të ardhurat e përfituara nga shitja e banesës në Bulqizë në vitin 2014, në shumën 3.650.000 lekë, të ardhura të cilat, në përfundim të hetimit administrativ, janë konsideruar të ligjshme, pasi është vërtetuar pagesa e tatimit mbi të ardhurat nga shitja e këtij apartamenti dhe shpenzimet e rivlerësimit në shumën 94.236 lekë⁷, dhe si të tilla, janë përfshirë në analizën financiare për këtë vit, pasqyruar në tabelën në vijim, ku duket se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për të shlyer shumën prej 3.000.000 lekësh në DPV-në e vitit 2014 ndaj vëllait I. Sh..

Përshkrimi	2014
Pasuri	-588 591
<i>Shtesa/pakësime likuiditete cash dhe bankë</i>	-588 591
Total likuiditete	241 714
Detyrime	-3 750 000
Shlyer detyrim financiar për huan 9,000 USD	-550 000
Shlyer detyrimi për huan 5,000 euro, marrë shtetasit P. B.	-200 000
Shlyer detyrim financiar për huan 30,000 euro vëllait I. Sh.	-3 000 000
PASURI NETO	2 511 409
Të ardhura të dokumentuara	5 048 750
Të ardhura nga punësimi i subjektit	1 235 510
Të ardhura nga punësimi i bashkëshortes	105 974
Të ardhura nga interesat bankare	57 266
Të ardhura nga shitja e apartamentit në Bulqizë në tetor 2014	3 650 000
Shpenzime	1 918 457
Shpenzime jetese për 5 persona ⁸	1 029 990
Shpenzime për rivlerësimin e apartamentit në Bulqizë	94 236
Shpenzime udhëtimi	294 231
Pagesë e kryer ndaj vëllait I. Sh. (sipas “Raiffeisen Bank”)	500 000

⁶ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 1.2.2019, nga “Raiffeisen Bank”, në dosjen e Komisionit.

⁷ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 1.9.2020, nga ASHK Bulqizë, në dosjen e Komisionit.

⁸ Shpenzimet e jetesës janë reduktuar në vlerën 70.000 lekë krahasuar me analizën që i ishte vënë subjektit në dispozicion, për shkak të marrjes në konsideratë të pretendimeve të subjektit për të ardhurat nga toka bujqësore, deklaruar në DPV-në e vitit 2014 (trajtuar hollësisht në vijim, te rubrikat “konstatime të tjera” dhe “analiza financiare”).

1.3.10. Në DPV-në e vitit 2015, në rubrikën “detyrime”, është deklaruar: “*Detyrim financiar ndaj vëllait I. Sh., mbetur pa shlyer nga viti 2013. Ky detyrim ka lindur nga deklarata noteriale e vitit 2012, ku detyrimi ka qenë 30.000 (tridhjetë mijë) euro. Ky detyrim e ka origjinën nga marrëdhënia e pronësisë në apartamentin me sip. 64 m², në Lagjen ***, ***, Durrës. Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm është 700 euro (paguar cash), gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer është 1.800 euro*”.

1.3.11. Në DPV-në e vitit 2016 subjekti nuk ka kryer asnjë deklaram në lidhje me detyrimin financiar ndaj të vëllait I. Sh..

1.3.12. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar detyrimin financiar në shumën 1.800 euro.

1.3.13. Analizë ligjore e të gjitha fakteve dhe rrethanave të rezultuara nga deklaramet e subjektit

Bazuar në të gjitha provat e administruara si më sipër, u konstatua se pavarësisht se subjekti ka qenë *de jure* blerës dhe pronar i vetëm i pasurisë, referuar deklarameve periodike të subjektit, *de facto* pasuria duket të jetë paguar prej të dy vëllezërve, ashtu sikurse subjekti ka pretenduar edhe gjatë procesit të rivlerësimit dhe ka deklaruar edhe në deklaratën *Vetting*. Konkretisht, pasuria është porositur nga subjekti në vitin 2005, vit në të cilin personi i lidhur I. Sh. i ka dhënë dorazi subjektit të rivlerësimit shumën 11.500 euro, për të paguar 1/2 e pjesës së tij takuese. Në DPV-në e vitit 2007 subjekti ka deklaruar pjesën e tij takuese në pasuri me vlerë 1.400.000 lekë, ndërsa në DPV-në e viteve 2008 dhe 2009 ka deklaruar bashkëpronësinë mbi këtë apartament banimi me të vëllanë I. Sh.. Me tej, ashtu sikurse deklarohet në DPV-në e vitit 2010, gjatë këtij viti vëllezërit kanë rënë dakord që z. I. Sh. të blejë pjesën e subjektit Bari Shyti në vlerën 18.500 euro, shumë e cila është dhënë dorazi në muajt mars - prill të vitit 2010. Dhe më tej, ashtu sikurse deklarohet në DPV-në e vitit 2012, vërtetohet se gjatë këtij viti, me marrëveshje të përbashkët, vëllezërit kanë vendosur që pasuria t’i mbetet subjektit, kundrejt detyrimit të këtij të fundit për t’i paguar të vëllait I. Sh. shumën 30.000 euro. Ndërsa, në DPV-në e vitit 2014 subjekti ka deklaruar se ky detyrim është për shkak të marrëdhënies së bashkëpronësisë me vëllain e tij në apartamentin me sip. 64 m², në Lagjen ***, ***, Durrës.

Për sa i takon detyrimit financiar të subjektit ndaj z. I. Sh., detyrim i lindur në vitin 2012 dhe i deklaruar në DPV-në e këtij viti, duke qenë se ka pasur disa paqartësi, me kalimin e barrës së provës në përfundim të hetimit administrativ, subjektit i janë kërkuar sqarime nëse detyrimi ka qenë në shumën 30.000 apo në 27.500 euro. Në parashtrimet e tij, subjekti ka pranuar se detyrimi ndaj vëllait I. Sh. është në shumën 30.000 euro dhe jo në 27.500 euro, dhe për të vërtetuar këtë fakt ka sqaruar në mënyrë të detajuar të gjitha deklaramet e tij në DPV-të e viteve 2012, 2013, 2014 dhe 2015. Nga riverifikimi i këtyre deklaramave u konstatua se pretendimi i subjektit qëndron, pasi vërtetohet që brenda vitit 2015 ka deklaruar si të shlyer detyrimin 28.200 euro, në këtë mënyrë: në vitin 2012 shuma e shlyer është 2.500 euro¹⁰; në vitin 2013 është 3.500 euro; në vitin 2014 është 3.000.000 lekë ose 21.500 euro; dhe në vitin 2015 është 700 euro. Shuma e shlyer në total, e deklaruar nga subjekti deri në fund të vitit 2015, rezulton të jetë 28.200 euro. Për sa i takon detyrimit të mbetur prej 1.800 euro, subjekti e ka deklaruar në DPV-në e viteve 2015 dhe 2016 dhe në deklaratën *Vetting*. Për rrjedhojë, në analizën financiare përfundimtare, Komisioni ka konsideruar si detyrim shumën 30.000 euro.

⁹ Diferenca e vogël negative prej 31.116 lekësh është shkaktuar nga shpenzime dhe/ose pagesa të tjera të kryera gjatë këtij viti.

¹⁰ Në DPV-në e vitit 2012 subjekti ka deklaruar: “... shpenzuar 350.000 lekë nga kursimet për pagimin pjesërisht të borxhit të marrë I. Sh., sipas deklaramës noteriale datë 13.7.2012, shuma: 2500 euro. Shuma e detyrimit të mbetur 27.500 euro”.

1.4. Në lidhje me trajtimin e mundshëm preferencial

Referuar udhëzimit nr. 5, datë 23.11.2005, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja për vitin 2005”, rezulton se për qytetin e Durrësit, ku ndodhet apartamenti, çmimi në tregun e lirë është 54.838 lekë/m². Pra, apartamenti i blerë do të kushtonte 57.64 m² (vetëm sipërfaqja e brendshme) x 54.838 m² = 3.160.862 lekë, ndërkohë që ka kushtuar 2.862.000 lekë. Subjekti e ka blerë këtë apartament 298.862 lekë më ulët se çmimi tregut, shumë e cila për shkak të vlerës së vogël nuk është vlerësuar nga Komisioni si shkak për të arritur në një përfundim se subjekti është trajtuar me çmim më të favorshëm nga çmimi i tregut, për me tepër, subjekti nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit me administratorin e shoqërisë “****” sh.p.k., z. G. H..

1.5. Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë

1.5.1. Komisioni ka kryer verifikime në lidhje me të ardhurat që kanë shërbyer për shumën 1.400.000 lekë, paguar nga subjekti në vitin 2005, për të cilën ka deklaruar si burime kursime nga pagat e tij dhe bashkëshortes për periudhën 2003 – 2005. Këto të ardhura kanë qenë në shumën 700.000 lekë, referuar DPV-ve të viteve 2003, 2004 dhe 2005, si vijon:

a. Në DPV-në e vitit 2003 subjekti ka deklaruar depozitë prej 1.600.000 lekësh në “Tirana Bank”, me burim “kursime”. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga “Tirana Bank”¹¹ rezultoi se subjekti ka pasur një llogari të përbashkët me të vëllanë H. Sh., e krijuar që në vitin 2002 në shumën 3.200.000 lekë. Duke qenë se kjo është një llogari në të cilën ka pasur të drejtë veprimi edhe vëllai H. D. Sh., duket se subjekti ka deklaruar në vitin 2003 gjysmën e shumës prej 3.200.000 lekësh. Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit vërehet se kjo depozitë ka qenë me afat 5-vjeçar, pasi është maturuar në dhjetor të vitit 2007 dhe në periudhën 2003 – 2006, kjo shumë nuk është përdorur as nga subjekti dhe as nga vëllai i tij. Subjekti e ka tërhequr gjithë shumën në vitin 2011, çka nënkupton se kjo depozitë nuk ka shërbyer si burim për blerjen e kësaj pasurie. Kjo depozitë është trajtuar në mënyrë të detajuar në vijim, pasi është deklaruar si burim konkret për një pasuri tjetër.

b. Në DPV-në e vitit 2004 subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 250.000 lekë nga kursimet e vitit 2004.

c. Në DPV-në e vitit 2005 subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 450.000 lekë si kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes për vitin 2005.

1.5.2. Lidhur me burimin nga letrat me vlerë përfituar nga bashkëshortja si trashëgimtare e ish të dënuarit politik B. D. (babai i bashkëshortes) në vlerën 650.000 lekë, shitur shoqërisë sipërmarrëse “****” sh.p.k., në vlerën 600.000 lekë, konstatohet se ky është një burim i deklaruar për herë të parë në deklaratën *Vetting*. Pavarësisht këtij fakti, Komisioni kreu hetime në lidhje me këtë burim. Konkretisht, nga aktet në dosjen e ILDKPKI-së¹², shpjegimet dhe dokumentet që subjekti ka vënë në dispozicion në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, në përfundim të hetimit administrativ u vërtetua burimi i ligjshëm i kësaj shume, referuar provave si vijojnë:

a. sipas dëshmisë së lëshuar nga regjistri i gjendjes gjyqësore në datën 16.2.1993, vërtetohet se z. B. D. është dënuar në vitin 1977 për “agjitacion dhe propagandë kundër pushtetit”, duke u dënuar me “7 vjet heqje lirie”;

b. sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. *** regj., datë 24.10.1994, trashëgimtarët e trashëgimlënësit B. D. janë bashkëshortja e tij M. D. dhe fëmijët M. dhe E. D., të cilët trashëgojnë sipas ligjit paratë që u takojnë si pension në pjesë të barabarta;

¹¹ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 10.7.2020, të “Tirana Bank”, në dosjen e Komisionit dhe shkresën nr. *** prot., datë 12.6.2019, të “Tirana Bank” në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

¹² Shihni aktet në aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së.

c. sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 19.1.2017, lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., vërtetohet se kjo shoqëri ka marrë nga shtetasja M. D. letrën me vlerë akorduar trashëgimtarëve të z. B. D. nga fondi i të përndjekurve politikë, në vlerën 650.000 lekë, shumë e cila i është kompensuar vajzës së saj E. D. (Sh.), bashkëshortja e subjektit, në vlerën e apartamentit që ka porositur në Lagjen ***, ***, të ndërtuar nga kjo shoqëri. Apartamenti në fjalë është prenotuar në gusht të vitit 2005 dhe nga momenti i këtij prenotimi detyrimi për shumën 600.000 lekë, që rrjedh nga letra me vlerë e sipërpërmendur, është konsideruar i likuiduar;

ç. me dokumentin urdhërshirimi nr. ***, datë 18.12.1995, nga Banka e Kursimeve, vërtetohet se shuma prej 644.429 lekësh rrjedh nga letra me vlerë e emtuar nga kjo bankë dhe i është shitur shoqërisë “****” sh.p.k. nga mbajtësja M. D.;

d. sipas deklaratës së thjeshtë me datë 7.6.2019, shtetasja M. D., nëna e bashkëshortes së subjektit, konfirmon faktet e sipërpërmendura.

Në përfundim të hetimit administrativ, shuma prej 600.000 lekësh, përfituar nga letra me vlerë nga fondi i të përndjekurve politikë, është përfshirë në analizën financiare si e ardhur e ligjshme, pasi pavarësisht se subjekti nuk e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2005, vërtetohet se kjo shumë ka shërbyer si burim për pasurinë objekt shqyrtimi.

1.5.3. Për sa i takon pjesës tjetër prej 50 % të çmimit të shitjes prej 11.500 euro, konvertuar në 1.462.000 lekë, paguar nga vëllai i subjektit I. Sh. në vitin 2005, bazuar në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të vërtetojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të tij, i cili u vlerësua të jetë person tjetër i lidhur, sipas parashikimit të pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka dhënë disa shpjegime për të vëllanë, i cili ka jetuar dhe punuar në Belgjikë që nga viti 2000, si dhe ka vënë në dispozicion dy dokumente shkresore në gjuhën holandeze, në të cilat pasqyrohet historiku i adresave të vëllait I. Sh. në shtetin belg që në vitin 2000, por nga subjekti nuk janë paraqitur dokumente që vërtetojnë të ardhura të ligjshme për të cilat janë paguar detyrimet ligjore të këtij shtetasi¹³.

1.6. Analizë financiare për të vërtetuar blerjen e pasurisë me të ardhura të ligjshme

1.6.1. Për të kryer analizën financiare të pasurisë objekt shqyrtimi, Komisioni ka verifikuar mundësinë financiare të dy vëllezërve për të paguar me të ardhura të ligjshme çmimin e shitjes së pasurisë në mënyrë të barabartë secili, ashtu sikurse subjekti ka pranuar në të gjitha deklaratimet, përfshirë edhe deklaratën *Vetting*. Ndërsa, për sa i takon momentit të likuidimit të këtij çmimi, i cili afekton në mënyrë të drejtpërdrejtë analizën financiare, Komisioni është gjendur përpara fakteve të poshtëshënuara:

a. kontrata e porosisë datë 9.8.2005, dhe mandatarkëtimi i vënë në dispozicion nga shoqëria “****” sh.p.k., që mban po këtë datë, vërtetojnë pagimin e çmimit të shitjes, në total prej 2.862.000 lekësh në datën e lidhjes së kësaj kontrate, 9.8.2005. Me procesverbalin e nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në kontratë vërtetohet marrja në dorëzim e pasurisë po në këtë datë, 9.8.2005;

b. kontrata e shitjes nr. ***, datë 2.4.2012, parashikon se z. Bari Shyti ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. apartament banimi me sip. 57.64 m², me nr. pasurie ***, në çmimin prej 2.862.000 lekësh, i paguar plotësisht jashtë zyrës noteriale, sipas mandatarkëtitimit nr. ***, datë 9.8.2005;

¹³ Subjekti kishte deklaruar se ishte në përpjekje të sigurimit të një dokumenti nga Belgjika, ku një familje e besueshme belge ka shprehur gatishmërinë për të deklaruar para noterit publik faktin se i vëllai I. Sh. dhe bashkëshortja e tij kanë punuar për shumë vite me kohë të pjesshme pranë familjes së tyre dhe janë paguar me para në dorë për punën e kryer sipas orëve ditore.

c. në deklaratën noteriale të vitit 2012, pjesëmarrësit në akt, subjekti dhe i vëllai I. Sh., kanë pranuar se çmimi i shitjes është paguar 1/2 në vitin 2005 dhe 1/2 në vitin 2007;

ç. në deklaratimet gjatë procesit të rivlerësimit subjekti ka deklaruar se në vitin 2005 është paguar shumën 2.000.000 lekë dhe në vitin 2007 është paguar diferenca prej 880.000 lekësh.

Në kushtet e këtyre mospërputhjeve në deklarime, për më tepër, në kushtet kur në asnjë prej DPV-ve subjekti nuk ka kryer deklarime në lidhje me periudhat/periudhën e likuidimit të çmimit të shitjes ndaj palës shitëse, Komisioni kreu analizën financiare për të verifikuar mundësinë e blerjes së pasurisë me të ardhura të ligjshme të të dy vëllezërve në mënyrë të barabartë, secili në vitin 2005, referuar dokumenteve shkresore me vlerë të pakontestueshme si: (i) kontratë porosie datë 9.8.2005, dhe akteve bashkëlidhur kësaj kontrate; si dhe (ii) kontratë shitjeje nr. ***, datë 2.4.2012.

1.6.2. Nga analiza financiare e kryer deri më 9.8.2005, kur është paguar çmimi i blerjes, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën në vijim, duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar pjesën e tij takuese në shumën prej 1.400.000 lekësh, për shkak të një balance negative prej 1.052.665 lekësh.

Përshkrimi	9.8.2005
Pasuri	1 919 432
Apartament 54.87 m ² , në ***, Durrës (pjesë takuese 50 % me vëllain)	1 400 000
Shtesa/pakësime likuiditete	519 432
Të ardhura	1 086 016
Të ardhura nga pagat e subjektit	454 206
Të ardhura nga interesa bankare	31 810
Përfitim pagese nga ish të përndjekurit, bashkëshortja si trashëgimtare e shtetasit B. D.	600 000
Shpenzime	219 249
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së për 4 persona	219 249
Mundësia për kursime	-1 052 665

1.6.3. Për sa i takon pjesës takuese të vëllait I. Sh., gjatë hetimit administrativ nuk u vërtetuan të ardhura të ligjshme të tij për të paguar pjesën takuese prej 11.500 euro, të barabartë me 1.440.000 lekë.

1.7. Konstatime në lidhje me pasurinë apartament banimi me sip. 57.64 m², me nr. pasurie *, në Durrës**

Në përfundim të hetimit administrativ, subjektit i kaloi barra e provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 në lidhje me konstatimet, duket se:

a. në DPV-të e viteve 2005 dhe 2006 subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer deklarime për këtë pasuri dhe të drejtat reale mbi të, si dhe nuk ka deklaruar pagesën për çmimin e blerjes dhe as burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për këtë pagese, sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar;

b. në DPV-në e vitit 2007 subjekti ka deklaruar blerjen e një pasurie me sip. 35 m², pra pjesën e tij takuese të pandarë, me vlerë të paguar prej 1.400.000 lekësh, ndërkohë që sipas kontratës se sipërmarrjes dhe mandatarkëtimit të lëshuar nga shoqëria ndërtimore me datë 9.8.2005, likuidimi total i çmimit të shitjes dhe marrja në dorëzim e pasurisë ishte bërë nga subjekti në vitin 2005 dhe, për rrjedhojë, subjekti duhet të kishte deklaruar të gjithë pasurinë dhe të drejtat

reale mbi të. Në këtë DPV mungojnë deklaratimet për pjesën tjetër të çmimit të shitjes, shumë e pretenduar prej 11.500 euro të paguar të marrë nga vëllai I. Sh., si dhe burimin e krijimit të kësaj shume, sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar;

c. ka deklarime kontradiktore dhe të paqarta gjatë procesit të rivlerësimit në lidhje me pagimin e çmimit të shitjes dhe periudhat përkatëse, krahasuar me deklaratat periodike vjetore, si dhe deklarime kontradiktore dhe të paqarta në DPV në lidhje me detyrimin financiar ndaj personit tjetër të lidhur I. Sh.;

ç. subjekti ka deklaruar për herë të parë në deklaratën *Vetting* si burim të krijimit të pasurisë dhurimin që nëna e bashkëshortes i ka bërë në letrat me vlerë prej 650.000 lekësh;

d. ka mungesë burimi të ligjshëm financiar për të paguar shumë prej 1.400.000 lekësh, paguar nga subjekti në vitin 2005;

dh. ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për pagesën e kryer nga shtetasi I. Sh. në shumë 11.500 euro në vitin 2005, si dhe mungesë të të ardhurave të tij të ligjshme për pagesën e kësaj shume. Nuk vërtetohet me dokumentacion shkresor dhënia e kësaj shume nga personi i lidhur I. Sh. si pagesë për blerjen e 1/2 pjese të një apartamenti në Durrës;

e. deklarata noteriale e datës 13.7.2012 duket se përmban një fakt të pavërtetë lidhur me nënshkrimin e shtetasit I. Sh. në këtë datë, pasi nga verifikimi i sistemit *TIMS* rezulton se ky shtetas ka dalë nga Shqipëria në datën 16.3.2012 dhe ka hyrë në territorin shqiptar në datën 30.7.2012, pra, nuk ka qenë në Shqipëri në datën 13.7.2012.

1.8. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi nga Komisioni

1.8.1. Për sa i takon mosdeklarimeve në DPV-në e viteve 2005 dhe 2006, në parashtrimet e datës 13.10.2020, subjekti ka deklaruar se: *“Vonesa në deklarin e kësaj pasurie ka ardhur pikërisht për faktin se akoma nuk ishte paguar i gjithë çmimit i blerjes, duke u vlerësuar nga ana ime si pasuri e papaguar, aq më pak që nuk kishte asnjë dokumentacion ligjor të regjistruar në ndonjë regjistër publik. E pranoj që duhej deklaruar në vitin e rezervimit, por është lehtësisht e kuptueshme se nuk është fshehur asnjë gjë”*. Shpjegimet e subjektit vijnë në kundërshtim me të dhënat e kontratës së porosisë së datës 9.8.2005. Në lidhje me këtë kontratë dhe aktet bashkëlidhur me të, subjekti është pyetur gjatë procesit të rivlerësimit dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka deklaruar se pagesa e çmimit nuk është bërë në vitin 2005, sikurse kontrata parashikon, dhe se kjo kontratë, mandatpagesa dhe akti i dorëzimit të apartamentit janë kryer në mirëbesim me shoqërinë ndërtuese, duke pranuar se këto akte përmbanin fakte të pavërteta. Këtë qëndrim subjekti mbajti edhe në seancën dëgjimore të datës 23.1.2021, por pa shpjeguar në mënyrë të qartë përse ka ndodhur kjo. Gjithsesi, në kushtet e një kontrate porosie dhe një akti që vërteton marrjen në dorëzim të apartamentit në vitin 2005, fakt të cilin e ka deklaruar edhe gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka pasur detyrimin e deklarin të pasurisë në DPV-në e viteve 2005 dhe 2006, në zbatim të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, i cili parashikon se subjektet kanë detyrimin e deklarin të pasurisë, të drejtave reale, pakësimet e depozitave apo gjendjeve *cash*, si dhe burimin e krijimit.

1.8.2. Për sa i takon deklarin në vitin 2007, vetëm të gjysmës së pasurisë në vlerën 1.400.000 leke, subjekti ka sqaruar se: *“Në këtë deklaratë është deklaruar vetëm çmimi për sipërfaqen takuese prej 32 m², sipërfaqe kjo që i korrespondon gjysmës së sipërfaqes së apartamentit, ndërkohë që sipërfaqja totale sipas dokumenteve paraprake ishte 63.5 m²...”*. Më tej, subjekti ka deklaruar se: *“... marrëdhënia e bashkëpronësisë me vëllain I. Sh. në këtë pasuri me nga 1/2 secili del e pasqyruar që në DPV-në e vitit 2008, në rubrikën ‘të dhëna konfidenciale’, duke vijuar ky deklarim edhe më pas në DPV-në e vitit 2009, po ashtu edhe në vitin 2010”*.

Në vlerësim të këtyre deklarimeve, Komisioni arsyeton se formulari i deklarimit të pasurisë, në rubrikën e “interesave private, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, parashikon detyrimin për deklarimin e pasurisë, me të dhëna të plota (sipërfaqe, çmim etj.), deklaratë e cila të krijon mundësinë e deklarimit të pjesës takuese mbi këtë pasuri në një kolonë të veçantë. Pra, vetëm nëpërmjet deklarimit të pjesës takuese të pasurisë bëhet i kuptueshëm fakti nëse subjekti është pronar i vetëm apo bashkëpronar i saj, deklarim i cili mungon të jetë kryer në DPV-në e vitit 2007, por vetëm në DPV-në e vitit 2008 dhe në vijim.

1.8.3. Në lidhje me deklaratimet kontradiktore gjatë procesit të rivlerësimit me deklaratimet periodike mbi pagimin e çmimit të shitjes dhe periudhat përkatëse, subjekti ka deklaruar se: *“Në vitin 2005 është paguar shuma 2.000.000 lekë, e cila përbëhej nga shuma 11.500 euro, pjesa e vëllait, dhe shuma 600.000 lekë, pjesa ime nga letrat me vlerë të dhëna shoqërisë ndërtuese. Kam deklaruar që pjesa e mbetur e imja në shumën 840.000 lekë është paguar deri në vitin 2007”*. Pra, subjekti nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me deklaratimet kontradiktore, duke vijuar të jetë në mospërputhje me deklarimet në deklaratën noteriale të vitit 2012, sipas së cilës çmimi i shitjes është paguar 1/2 në vitin 2005 dhe 1/2 në vitin 2007, dhe për më tepër, deklarimet e tij vijnë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes dhe mandatpagesën datë 9.8.2005.

Për sa i takon deklaratimeve kontradiktore për detyrimin financiar ndaj vëllait I. Sh., siç u sqarua më sipër, subjekti ka vërtetuar se detyrimi në total ka qenë në shumën 30.000 euro.

1.8.4. Për sa është konstatuar nga Komisioni mbi deklarimin për herë të parë në deklaratën *Vetting* si burim krijimi të kësaj pasurie, dhurimin nga nëna e bashkëshortes të letrave me vlerë prej 650.000 lekësh, subjekti nuk ka dhënë sqarime, por vetëm ka përshkruar rrethanat e përdorimit të kësaj shume për pagesën, njësoj siç ka deklaruar gjatë procesit të rivlerësimit. Kjo vlerë është konsideruar si burim i ligjshëm për blerjen e pasurisë.

1.8.5. Në lidhje me mungesën e burimit të ligjshëm të të ardhurave të tij për të paguar shumën prej 1.400.000 lekësh në vitin 2005, subjekti mohon të këtë paguar këtë shumë në vitin 2005, duke deklaruar se prej tij gjatë këtij viti është paguar vetëm shuma 600.000 lekë nga fondi i të përndjekurve politikë të familjes së bashkëshortes, pretendim që ka vijuar ta këtë edhe në parashtrimet e rezultateve të hetimit shtesë, duke kërkuar që pjesa e tij takuese e paguar në vitin 2005 të konsiderohet në vlerën 600.000 dhe pjesa e mbetur prej 880.000 lekësh të konsiderohet si detyrim ndaj vëllait, i paguar nga subjekti në vitin 2007, duke bërë të ditur në këtë mënyrë se kjo shumë është paguar prej vëllait në vitin 2005. Por, këtë detyrim dhe shlyerjen e tij subjekti nuk rezulton ta këtë deklaruar në asnjë prej DPV-ve. Pra, pretendimet e subjektit mbeten në nivel deklarativ dhe, si të tilla, nuk janë marrë në konsideratë. Përveç kësaj, edhe nëse do të merret në konsideratë pretendimi se shuma prej 880.000 lekësh është paguar nga vëllai I. Sh. në vitin 2005, nuk është vërtetuar që ky shtetas të këtë pasur të ardhura të ligjshme me të cilat të këtë paguar këtë shumë, nderkohë që nga ana tjetër, subjekti nuk do të kishte të ardhura të mjaftueshme për të shlyer këtë detyrim në vitin 2007 sipas pretendimit të tij, për shkak se balanca negative e këtij viti, do të rezultonte -114,479 lekë.

Po kështu, subjekti sjell në vëmendje faktin që e ka deklaruar këtë pronë për herë të parë në DPV-në e vitit 2007, pikërisht për shkak të likuidimit të plotë të çmimit prej tij në këtë vit, fakt që bie në kundërshtim me provat shkresore të administruara, por edhe me vetë deklarimet e subjektit, të cilat shpesh janë jokonsistente.

Në përfundim, Komisioni çmoi se subjekti nuk arriti të kundërshtojë rezultatin në lidhje me pamundësinë e pagimit të shumës prej 1.400.000 lekësh në vitin 2005. Për këtë arsye analiza financiare e kryer në datën 9.8.2005, mbetet e pandryshuar, me një balancë negative prej 1.052.665 lekësh.

1.8.6. Për sa i takon vërtetimit të dorëzimit të shumës prej 11.500 euro, konvertuar në 1.440.000 lekë, paguar nga vëllai I. Sh. në vitin 2005, subjekti ka deklaruar se kjo shumë është marrë nga gjendja *cash* që i vëllai kishte dërguar herë pas herë në Shqipëri nëpërmjet personave të ndryshëm që kishin mundësi lëvizjeje. Për sa i takon të ardhurave që kanë shërbyer si burim i saj, subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara për mënyrën e sigurimit të të ardhurave nga i vëllai në shtetin belg dhe ka vënë në dispozicion disa dokumente, nga verifikimi i të cilave nuk vërtetohen të ardhura të ligjshme të tij¹⁴. Në vijim, me *e-mail*-in e datës 4.2.2021, subjekti ka paraqitur një vërtetim, sipas të cilit vëllai i tij është trajtuar nga shteti belg me asistencë sociale, e cila është ndihmë ekonomike që jepet nga shteti vetëm për të mbuluar nevojat bazë të jetesës dhe, si e tillë, nuk mund të shërbejë për të krijuar kursime. Në përfundim, subjekti nuk ka vërtetuar të kundërtën e barrës së provës, sa i takon vërtetimit të burimit të ligjshëm të të ardhurave të personit tjetër të lidhur, z. I. Sh., për të paguar shumën 11.500 euro në vitin 2005, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

Për sa i takon pretendimit të subjektit se i vëllai I. Sh. nuk është person tjetër i lidhur, Komisioni e vlerëson si të pabazuar, pasi, sipas parashikimit të pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, ky shtetas hyn në rrethin e personave të tjerë të lidhur, referuar fakteve dhe rrethanave të vërtetuara me deklaratimet e subjektit në DPV-të përkatëse, si dhe ato gjatë procesit të rivlerësimit, si vijojnë: (i) subjekti dhe shtetasi I. Sh. kanë qenë bashkëpronarë *de facto* në pjesë të pandara mbi pasurinë, secili në 1/2 pjesë që në vitin 2005 deri në vitin 2010, kur palët me marrëveshje kanë rënë dakord që ky shtetas të blinte pjesën takuese të subjektit; (ii) në DPV-në e viteve 2008 dhe 2009 subjekti ka deklaruar bashkëpronësinë me të vëllanë mbi këtë pasuri; (iii) në vitin 2010 vëllezërit kanë rënë dakord që shtetasi I. Sh. të blejë pjesën e subjektit Bari Shyti në vlerën 18.500 euro, shumë e cila është dhënë dorazi në muajt mars - prill të vitit 2010. Për me tepër, siç vërehet, subjekti ia ka shitur pjesën e tij takuese të vëllait, më shumë se vlera fillestare prej 11.500 euro, që përkon me rritjen e çmimit të tregut krahasuar me vitin 2005 kur është porositur pasuria. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se në vitin 2010 kishte rënë dakord me të vëllanë që apartamenti në bashkëpronësi t'i mbetej shtetasit I. Sh., duke i dhënë subjektit kundërvlerën e pjesës takuese me çmimin e tregut që i korrespondonte vitit 2010; (iv) në vitin 2012, po me marrëveshje, palët kanë rënë dakord që pasurinë ta mbajë subjekti Bari Shyti, kundrejt detyrimit ligjor prej 30.000 euro ndaj të vëllait, detyrim i deklaruar ndër vite rregullisht nga subjekti i rivlerësimit.

Siç vërehet, referuar dinamikës së ngjarjeve, marrëdhënia midis subjektit dhe vëllait të tij I. Sh. është një marrëdhënie e pastër interesi që ka përfunduar në një detyrim financiar të njërit ndaj tjetrit. Përveç kësaj, shuma prej 18.500 euro dhënë nga z. I. Sh. në vitin 2012, përdorur e deklaruar nga subjekti si burim për blerjen e një pasurie tjetër në pronësi të plotë të subjektit të rivlerësimit, pavarësisht se nuk është formalizuar në një kontratë huaje, është në thelb një marrëdhënie huaje, të cilën subjekti e ka deklaruar në formën e detyrimit financiar në DPV-në e vitin 2012, duke deklaruar në vijim shlyerjen me këste ndër vite.

1.8.7. Në lidhje me deklaratën noteriale të datës 13.7.2012, të nënshkruar nga shtetasi I. Sh. ndërkohë që nuk ka qenë në Shqipëri në këtë datë, subjekti ka deklaruar se: *“Konstatimi juaj, qëndron si fakt... Deklarata është përpiluar në datën 13.7.2012 nga noteri I. K. në mirëbesim, pasi i kam kërkuar që deklaratën ta mbajë në zyrë deri sa vëllai I. do të shkonte ta firmoste në prezencë të tij, fakt i cili ka ndodhur sapo ai është kthyer në Shqipëri në datën 30.7.2012.*

¹⁴ Deklaratë dore (dorëshkrim) me nënshkrimin I. Sh., e cila konfirmon deklaratimet e subjektit; vërtetim nga zyra e gjendjes civile të qytetit Ostend (Belgjikë), në të cilin tregohen adresat ku ka banuar z. I. Sh. nga korriku i vitit 2000 deri më 12.10.2020; vërtetim i paraqitur nga subjekti me pyetësorin nr. 4, i përkthyer dhe i noterizuar.

Nëpërmjet deklaratës unë qetësova familjarët tanë, të cilët u shqetësuan nga frika e prishjes së marrëdhënieve ndërmjet vëllezërve”.

Për sa i takon kësaj deklarate, për sa kohë Komisioni nuk mund të vërtetojë autenticitetin e nënshkrimit të shtetasit I. Sh. në të, nuk mund të arrihet në përfundimin se kjo deklaratë nuk është nënshkruar prej tij. Por, referuar faktit që deklarata midis vëllezërve është redaktuar 7 vjet më vonë se ata kanë rënë në një marrëveshje të përbashkët për blerjen e një pasurie, periudhë gjatë së cilës nuk është evidentuar ndonjë konflikt midis tyre, deklarimi i subjektit se kjo deklaratë është bërë për të qetësuar familjarët nuk është tërësisht i besueshëm. Po kështu, nënshkrimi i deklaratës në një ditë që z. I. Sh. nuk ka qenë në Shqipëri, përpos mungesës së përgjegjshmërisë së subjektit si gjyqtar, i cili nuk duhet të lejonte nënshkrimin e aktit noterial në kundërshtim me nenin 49, të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994, “Për noterinë”, i ndryshuar¹⁵, në raport dhe së bashku me rrethana të tjera si: (i) faktin që nuk ka asnjë dokument shkresor që vërteton kalimin e shumës 11.500 euro (ashtu si dhe të shumës 18.500 euro) nga z. I. Sh. te subjekti i rivlerësimit; (ii) faktin që nuk është vërtetuar mundësia e pagimit të këtyre shumave prej këtij shtetasi me të ardhura të ligjshme; (iii) faktin që në këtë deklaratë mënyra e likuidimit të çmimit të shitjes bie në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes, datë 9.8.2005, mund të ngrenë dyshime se pasuria objekt shqyrtimi mund të jetë një pasuri e blerë vetëm prej subjektit të rivlerësimit.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit për pasurinë apartament banimi në Durrës, u konstatua se në kuptim të germave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka kryer deklarime të pasakta dhe ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për blerjen e saj dhe, për rrjedhojë, është në kushtet e pamjaftueshmërisë në deklarime, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

2. Apartament 2+1, me sip. 107 m², nr. ***, k. ***, shk. ***, objekti ***, godinë banimi e ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k., në rr. “J. M.”, Tiranë, me kontratë sipërmarrjeje, datë 12.3.2010 dhe kontratë shitjeje nr. ***, datë 2.9.2015, regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në datën 18.9.2015, nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***. Vlera e blerjes: 75.000 euro, paguar në 4 këste gjatë periudhës mars 2010 – prill 2012. Si burim i të ardhurave për këtë pasuri janë deklaruar:

a. shuma 21.000 USD e siguruar nga puna e subjektit dhe e bashkëshortes në grumbullimin e kromit gjatë periudhës 2007 – 2008 në stokun e minierës “****” sh.p.k., me administrator z. I. Sh. (vëllai i subjektit të rivlerësimit). Shpërblimi është bërë me para *cash*, pas dorëzimit të sasisë prej 60 ton krom;

b. kursime nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes për periudhën janar 2007 – dhjetor 2012;

c. premtim shitjeje e pjesës prej 50 % e apartamentit në Lagjen ***, ***, Durrës, të bashkëpronarit z. I. Sh., kundrejt vlerës 18.500 euro;

ç. kontratë huaje, datë 13.12.2011, me z. I. Sh., për shumën 9.000 USD (shuma është paguar para lidhjes së kontratës);

d. tërheqje depozite datë 21.1.2011, nga “Tirana Bank” në shumën 3.203.000 lekë. Kjo depozitë në shumën 1.600.000 lekë është krijuar në vitin 2002 nga kursimet deri në datën 31.12.2001, shtuar me interesa dhe pagesa nga një pjesë e kursimeve. Pjesa takuese: 100 %.

¹⁵ Akti noterial hartohet nga noteri në prani të palëve.

Në lidhje me këtë pasuri, ILDKPKI-j ka konstatuar:

- Mungesë burimi dhe dokumentacioni të ligjshëm financiar për shumën 21.000 USD, të deklaruar nga mbledhja e mineralit të kromit.

- Shuma 21.000 USD nuk është deklaruar gjendje *cash* apo në bankë në deklaratat e interesave private të viteve 2008 dhe 2009, po kështu, as pakësimi në vitin 2010 për pagesë të këstit të parë të apartamentit në rr. “J. M.”, Tiranë.

Hetimi i Komisionit për këtë pasuri

2.1. Në lidhje me statusin aktual të kësaj pasurie, gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se:

a. ZVRPP-ja Tiranë¹⁶ ka informuar se në emër të subjektit Bari Shyti rezulton e regjistruar pasuria e llojit “apartament”, me sip. 95.80 m², me nr. ***. Subjekti e ka deklaruar me sip. 107 m², aq sa është në kontratën e sipërmarrjes.

b. OSHEE-ja¹⁷ nuk konfirmon kontratë të furnizimit me energji në emër të subjektit Bari Shyti ose bashkëshortes së tij, por informon se në emër të shtetasit E. Sh. (djali i subjektit) ka kontratë të furnizimit me energji me nr. ***, Tiranë. Në lidhje me këtë kontratë subjektit i janë kërkuar sqarime së bashku me kontratën e furnizimit me energji me nr. ***, që i përkiste apartamentit të banimit të Durrës. Shpjegimet e tij janë trajtuar me pikën 1.1 të vendimit.

2.2. Në lidhje me origjinën dhe mënyrën e krijimit të pasurisë, nga aktet¹⁸ në dosje rezultoi se:

a. Me kontratën e datës 12.3.2010, porositësi Bari Shyti ka porositur pranë sipërmarrësit, shoqërisë “****” sh.p.k., ndërtimin e një ambienti me sipërfaqe ndërtimi, në total 107.72 m² (ku përfshihen sipërfaqe në pjesën e përbashkët të shkallëve dhe pjesëve të tjera në bashkëpronësi), si dhe vendparkimi nr. ***, me çmim 80.000 euro.

b. Sipas certifikatës për vërtetim pronësie, datë 26.6.2015, pasuria e llojit “apartament”, me sip. 95.80 m², me nr. ***, rezulton e regjistruar në emër të shoqërisë “****” sh.p.k.

c. Me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 2.9.2015, z. Bari Shyti ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k.: (1) apartamentin nr. ***, me nr. pasurie ***, me sipërfaqe të brendshme ndërtimi 95.80 m², me sipërfaqe të përbashkët 11.92 m² dhe me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi 107.72 m²; (2) garazh me nr. pasurie ***, me sipërfaqe ndërtimi 15.50 m², me sipërfaqe të përbashkët 14.74m² dhe me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi 30.24 m². Çmimi i parashikuar në kontratë është 80.000 euro, nga të cilat 75.000 euro për apartamentin dhe 5.000 euro për garazhin. Në kontratë parashikohet që pagesa është kryer nga blerësi sipas kontratës se porosisë datë 12.3.2010.

ç. Sipas certifikatës për vërtetim pronësie, datë 18.9.2015, apartamenti me sip. 95.80 m², nr. pasurie *** (dhe garazhi), rezulton i regjistruar në emër të z. Bari Shyti.

2.3. Në lidhje me çmimin e shitjes dhe likuidimin e tij, u konstatua se:

2.3.1. Kontrata e sipërmarrjes parashikon se çmimi i pasurisë objekt kontrate, do të jetë 80.000 euro, i cili do të paguhet me këste në mënyrë periodike, si vijon: (i) porositësi ka paguar këstin e parë të blerjes së ambientit që premtohet në vlerën 35.000 euro me nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes datë 12.3.2010; (ii) porositësi do të paguajë këstin e dytë deri në datën

¹⁶ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 13.2.2019, nga ZVRPP-ja Tiranë, në dosjen e Komisionit.

¹⁷ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 5.2.2019, nga OSHEE-ja, në dosjen e Komisionit.

¹⁸ Shihni aktet në aneksin 4/2, në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentet bashkëlidhur shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 13.2.2019, të ZVRPP-së Tiranë, në dosjen e Komisionit.

30.5.2010, në shumën 10.000 euro; (iii) porositësi do të paguajë këstin e tretë të çmimit deri në datën 10.1.2011, në shumën 25.000 euro; (iv) porositësi do të paguajë këstin e fundit me marrjen në dorëzim me çelësa në dorë në vlerën 10.000 euro. Pagesat do të kryhen nga porositësi në numrin e llogarisë me nr. ***, në euro, në “Intesa Sanpaolo Bank”.

2.3.2. Sipas dokumentacionit të administruar nga shoqëria “****” sh.p.k.¹⁹ pagesat e kryera për likuidimin e shumës 80.000 euro janë kryer si vijon: (i) me dokumentin bankar, datë 12.3.2010, të “Intesa Sanpaolo Bank”, subjekti Bari Shyti ka derdhur për llogari të shoqërisë “****” sh.p.k. shumën 35.000 euro, me përshkrim “blerje apartamenti, kësti i parë”; (ii) me dokumentin bankar, datë 21.1.2011, të “Tirana Bank”, subjekti ka transferuar nga llogaria e tij shumën 25.000 euro, me përshkrimin “TNT për ‘****’ sh.p.k. blerje apartament ***+parking, kësti i dytë”; (iii) me mandatarëkëtimin nr. ***, datë 6.7.2011, subjekti Bari Shyti ka derdhur *cash* në arkën e shoqërisë “****” sh.p.k. shumën 10.000 euro; (iv) me mandatarëkëtimin nr. ***, datë 12.4.2012, subjekti Bari Shyti ka derdhur *cash* shumën 10.000 euro.

2.3.3. Sipas dokumentacionit të administruar nga ZVRPP-ja Tiranë²⁰, pagesat e kryera për likuidimin e çmimit të apartamentit përputhen me të dhënat e vëna në dispozicion nga shoqëria “****” sh.p.k. Referuar dokumenteve si më sipër, konstatohet se likuidimi i çmimit të shitjes prej 80.000 euro nuk është kryer tërësisht sipas kontratës së sipërmarrjes të datës 12.3.2010, pasi kësti prej 10.000 euro nuk është paguar në datën 30.5.2010 sipas parashikimit në kontratën e sipërmarrjes datë 12.3.2010.

2.4. Nga deklaratimet periodike në lidhje me këtë pasuri rezulton se:

2.4.1. Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri për herë të parë në DPV-në e vitit 2010, ku ndër të tjera, ka deklaruar se: “... *prenotuar me kontratë shitjeje një apartament 2+1, sip. 107 m², vendndodhja: rr. ‘J. M.’, pas burgut 313, është paguar kësti i parë 35.000 euro, pjesë takuese 50 %...*”. Në këtë deklaratë nuk është deklaruar garazhi, si dhe nuk është deklaruar burimi i krijimit të pasurisë. Pagesa sipas këtij deklarimi vërtetohet me aktin bankar, datë 12.3.2010, në “Intesa Sanpaolo Bank”, sipas të cilit subjekti Bari Shyti ka derdhur për llogari të shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrim “blerje apartamenti shumën prej 35.000 euro”.

2.4.2. Në DPV-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar: “... *paguar dy këste për blerje të apartamentit, një këst në datën 21.1.2011, në shumën 25.000 euro dhe një këst në datën 6.7.2011, në shumën 10.000 euro*”. Nuk është deklaruar burimi i krijimit. Pagesat sipas këtij deklarimi vërtetohen nëpërmjet: (i) dokumentit bankar nga “Tirana Bank”, sipas të cilit rezulton se në datën 21.1.2011 nga llogaria e subjektit në monedhën euro pranë kësaj banke është transferuar shuma prej 25.000 euro, me përshkrimin “TNT për ‘****’ sh.p.k., blerje apartament ***+parking, kësti i dytë”; dhe (ii) mandatarëkëtimin nr. ***, datë 6.7.2011, sipas të cilit z. Bari Shyti ka derdhur *cash* shumën 10.000 euro (kësti i tretë).

2.4.3. Në DPV-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar: “... *paguar kësti i fundit për blerjen e apartamentit në Tiranë për këtë pagesë janë përdorur 5.000 euro të marra hua shtetasit P. B. dhe 700.000 lekë nga kursimet e vitit 2012. Vlera: 10.000 euro...*”. Huaja e shtetasit P. B. nuk është deklaruar si burim në deklaratën *Vetting* për blerjen e apartamentit (por është deklaruar si burim për blerjen e garazhit, i cili është trajtuar në vijim). Kjo pagesë vërtetohet nëpërmjet mandatarëkëtimin nr. ***, datë 12.4.2012, sipas të cilit rezulton se shuma 10.000 euro është paguar *cash* pranë arkës së shoqërisë “****” sh.p.k. nga subjekti.

2.4.4. Në DPV-në e vitit 2014, në rubrikën “të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar: “*Apartament me sip. 107m² dhe post parkimi, adresa: rr. ‘J. M.’, Tiranë, blloku i*

¹⁹ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. ***, datë 11.6.2019, nga shoqëria “****” sh.p.k., në dosjen e Komisionit.

²⁰ Shihni dokumentet bashkëlidhur shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 13.2.2019, nga ZVRPP-ja Tiranë, në dosjen e Komisionit.

apartamenteve ***. Kjo pasuri është e paregjistruar, por është deklaruar kontrata e sipërmarrjes në deklaratat e mëparshme”.

2.4.5. Në DPV-në e vitit 2015, në rubrikën “të dhëna kofidenciale”, subjekti ka deklaruar: “Apartament me sip. 107 m² dhe post parkim, adresa: rr. ‘J. M.’, blloku i apartamenteve ***. Kjo pasuri është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në vitin 2015”.

2.4.6. Nga sa më sipër, vërehet se: (i) në DPV-të e viteve 2010, 2011 dhe 2013 nuk janë kryer deklarime për garazhin, i cili është deklaruar për herë të parë në DPV-në e vitit 2014; (ii) lidhur me burimet që kanë shërbyer për këtë pasuri, deklarimet në deklaratën *Vetting* detajojnë burimet e përdorura, ndërkohë që në DPV nuk janë specifikuar se cilat burime janë përdorur dhe për çfarë, sipas parashikimit të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i është kërkuar të japë sqarime në lidhje me konstatimet si më sipër.

Në parashtrimet e tij, dërguar në rrugë elektronike në datën 13.10.2020, subjekti ka dhënë sqarime vetëm lidhur me mosdeklarimin e garazhit në DPV-të e viteve 2010, 2011 dhe 2013, duke deklaruar se: “.. është lidhur vetëm një kontratë porosie në vitin 2010 me shoqërinë ndërtuese, ku citohet apartamenti dhe garazhi, ku në çmimin prej 80.000 euro është përfshirë çmimi i apartamentit dhe i garazhit, ndaj nuk është cilësuar si pasuri më vete në DPV-në e vitit 2010 garazh”. Në fakt, në DPV-në e vitit 2010 subjekti ka deklaruar vetëm një kontratë porosie me shoqërinë “****” sh.p.k. për blerje apartamenti 2+1, pa përmendur garazhin. Por, në kushtet kur garazhi është përfshirë në të njëjtën kontratë me apartamentin, duke u përcaktuar një çmim i posaçëm për të, dhe në kushtet kur subjekti e ka deklaruar garazhin në deklaratën *Vetting*, Komisioni nuk e konsideron mosdeklarimin e garazhit me qëllim fshehjen e tij, por si pasaktësi në deklarim, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, që së bashku me pasaktësi të tjera, janë marë në konsideratë nga Komisioni në vleresimin përfundimtar të çështjes.

2.5. Në lidhje me trajtimin e mundshëm preferencial

Referuar udhëzimit nr. 3, datë 3.2.2010, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2010”, rezulton se për qytetin e Tiranës ku ndodhet apartamenti, çmimi mesatar i shitjes në tregun e lirë për vitin 2010 është 84.750 lekë/m²²¹, pra apartamenti i blerë do të kushtonte 95.80 m² (sipërfaqe e brendshme) x 84.750 lekë/m² = 8.119.050 lekë²², ndërkohë që ka kushtuar 10.397.450 lekë. Subjekti e ka blerë këtë apartament 2.278.400 lekë më shtrenjtë se çmimi i tregut.

2.6. Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë, gjatë hetimit administrativ janë analizuar specifikisht burimet e deklaruara në deklaratën *Vetting*, si vijojnë:

2.6.1. Burimi: shuma 21.000 USD e siguruar nga puna e subjektit dhe e bashkëshortes në grumbullimin e kromit gjatë periudhës 2007 – 2008, në stokun e minierës “****” sh.p.k., me administrator I. Sh. (vëllai i subjektit të rivlerësimit). Shpërblimi është bërë me para *cash*, pas dorëzimit të sasisë prej 60 ton krom.

Në lidhje me këtë burim, ILDKPKI-ja ka administruar informacione nga shoqëria “****” sh.p.k., me përfaqësues ligjor I. Sh., vëllai i subjektit të rivlerësimit²³, si dhe një deklaratë të thjeshtë të datës 11.12.2014, të këtij shtetasi²⁴, sipas të cilave është konfirmuar se: (i) znj. E. Sh., bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, ka qenë e punësuar si llogaritë pranë subjektit “****” sh.p.k., për periudhën tetor 2007 – korrik 2008; (ii) bashkëshortët Bari dhe E. Shyti kanë punuar në vitin 2008 në stokun e galerisë nr. 3, të subjektit “****” sh.p.k., ku me punën dhe

²¹ Referuar tabelës nr. 2 të këtij udhëzimi, listës së qyteteve për çmimet e tregut të lirë për vitin 2010 për qytetin e Tiranës.

²² Në kontratën e shitjes, sipërfaqja totale e apartamentit, së bashku me sipërfaqet e përbashkëta, është 107.72 m², ndërsa vlera sipas EKB-së për këtë sipërfaqe do të ishte 9.129.270 lekë. Subjekti e ka blerë apartamentin më shtrenjtë se vlera e referencës.

²³ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 3.8.2017, nga “****” sh.p.k., në aneksin nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁴ Shihni dokumentin në aneksin ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

shpenzimet e tyre kanë grumbulluar një kamion mineral kromi, i cili është shitur nga shoqëria “****” sh.p.k., duke i paguar z. Bari Shyti çmimin e tregut të shitjes së kohës, pasi janë zbritur vetëm detyrimet tatimore, transporti dhe shpenzimet portuale; si dhe (iii) dokumentacioni i rregullt për shitjet dhe blerjet e periudhës para vitit 2011 nuk është ruajtur prej tij.

Nga verifikimi i deklarimeve periodike në lidhje me këtë burim konstatohet se:

a. Në DPV-në e vitit 2007, në rubrikën “të ardhura”, subjekti ka deklaruar: “Paga për 3 muaj tek subjekti privat ‘****’ sh.p.k. – 75.000 lekë”. Në këtë vit, bashkëshortja nuk e ka plotësuar formularin e pjesëtarëve të familjes që mbartin detyrimin për deklarim. Nga verifikimet e kryera rezulton se sipas vërtetimit nr. ***, datë 27.10.2016, të lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k.,²⁵ paga e bashkëshortes për tre muajt e vitit 2007 është në total 42.624 lekë. Pra, deklarimi i subjektit nuk përputhet me dokumentacionin e administruar dhe kjo shumë është konsideruar si e ardhur e ligjshme në analizën financiare, pasi është vërtetuar se për këto të ardhura janë paguar detyrimet²⁶.

b. Në DVP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar: “Mbledhje shitje minerali kromi maj - qershor 2008. Nga mbledhja dhe shitja e 60 ton krom, në stokun e firmës ‘****’ sh.p.k.; It = 350 USD; 21.000 USD”. Kjo shumë nuk është deklaruar nga subjekti si gjendje *cash* në fund të vitit 2008.

c. Në DPV-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar kursime nga pagat në shumën 300.000 lekë, pra nuk është deklaruar gjendja *cash* në shumën 21.000 USD.

ç. Në DPV-në e vitit 2010, ku subjekti ka deklaruar prenotimin e apartament 2+1, në rr. “J. M.” dhe pagesën e këstit të parë prej 35.000 euro, nuk ka deklaruar pagesën e këtij kësti me burim shumën 21.000 USD, burim të cilin e ka deklaruar për herë të parë në deklaratën *Vetting*.

Për të verifikuar ligjshmërinë e shumës prej 21.000 USD, Komisioni kreu veprimet e mëposhtme hetimore:

a. Nga verifikimi në faqen zyrtare të QKB-së²⁷, në regjistrin e shoqërisë “****” sh.p.k., rezulton se kjo shoqëri është regjistruar në datën 15.3.1999, me objekt “aktivitet minerar në nxjerrje, përpunim e pasurim të mineralit të kromit, etj.”. Me vendimin nr. ***, datë 13.7.2004, të asamblesë së ortakëve të shoqërisë, është kryer emërimi i z. I. Sh. si administrator i shoqërisë, ortak i vetëm i saj.

b. Pasi është kërkuar dokumentacioni financiar mbi fitimin e shoqërisë për vitin 2008, arkëtimin e shumës prej 21.000 USD, si dhe marrëdhëniet e punësimit, shoqëria “****” sh.p.k.²⁸ ka informuar se nuk disponon pasqyrat financiare për vitet 2008, 2009 dhe 2010 për shkak të kalimit të një periudhe shumë të hershme. Administratori i shoqërisë I. Sh. ka deklaruar se: “Duke qenë se vëllai im Bari Shyti ishte pa punë për shkak se u mbyll Gjykata e Bulqizës ku ai punonte si gjyqtar, i ofrova mundësinë që vetë me familjen e tij, apo duke organizuar një grup pune me shpenzimet e tij, të mblidhte mineral kromin, stokun e sterilëve të objektit tim minerar... Pasi është shitur nga shoqëria ‘****’ sh.p.k. nëpërmjet eksportit gjithë sasia e kromit, ku në sasinë e grumbulluar përfshihej edhe sasia e mbledhur nga vëllai, çmimi i shitjes, pasi janë zbritur detyrimet që rëndojnë mbi shoqërinë, i është paguar në *cash* në monedhën USD vëllait Bari Shyti, pasi kjo shumë është tërhequr nga llogaria ime në ‘Alpha Bank’ *cash*. Nuk mund të kujtoj me detaje shumën që i kam paguar, por shuma e deklaruar prej tij 21.000 USD,

²⁵ Shihni aktin në aneksin ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁶ Shihni listëpagesat e punonjësve dhe mandatpagesat e detyrimeve të paguara (sigurime shoqërore dhe TAP) në dokumentet e paraqitura nga subjekti, me pyetësorin nr. 2 dhe nr. 4.

²⁷ Shihni në *website*-n <http://www.qkr.gov.al/kërko/kërko-në-regjistrin-tregtar/kërko-për-subjekt/>.

²⁸ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. ECT prot., datë 21.6.2019, nga shoqëria “****” sh.p.k., dhe shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 10.10.2019, nga shoqëria “****” sh.p.k., në dosjen e Komisionit.

nga ku del se çmimi për (1) ton i takon të jetë 350 USD, është çmimi normal për kohën, që përfaqëson afërsisht edhe çmimin e blerjes së këtij minerali në tregun informal (treg ky mjaft i përhapur si në atë kohë edhe aktualisht”.

Gjithashtu janë vënë në dispozicion disa dokumente shkresore²⁹, nga analiza e të cilave shuma prej 21.000 USD nuk mund të konsiderohet si e ardhur e ligjshme, referuar fakteve si vijojnë: (i) subjekti rivlerësimi dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur një marrëdhënie punësimi të formalizuar me shoqërinë “***” sh.p.k.; (ii) bashkëshortja e subjektit, znj. E. Sh., figuron në listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi në shoqërinë “***” sh.p.k., në periudhën dhjetor 2007 – shtator 2008, me pagë minimale mujore, por nuk vërtetohet vlera e dokumentuar e punës për mbledhjen e 60 ton mineral kromi, për të cilën duhet të ishte paguar tatimi në burim; (iii) mungon fatura tatimore e eksportit që të tregojë shitjen e kromit në shumën 21.000 USD, e cila të jetë e konfirmuar nga organet tatimore për deklarimin dhe pagesën e detyrimeve fiskale.

Në lidhje me papajtueshmërinë e subjektit me detyrën si gjyqtar, për shkak të veprimtarisë së tij në aktivitetin tregtar të shoqërisë “*” sh.p.k.**

Me qëllim evidentimin e faktit nëse subjekti ka qenë në papajtueshmëri me detyrën e tij si gjyqtar, Komisioni kreu verifikimet, si vijojnë:

a. Subjektit iu kërkuan sqarime, i cili, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, deklaroi se *në periudhën shtator 2007 – nëntor 2008 nuk e ka ushtruar detyrën e gjyqtarit, për arsye se në shtator të vitit 2007 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Bulqizë u suprimua me vendim të KLD-së dhe gjyqtarëve të kësaj gjykate iu ndërpre ushtrimi i funksionit të gjyqtarit, duke përfutur pagesën vetëm për 1 vit. Në këto kushte, dhe kur rikthimi në sistemin gjyqësor shihej gati i pamundur, dhe kur nuk ushtronte asnjë funksion tjetër publik, ishte angazhuar familjarisht në mbledhjen e kromit, ku gjatë viteve 2007 - 2008 kishte mbledhur një sasi prej rreth 60 ton krom, sasi të cilën ia kishte dhënë vëllait të tij dhe kishte marrë në këmbim shumën prej 21.000 USD. Kjo shumë ka rezultuar nga çmimi i tregut, pasi janë zbritur detyrimet tatimore dhe çdo detyrim tjetër deri në momentin e daljes për eksport.*

b. Me kërkesë të Komisionit, KLGJ-ja³⁰ ka informuar se *KLD-ja, me vendimin nr. 215/2, datë 30.8.2007, ka vendosur sistemimin e gjyqtarëve të gjykatave që suprimohen, të cilëve do t’u paguhet paga që marrin në datën 1.9.2007, për një periudhë 1-vjeçare. Z. Bari Shyti, për periudhën 1.9.2007 – 31.12.2008 është paguar nga ZABGJ-ja në shumën 1.336.000 lekë bruto. Ndërkohë që KLGJ-ja nuk ka dhënë vlerësimin e saj sa i takon kufizimeve që mund të kishin këta gjyqtarë në lidhje me angazhimet për të siguruar të ardhura të tjera.*

c. Në nenin 143 të Kushtetutës së Shqipërisë, parashikohet se: *“Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, politike ose private”.* Po kështu, në nenin 22 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, parashikohet se: “Gjyqtari nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër shtetërore, private ose politike”.*

²⁹ Faturë tatimore nr. ***, me TVSH, datë 31.7.2008, për shitjen e 450 ton krom nga shoqëria “***” sh.p.k.; deklaratë doganore datë 31.7.2008, për eksportimin e 450 ton krom nga shoqëria “***” sh.p.k.; *statement* nga “Alpha Bank”, ku pasqyrohet arkëtimi nga shitja e 450 ton krom; 9 fletëhyrje magazine, ku tregohet se znj. E. Sh. ka dorëzuar në stokun e shoqërisë “***” sh.p.k. 60 ton krom nga muaji prill deri në korrik të vitit 2008; 5 mandatpagesa nga shoqëria “***” sh.p.k., për znj. E. Sh. nga muaji prill deri në dhjetor të vitit 2008, në total në shumën 21.000 USD; *statement* të llogarisë në USD të shoqërisë “***” sh.p.k. te “Alpha Bank” nga muaji prill deri në dhjetor të vitit 2008 (kur janë paguar 21.000 USD subjektit), ku tregohet se nga kjo llogari janë kryer tërheqje *cash* në shumën rreth 170.000 USD; shkresë nga DRT-ja Bulqizë, që vërteton se shoqëria “***” sh.p.k. është kontrolluar në datën 20.11.2008, për TVSH, sigurime shoqërore etj., për periudhën 1.1.2006 – 30.10.2008, dhe tatim fitimi për periudhën 1.1.2006 – 31.12.2007.

³⁰ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 27.9.2019, nga KLGJ-ja, në dosjen e Komisionit.

Konstatime në lidhje me burimin: 21.000 USD nga grumbullimi dhe shitja e 60 ton krom

Në përfundim të hetimit administrativ, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për konstatimet, duket se:

a. Subjekti rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion burimin e ligjshëm të të ardhurave në shumën 21.000 USD.

b. Në asnjë prej DPV-ve nuk është deklaruar ky burim për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi, sipas detyrimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar. Ky burim është deklaruar për herë të parë në deklaratën *Vetting*, dhe konkretisht pretendohet të jetë përdorur për pagimin e këstit të parë prej 35.000 euro, paguar në datën 12.3.2010. Ndërkohë, kjo shumë nuk është deklaruar si gjendje *cash* në fund të vitit 2008 dhe as në vitin 2009.

c. Në DPV-në e vitit 2010 nuk është deklaruar pagesë kësti për blerjen e pasurisë apo pakësim likuiditeti në shumën 21.000 USD.

ç. Për këto arsye, shuma 21.000 USD nuk është përfshirë si e ardhur e ligjshme në analizën financiare.

d. Duket se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar aktivitet privat në kundërshtim me nenin 143 të Kushtetutës, sipas të cilit: *“Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, politike ose private”* dhe ligjin nr. 9877, datë 18.2.2008, *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, pasi në periudhën 2007 – 2008, kur edhe pse Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka qenë e suprimuar, subjekti ka pasur statusin e gjyqtarit dhe është paguar nga ZABGJ-ja, ndërkohë që ka siguruar edhe të ardhura nga mbledhja e kromit në shumën 21.000 USD.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

Në parashtrimet e tij të datës 13.10.2020, subjekti ka prapësuar, si vijon:

a. Në lidhje me burimin e ligjshëm të shumës 21.000 USD, ka dhënë sqarime të detajuara, të cilat mbeten në nivel deklarativ, pasi nuk ka vënë në dispozicion asnjë dokument që provon pagimin e rentës minerare³¹ për sasinë 60 ton të kromit të shitur shoqërisë “****” sh.p.k., si dhe pagesën e tatimit në burim për të ardhurat e përfuara nga puna e kryer në lidhje me mbledhjen e kromit. Për më tepër, mbetet i paqartë shkaku i pagimit të kësaj shume bashkëshortes së subjektit në *cash*, ndërkohë që sipas subjektit vlera e plotë nga kromi i eksportuar është lëvruar në llogarinë bankare të shoqërisë “*****” sh.p.k.

b. Për sa i takon mosdeklarimit në DPV të shumës 21.000 USD, si burim krijimi i pasurisë objekt shqyrtimi, si dhe mosdeklarimit të saj si gjendje *cash* në fund të vitit 2008 dhe në vitin 2009 subjekti ka sqaruar se: *“Kjo e ardhur është deklaruar në DPV-në e vitit 2008 dhe është përdorur si burim për pagimin e këstit të parë prej 35.000 euro të apartamentit në Tiranë. Fakti që nuk është deklaruar në DPV-në e vitit 2009, apo nuk është shprehur si burim për pagimin e këstit të parë të apartamentit në Tiranë në DPV-në e vitit 2010, mund të përbëjë pasaktësi, por nuk mund ta zhvlerësojë si burim të ligjshëm të ardhurave”*. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pretendon se e ardhura prej 21.000 USD është plotësisht e ligjshme dhe duhet të përfshihet në analizën financiare të vitit 2010.

³¹ Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare” i ndryshuar, parashikon pagesën e rentës minerare, e cila për kromin është në masën 6 % mbi vlerën e shitjes dhe në rastin e eksportit ajo paguhet në kohën kur bëhet deklarata e eksportit.

Pas riçeljes së hetimit administrativ, me vendimin nr. 3, datë 19.10.2020, të trupit gjykues, u kryen veprimet hetimore, si vijojnë:

a. Subjektit iu kërkua të provojë: (i) pagesën e rentës minerare sipas ligjit nr. 7796, datë 17.2.1994, nga shoqëria “****” sh.p.k. në momentin e eksportimit të sasisë prej 449,65 ton krom në datën 31.7.2008; (ii) pagesën e tatimit në burim për shumën 21.000 USD, dhënë bashkëshortes së tij gjatë vitit 2008 nga shoqëria “****” sh.p.k., sipas mandatpagesave të vëna në dispozicion.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka sqaruar se: “... të ardhurat e shoqërisë ‘***’ sh.p.k., të siguruara nga shitja e kromit, janë të ardhura të tatuara; nuk rezulton që shoqëria të ketë detyrime tatimore apo taksa të papaguara³². Gjithashtu, shoqëria e ka paguar rentën minerare të kryer në momentin e eksportimit, pasi kromi nuk mund të eksportohej pa u paguar kjo rentë”. Subjekti ka paraqitur dokumente që provojnë pagesën e rentës minerare³³.

Nga disa përllogaritje të prezantuara nga subjekti, ai pretendon se shuma 21.000 USD, e marrë prej tij *cash*, ka qenë *neto* dhe e zhveshur nga çdo lloj detyrimi, pasi ato janë paguar nga shoqëria “****” sh.p.k., e cila ka pasur detyrimin për pagesën e tatimit mbi këto të ardhura. Gjithashtu, subjekti prapëson se, megjithëse është paguar tatimi në burim për shumën 21.000 USD, ligji nuk parashikon pagesën e këtij tatimi në këtë rast³⁴.

b. Me qëllim një vlerësim sa më objektiv dhe ligjor të pretendimeve të subjektit, Komisioni kërkoi interpretim të bazës ligjore nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë³⁵. Me shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 21.1.2021, ky institucion ka bërë një interpretim të ligjit nr. 8437, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, dhe pikërisht të nenit 33, i cili përcakton rastet kur mbahet tatimi në burim. Gjithashtu, ky institucion i referohet gërmës “c” të pikës 5.2, të udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006, të Ministrisë së Financave, ku përcaktohen ato raste kur nuk mbahet tatim në burim. Në konkluzion të kësaj shkrese, DPTT-ja shprehet se: “Referuar shkresës suaj për të ardhurat e përfituara nga individët nga grumbullimi i kromit (60 ton), nuk do të mbahej tatim në burim, por ata duhet të regjistroheshin në gjykatë për ushtrimin e aktivitetit sipas përcaktimeve në dispozitat e ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999, ‘Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë’, neni 30, ‘Pajisja me certifikatë tatimore’, pika 2, germa ‘b’, në të cilën citohet: ‘Personat juridikë dhe fizikë me qarkullim vjetor nën kufirin e regjistrimit për TVSH-në duhet të paraqesin vendimin e gjykatës që miraton regjistrimin e tyre dhe informacione kontakti për çdo përfaqësues të tatimpaguesit”.

Nga informacioni si më sipër, duket se subjekti dhe/ose bashkëshortja e tij do duhet të ishin të regjistruar në gjykatë, në mënyrë që të ardhurat nga shitja e kromit të konsideroheshin të ligjshme.

Konstatime në lidhje me burimin 21.000 USD, në përfundim të hetimit administrativ shtesë

Bazuar në të gjitha dokumentet dhe provat shkresore të administruara gjatë hetimit administrativ shtesë, edhe në përfundim të këtij hetimi shuma prej 21.000 USD nuk është konsideruar si e ardhur e ligjshme, e përdorur si burim për blerjen e pasurisë apartament banimi

³² Subjekti i referohet shkresës nr. *** prot., datë 18.1.2012, administruar në dosjen e Komisionit, e cila përmban raportin e kontrollit të kryer për shoqërinë “****” sh.p.k., nga DRT-ja Dibër në datën 16.12.2011. Ky raport, midis të tjerash, jep informacion se detyrimet e lindura për vitin 2008 janë të shlyera nga ana e shoqërisë.

³³ Shihni në dosjen e Komisionit ekstrakt të llogarisë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k., në “Raiffeisen Bank”, ku evidentohet se në datën 10.10.2008 është paguar renta minerare për faturën nr. ***, datë 31.7.2008, për llogari të DRT-së Dibër.

³⁴ Subjekti i referohet ligjit nr. 9161, datë 18.12.2003, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”, dhe pikërisht nenit 33, në të cilin sipas subjektit, marrëdhënia ndërmjet tij dhe bashkëshortes me shoqërinë “****” sh.p.k. nuk përfshihet në asnjë nga rastet e parashikuara në këtë nen, d.m.th. që ky nen nuk përcakton detyrim për pagesën e tatimit në burim nga shoqëria “****” sh.p.k. për shitblerjen e mallit prej 60 ton krom.

³⁵ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 14.12.2020, dërguar nga Komisioni.

në Tiranë në vitin 2010, referuar fakteve dhe provave, si vijojnë: (i) subjekti dhe/ose bashkëshortja e tij nuk rezulton të jenë regjistruar në gjykatë për ushtrim të aktivitetit privat të mbledhjes së kromit; (ii) subjekti nuk e ka deklaruar këtë shume si gjendje *cash* në DPV-të e viteve 2008 dhe 2009, sipas detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003.

Për rrjedhojë, shuma prej 21.000 USD, ashtu sikurse ishte konstatuar edhe gjatë hetimit administrativ më parë, duket se nuk mund të këtë shërbyer: (i) si e ardhur e ligjshme në analizën financiare të kryer për vitin 2008, e cila mbetet me një balancë negative prej 538.409 lekësh; si dhe (ii) si burim për blerjen e pasurisë apartament banimi në Tiranë në vitin 2010, pasi në momentin e blerjes së pasurisë subjekti mbetet me një balancë negative prej 5.065.229 lekësh³⁶.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e këtij konstatimi.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas hetimit administrativ shtesë dhe vlerësimi përfundimtar i Komisionit

a. Për sa i takon ligjshmërisë së burimit të shumës 21.000 USD, edhe në parashtrimet e dyta të datës 20.3.2021, subjekti nuk arriti të vërtetojë të kundërtën e barrës së provës dhe, për rrjedhojë kjo shumë nuk u konsiderua si e ardhur e ligjshme që ka shërbyer si burim për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi, referuar fakteve si vijojnë:

i) Subjekti dhe/ose bashkëshortja nuk janë regjistruar në gjykatë për ushtrimin e e aktivitetit të mbledhjes së 60 tonëve krom, sikurse përcaktohet nga ligji, veprim i cili do ta kualifikonte shumën 21.000 USD si të ardhur të ligjshme.

ii) subjekti nuk arriti të justifikojë bindshëm arsyet e mosdeklarimit të kësaj shume të marrë *cash* nga shoqëria “****” sh.p.k., në vitin 2008, të pretenduar të mbartur *cash* në DPV-në për vitet 2008 dhe 2009 dhe përdorur në vitin 2010. Konkretisht, në të dyja parashtrimet, subjekti ka pretenduar se në DPV-në e vitit 2008 nuk ka deklaruar likuiditetin *cash* prej 21.000 USD, pasi e kishte deklaruar si të ardhur. Ndërkohë, neni 4 i ligjit nr. 9049/2003 parashikon detyrimet e subjekteve për të deklaruar të ardhurat dhe pasuritë e çdolloji, si gjendjet e likuiditeteve *cash*, llogari rrjedhëse depozitë, huadhënie etj. Ndërsa në DPV-në e vitit 2009, subjekti ka pretenduar se nuk e ka deklaruar likuiditetin *cash*, për shkak se ka menduar që duhet të deklaronte vetëm shtesat dhe pakësimin e likuiditeteve, pretendim i cili do të qëndronte në rastin kur subjekti do të kishte deklaruar gjendjen e likuiditetit *cash* në DPV-në e vitit 2008, gjë që nuk e ka bërë. Në vijim të qasjes së subjektit dhe logjikës që përdor në argumentim, edhe nëse do të merrej e mirëqenë që në fund të vitit 2009 subjekti e ka pasur likuiditetin *cash* në vlerën 21.000 USD, në DPV-në e vitit 2010, subjekti nuk ka deklaruar sipas ligjit pakësimin e këtij likuiditeti për shkak të pagesës së kështit prej 35.000 euro për blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi. Për më tepër, likuiditeti në shumën 21.000 USD nuk është përmendur në këtë deklaratë si burim i përdorur për pagimin e kështit 35.000 euro, burim i cili është deklaruar për herë të parë në deklaratën *Vetting*. Për këto arsye gjendja *cash* është konsideruar nga Komisioni, sikurse është deklaruar në DPV-të ndër vite nga subjekti, pasi çdo pretendim i paraqitur gjatë procesit të rivlerësimit mbetet në nivel deklarativ.

Në vijim të sa më sipër, Komisioni arsyeton se jo me kot ligji nr. 9049/2003 në nenin 4 të tij, ka parashikuar detyrimin e subjekteve për të deklaruar likuiditetet në bankë dhe *cash* në fund të çdo viti, e në vijim shtesat dhe pakësimet e tyre. Deklarimet periodike vjetore do të përbënin të vetmen mënyrë verifikimi dhe vërtetimi që subjekti e ka pasur likuiditetin në shumën 21.000

³⁶ Në analizën përfundimtare kjo balancë bëhet -5.465.229 lekë, për shkak të përfshirjes si shpenzim të shumës prej 400.000 lekësh, vëllait H. Sh. për depozitën dyemërore.

USD në momentin e pagimit të kështit prej 35.000 euro në datën 12.3.2010, qëndrim i konsoliduar edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, për çështjet e deklaramit *cash*, shtesave dhe pakësimeve³⁷. Po kështu, vetëm në rastin kur subjekti do të plotësonte në mënyrë akumulative dy kushte, së pari të vërtetonte legjitimitetin e shumës 21.000 USD, deklaruar si e ardhur në DPV-në e vitit 2008 dhe së dyti, të kishte kryer deklarime të sakta në lidhje me gjendjen e likuiditetit *cash* prej 21.000 USD në DPV-në e viteve 2008 dhe 2009 dhe pakësimin e tij në vitin 2010, kjo shumë do të konsiderohej si burim i ligjshëm në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Për të gjitha sa më sipërshtetuar, në përfundim të procesit, Komisioni çmoi se subjekti ka kryer deklarime të pasakta e të pamjaftueshme në lidhje me shumën 21.000 USD, e cila nuk u konsiderua burim i ligjshëm për blerjen e pasurisë apartament banimi me nr. pasurie ***, në rrugën “J. M.” Tiranë.

b. Për sa i takon konstatimit se subjekti ka ushtruar aktivitet në kundërshtim me nenin 143 të Kushtetutës sipas të cilit “*Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, politike ose private*” në parashtrimet e datës 13.10.2020, subjekti është përpjekur të argumentojë mungesën e një konflikti interesi në ushtrim të detyrës së tij, ndërkohë që konstatimi i Komisionit lidhet me papajtueshmërinë me ushtrimin e funksionit, sipas parashikimit në nenin 143 të Kushtetutës. Subjekti vijon të pretendojë se gjatë periudhës që ka siguruar të ardhurat nga mbledhja dhe shitja e kromit në vitin 2008 pa pasur një licencë apo leje për ushtrim aktiviteti privat, nuk ushtronte efektivisht funksione gjyqësore për shkak se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Bulqizë, ku ushtronte funksionin e magjistratit u suprimua, duke i siguruar vetëm një vit pagë dhe, sipas tij, perspektiva e rikthimit në detyrë dukej e zyrtë. Në këto kushte, sipas subjektit, duke pasur parasysh edhe faktin që kromi ishte një mineral me shumë vlerë në atë periudhë dhe gjendej lehtësisht në sipërfaqe pranë minierave, nuk mund të mos e shfrytëzonte këtë mundësi, ashtu si pothuaj gjithë popullsia e zonës.

Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, pavarësisht se subjekti nuk e kishte humbur statusin e gjyqtarit në vitin 2008, Komisioni i çmoi bindëse argumentet e tij dhe vlerësoi se subjekti i rivlerësimit do të kishte vepruar në kundërshtim me nenin 143 të Kushtetutës, nëse do të ishte duke ushtruar detyrën e gjyqtarit. Në vitin 2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka qenë e suprimuar dhe subjekti ka pasur formalisht statusin e gjyqtarit duke u paguar me pagë të pjesshme nga ZABGj-ja, pra, nuk e ka ushtruar *de jure* profesionin e gjyqtarit. Në këto kushte, fakti që subjekti ka siguruar të ardhura nga mbledhja e kromit gjatë vitit 2008, aq më tepër në kushtet kur subjekti nuk u vërtetua të ketë ushtruar aktivitet të licencuar në të njëjtën kohë që ka pasur formalisht statusin e gjyqtarit, nuk u konsiderua nga Komisioni si veprimtari që bie ndesh me ligjin dhe, për pasojë, nuk përbën shkak për penalizim të subjektit.

2.6.2. Burimi i krijimit: kursime nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes për periudhën 1.2007 – 12.2012

Referuar deklaramive të subjektit në DPV-në për këto vite, gjendja e kursimeve me të ardhurat nga pagat për këtë periudhë ka qenë në shumën 1.050.000 lekë. Në përfundim të hetimit administrativ, referuar analizës financiare të viteve 2009 – 2012 (pasi në vitet 2007 dhe 2008 subjekti dhe bashkëshortja nuk kanë deklaruar kursime *cash*), duket se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur mundësi që të krijojnë kursimet dhe të mbulojnë shpenzimet e kryera gjatë kësaj periudhe, për shkak të balancave negative pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën vijuese³⁸.

³⁷ Vendimet (JR): nr. 7/2019, datë 5.4.2019; nr. 11/2019, datë 22.5.2019; nr. 20/2019, datë 31.7.2019.

³⁸ Në analizën financiare nuk janë përfshirë të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga shitja e pjesës takuese të subjektit të apartamentit në Durrës, në shumën 18.500 euro të vëllai i subjektit, z. I. Sh..

Përshkrimi	2009	2010	2011	2012
Pasuri	456 094	5 737 179	1 843 413	5 397 458
Apartament, lagjja “****”, Durrës				4 191 600 ³⁹
Apartament dhe garazh rruga “J. M.”, Tiranë, datë 18.3.2010		4 858 350 ⁴⁰	4 840 500 ⁴¹	1 397 200 ⁴²
SHTESA/PAKËSIM/LIKUIDITETE	456 094	878 829	-2 997 087	-191 342
Detyrime	0	0	0	4 191 600
Detyrim financiar ndaj vëllait I. Sh. për vlerën e apartamentit në Durrës, vlera: 30.000 euro				4 191 600 ⁴³
Pasuri neto (1-2)	456 094	5 737 179	1 843 413	1 205 858
Të ardhura	1 067 484	1 355 050	1 372 040	1 599 653
Të ardhura nga pagat, subjekti i rivlerësimit	946 450	990 390	1 145 068	1 326 305
Të ardhura nga pagat, bashkëshortja	63 641	216 885	226 972	249 883
Të ardhura nga interesat bankare	57 393	147 775		23 465
Shpenzime	1 112 998	683 100	1 015 847	831 171
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	683 100	683 100	683 100	705 120
Shpenzime për rivlerësimin e ap. në Bulqizë			26 441	
Shpenzime udhëtimi	429 898	0	306 306	126 051
Mundësia për kursime	-501 608	-5 065 229	-1 487 220	-437 376

Pasi subjektit i kaloi barra e provës, për të vërtetuar të kundërtën e këtyre konstatimeve, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, në parashtrimet e tij ka kundërshtuar këtë analizë financiare, duke ngritur pretendime, disa prej të cilave janë marrë në konsideratë. Konkretisht:

- i) Subjekti ka pretenduar se huaja në shumën 5.000 euro, marrë nga shtetasi P. L., është vërtetuar të jetë me të ardhura të ligjshme të këtij shtetasi, pretendim i cili qëndron⁴⁴ dhe për këtë shkak kjo shumë është përfshirë si e ardhur e ligjshme.
- ii) Subjekti ka pretenduar se në janar të vitit 2011 i janë paguar interesa nga “Tirana Bank” në shumën 194,955 lekë, pretendim i cili qëndron, pasi u verifikuan të dhënat bankare. Për këtë arsye, kjo shumë u përfshi si e ardhur e ligjshme.
- iii) Subjekti ka pretenduar reduktimin e shpenzimeve të jetesës në shumën 130.000 lekë për shkak të përdorimit të tokës bujqësore gjatë vitit 2012. Duke marrë në cilësinë e provës DPV-në e vitit 2012, në të cilën janë deklaruar të ardhura nga toka bujqësore në këtë shumë, në analizën e rishikuar, shpenzimet e jetesës për këtë vit janë reduktuar në këtë masë⁴⁵.
- iv) Subjekti ka pretenduar reduktimin e shpenzimeve të udhëtimeve sipas sistemit *TIMS* për vitin 2009, pretendim i cili është marrë në konsideratë, duke u reduktuar shpenzimet e udhëtimit përgjatë këtij viti nga shuma 429.898 lekë në shumën 224.143 lekë⁴⁶.

³⁹ Në shumën 30.000 euro, konvertuar në lekë sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2012.

⁴⁰ Në vitin 2010 sipas dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ është paguar shuma prej 35.000 euro, kësti i parë, konvertuar në lekë sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2010.

⁴¹ Në vitin 2011 sipas dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ është paguar shuma prej 35.000 euro, kësti i dytë prej 25.000 euro dhe shuma prej 10.000 euro e paguar me mandatin e datës 6.7.2011, konvertuar në lekë sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2011.

⁴² Në vitin 2012 sipas dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ është paguar shuma prej shuma 10.000 euro sipas mandatarëkëmit nr. ***, të datës 12.4.2012, konvertuar në lekë sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2012.

⁴³ Konvertuar në lekë sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2012.

⁴⁴ Trajtuar hollësisht në çështjen 3.2 të këtij vendimi.

⁴⁵ Trajtuar hollësisht në vijim në rubrikën *konstatime të tjera*, pika 2.2.

⁴⁶ Trajtuar hollësisht në vijim, në rubrikën *analiza financiare*, pika 7.

Veç sa më sipër, në analizën financiare të rishikuar pas riçeljes së hetimit administrativ, krahasimisht me analizën e dërguar subjektit në rezultatet e hetimit administrativ, me ndihmën e Njësisë Ligjore nga Komisioni janë bërë ndryshimet si vijojnë:

- i) është përfshirë si shpenzim shuma prej 4.000 USD, paguar në vitin 2011, si detyrim ndaj vëllait I. Sh., për huan në vlerën 9.000 USD, deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2011⁴⁷;
- ii) është përfshirë si shpenzim shuma 2.500 euro, paguar në vitin 2012 si detyrim ndaj vëllait I. Sh., deklaruar në DPV-në e vitit 2012.

Ndërsa, në përfundim të procesit të rivlerësimit, në analizën përfundimtare të kësaj periudhe, është shtuar si shpenzim shuma edhe prej 800.000 lekësh, e cila përfaqëson pjesën e mbetur takuese të vëllait H. Sh. nga depozita dyemërore e investuar në vitin 2002. Ky shpenzim është ndarë në mënyrë të barabartë midis viteve 2010 dhe 2011, sikurse është deklaruar nga subjekti në seancën dëgjimore të datës 19.3.2021⁴⁸.

2.6.3. Burimi i krijimit: premtim shitje e pjesës 50% të apartamentit në lagjen *, Durrës, bashkëpronarit të pjesës 50%, z. I. Sh., kundrejt vlerës 18.500 euro**

Lidhur me këtë burim, ashtu sikurse është trajtuar në pasurinë në pikën 1 të këtij vendimi, apartament banimi në Durrës, subjekti në vitin 2005 ka porositur këtë apartament, bazuar në një marrëveshje të pashkruar për bashkëpronësinë në një të dytën pjesë të pandarë secili, me vëllain e tij I. Sh.. Po me marrëveshje të tyre, në vitin 2010, ½ pjesë e pandarë e pasurisë pronë e subjektit, do t'i kalonte z. I. Sh., kundrejt vlerës 18.500 euro, shumë e pretenduar të jetë paguar nga personi i lidhur I. Sh. në vitin 2010, por, nuk është administruar asnjë dokument shkresor që vërteton këtë fakt. Pikërisht, kjo shumë prej 18.500 euro është deklaruar nga subjekti si një nga burimet për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi, apartament banimi në Tiranë.

Bazuar në pikën 14 të nenit 3 dhe në pikën 3, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer hetime në lidhje me të ardhura të ligjshme të personit tjetër të lidhur I. Sh., me qëllim justifikimin e dhënies së shumës prej 18.500 euro subjektit të rivlerësimit në vitin 2010. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se vëllai I. Sh. që në vitin 1999 e deri aktualisht ka siguruar të ardhura nga emigracioni, të cilat nuk mund t'i dokumentonte.

Në përfundim të hetimit administrativ sa i takon burimit, vlera prej 18.500 euro dhënë nga z. I. Sh. si premtim shitje apartamenti në Durrës⁴⁹, duket se:

- a. nuk vërtetohet me dokumentacion shkresor dhënia e kësaj shume nga personi i lidhur I. Sh. si pagesë premtimi për blerjen e ½ pjesë takuese të subjektit të rivlerësimit mbi një apartament në Durrës, si dhe nuk vërtetohet kalimi i shumës në rrugë bankare ose jo në favor të subjektit të rivlerësimit;
- b. subjekti nuk e ka deklaruar këtë shumë në DVP si burim për pagimin e ndonjë kësti për blerjen e apartamentit;
- c. nuk vërtetohen me dokumentacion ligjor të ardhurat nga burime të ligjshme të personit të lidhur, z. I. Sh., për dhënien e shumës 18.500 euro, në vitin 2010;
- ç. për këto arsye shuma prej 18.500 euro nuk është konsideruar e ardhur e ligjshme në analizën financiare për vitin 2010.

⁴⁷ Trajtuar hollësisht në vijim, në pikën 2.6.4.

⁴⁸ Trajtuar hollësisht në vijim në pikën 2.6.5. të këtij vendimi.

⁴⁹ Pretenduar si burim i këstit për shumën 35.000 euro, paguar nga subjekti sipas aktit bankar në "Intesa Sanpaolo Bank", të datës 12.3.2010.

Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën e këtyre konstatimeve.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

Në parashtrimet e tij, dërguar në rrugë elektronike në datën 13.10.2020, ndonëse ka dhënë shpjegime të detajuara dhe ka paraqitur një deklaratë dore të vëllait I. Sh.⁵⁰, subjekti nuk ka vërtetuar të kundërtën e barrës së provës pasi: së pari, nuk vërtetoi dhënien e shumës prej 18.500 euro nga vëllai I. Sh. duke argumentuar se për shkak të marrëdhënies së posaçme midis dy vëllezërve, kjo shumë është dhënë *cash* me burim nga kursimet e tij, dërguar në Shqipëri nëpërmjet personave të ndryshëm; së dyti, ndonëse ka dhënë shumë shpjegime për mundësinë e vëllait të tij dhe familjes për të siguruar të ardhura në Belgjikë ku ai jeton prej vitit 2000, nuk ka paraqitur asnjë dokument shkresor që të vërtetojë të ardhura të ligjshme të këtij shtetasi në shtetin belg.

Sa i takon mosdeklarimit në DPV-në e vitit 2010, të shumës 18.500 euro, si burim për pagimin e një pjese të kështit për blerjen e apartamentit, subjekti është fokusuar dhe ka argumentuar në lidhje me deklarimin e kësaj shume si të ardhur për shkak të marrëveshjes me vëllanë. Në fakt, nga verifikimi i DPV-në e vitit 2010, subjekti nuk e ka deklaruar këtë shumë në rubrikën të ardhura. Po kështu, mungon të ketë pasur një dokument shkresor në kohë reale që të vërtetojë faktin e dhënies së kësaj shume nga z. I. Sh.. Por, pavarësisht këtyre fakteve, Komisioni nuk e ka mohuar të ardhurën në shumën 18.500 euro, pasi subjekti ka deklaruar në DPV-në për vitin 2010 shitjen e 50% pjesë takuese nga ana e të vëllait I. Sh., në vlerën 18.500 euro. Kështu, në një kuptim, subjekti e ka deklaruar këtë shumë si të ardhur, por, nuk e ka deklaruar këtë shumë si burim për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi, sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049, sipas të cilit subjekti ka pasur detyrimin të deklarojë burimin e krijimit të çdo pasurie, në rastin konkret, burimin për pagesën e kështit prej 35.000 euro, në vitin 2010. Këtë burim e ka deklaruar vetëm në deklaratën *Vetting*. Nga ana tjetër nuk ka vërtetuar ligjshmërinë e krijimit të kësaj të ardhure. Për këto arsye, shuma prej 18.500 euro, nuk është përfshirë si e ardhur ligjore në analizën përfundimtare financiare.

Sa i takon pretendimit se marrëdhënia e tij me vëllain I. Sh. nuk është një marrëdhënie huaje apo dhurimi, e për këtë shkak, nuk i takon barra e provës për të vërtetuar burimin e të ardhurave të bashkëpronarit që pranon të blejë pjesën e tij takuese, Komisioni e ka vlerësuar si të pabazuar duke konsideruar vëllain e subjektit të rivlerësimit si person tjetër të lidhur sipas nenit 3, pika 14, të ligjit nr. 84/2016 (arsyetuar gjerësisht në pikën 1.6 të vendimit).

Sa më sipër, në përfundim të procesit të rivlerësimit, shuma prej 18.500 euro, deklaruar si burim për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi në deklaratën *Vetting*, nuk justifikohet me të ardhura të ligjshme, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit D, të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, pasaktësia në deklarimin për vitin 2010, për shkak të mosdeklarimit të këtij burimi, mer një peshë specifike të posaçme e me ndikim, në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

2.6.4. Burimi i krijimit: kontratë huaje me z. I. Sh. për shumën 9.000 USD, datë 13.12.2011

Me kontratë huaje nr. ***, datë 15.8.2011, shtetasi Bari Shyti ka marrë hua shumën 9.000 USD pa interes nga vëllai i tij I. Sh., për ta përdorur për blerjen e apartamentit⁵¹. Afati i huas është dy vjet dhe fillon nga data 30.6.2011, datë në të cilën është dorëzuar shuma. Ndërkohë sipas mandatarkëtimit nr. ***, datë 6.7.2011, një javë më vonë, z. Bari Shyti ka derdhur në këtë datë

⁵⁰ Shihni dokumentet bashkëngjitur parashtrimeve të datës 13.10.2021, në dosjen e Komisionit.

⁵¹ Shihni aktet në aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së.

shumën 10.000 euro, në favor të shoqërisë ndërtuese, me burim huan në shumën 9.000 USD ose 945.720 lekë marrë nga vëllai I. Sh.. Vërehet se ka një mospërputhje në deklaratën *Vetting* dhe në kontratën e huas sa i takon datës së deklaruar 13.12.2011 dhe datës së kontratës së huas 15.8.2011. Subjektit i është kërkuar të japë sqarime lidhur me këtë mospërputhje, por ai nuk ka dhënë.

Në lidhje me këtë hua, nga deklaratimet periodike konstatohet se:

a. Në DVP-në e vitit 2011 subjekti ka deklaruar: “9.000 USD marrë hua në datën 1.7.2011 për të shlyer këstin e tretë të shtëpisë. Kjo shumë është marrë hua pa interes me afat kthimi 2 vjet”. Më tej, në gjendjen e detyrimit të mbetur pa shlyer deri në fund të vitit 2011, subjekti ka deklaruar shumën 5.000 USD, por pa deklaruar emrin e huadhënësit. Pra, gjatë vitit 2011, sipas deklaratimeve të subjektit duket se është shlyer shuma prej 4.000 USD. Nga analiza financiare e vitit 2011, ky vit është me balancë negative dhe, për rrjedhojë, subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për shlyerjen e kësaj shume.

b. Në DPV-në e vitit 2014 është deklaruar: “... shitje pasurie apartament 2+1 në lagjen e Re Bulqizë në vlerën 3.650.000 lekë. Pasuria është krijuar në vitin 2003. Nga shitja e kësaj pasurie janë shpenzuar gjatë vitit 2014, 3 milionë lekë për shlyerje huaje I. Sh. dhe 550.000 lekë shlyer totalisht huaja prej 5.000 USD I. Sh.”. Kjo shumë është vërtetuar të jetë shlyer në rrugë bankare në “Raiffeisen Bank”.

Siç vërehet, për shlyerjen e shumës 550.000 lekë subjekti ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në shumën 3.650.000 lekë, në tetor të vitit 2014, në Bulqizë, nga të cilat 3.000.000 lekë ia ka dërguar vëllait tjetër I. Sh., si pagim kësti detyrimi (trajtuar më sipër, pasuria nr.1) dhe 550.000 lekë, i ka kaluar në rrugë bankare në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k., me administrator I. Sh., në datën 29.12.2014, me përshkrim “shlyerje borxhi”. Referuar këtij fakti, si dhe faktit që analiza financiare për vitin 2014 është me balancë pozitive, Komisioni ka vlerësuar që subjekti ka pasur mundësi që ta shlyejë këtë pjesë të huas në shumën 550.000 lekë, me të ardhura të ligjshme.

Bazuar në pikën 14 të nenit 3 dhe në pikën 3, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka hetuar në lidhje me të ardhura të ligjshme të z. I. Sh. për dhënien e huas. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se z. I. Sh. ushtron aktivitet tregtar në nxjerrjen dhe tregtimin e mineralit të kromit që prej vitit 2007 në bazë të lejes minerale nr. ***, datë 10.10.2006, kështu që burimi i të ardhurave për këtë shumë vjen nga ky aktivitet tregtar. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka depozituar vetëm pasqyrat financiare të shoqërisë “****” sh.p.k. të viteve 2010-2011, nga ku rezulton se kjo shoqëri nuk ka shpërndarë dividend nga fitimi i saj në vitet 2010-2011.

Në përfundim të hetimit administrativ, subjektit i kaloi barra e provës, duket se: (i) nuk provohen me dokumentacion ligjor të ardhura nga burime të ligjshme të personit tjetër të lidhur, z. I. Sh., për dhënien e huas në shumën 9.000 USD; (ii) subjekti nuk ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për të shlyer shumën prej 4.000 USD në vitin 2011.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

Së pari, në parashtrimet e datës 13.10.2020, subjekti nuk ka vërtetuar të kundërtën e barrës së provës në lidhje me burimin e ligjshëm të huas prej 9.000 USD. Ai ka pretenduar se si burim i kësaj shume kanë shërbyer të ardhura të shoqërisë “****” sh.p.k., ku vëllai i tij, z. I. Sh., ka qenë njëherësh administrator dhe ortak i vetëm, të cilit për shkak të marrjes së kësaj shume nga arka e shoqërisë i ka lindur detyrimi ndaj shoqërisë, detyrim i cili do të duhej të pasqyrohej edhe në bilancin e vitit 2011. Këto pretendime mbeten në nivel deklarativ pasi në dokumentet e paraqitura prej z. I. Sh., gjendet vetëm pjesa e bilancit 2011 - 2012 “Pasivi dhe Kapitali”, ndërsa në faqen zyrtare të QKR-së nuk gjendet bilanci i vitit 2011.

Pas riçeljes së hetimit administrativ, në pyetësonin nr. 4, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion të mëtejshëm mbi të ardhura të vëllait I. Sh. dhe familjes së tij deri më 30.6.2011, moment kur është dhënë huaja. Në përgjigje të këtij pyetësoni, subjekti ka vijuar të pretendojë se si burim për dhënien e kësaj huaje kanë shërbyer të ardhurat nga aktiviteti tregtar i shoqërisë, e cila gjatë vitit 2011 ka gjeneruar të ardhura *cash* nga arkëtimet e klientëve, në shumën 34.991.154 lekë, si dhe kursimet familjare të vëllait dhe të ardhura nga toka bujqësore në pronësi të tij. Për të vërtetuar këto pretendime, subjekti ka vënë në dispozicion disa dokumente për të vërtetuar të ardhurat e familjes së vëllait të tij⁵², ndërkohë që nuk ka paraqitur një bilanc të plotë të shoqërisë “****” sh.p.k. për vitin 2011.

Në vijim, subjektit iu dha edhe një herë mundësia për të vërtetuar burimin e ligjshëm të huas në shumën 9.000 USD, duke iu kërkuar të vërë në dispozicion: (i) bilancin e plotë dhe librat e kontabilizimit të arkës për vitin 2011, të shoqërisë “****” sh.p.k.; (ii) dokumente që vërtetojnë të ardhura të tjera familjare të huadhënësit I. Sh.; (iii) dokumente që vërtetojnë të ardhura nga toka bujqësore të z. I. Sh.. Në përgjigje të pyetësonit nr. 5, subjekti vijon të pretendojë se shumën prej 9.000 USD vëllai e ka marrë nga arka e shoqërisë dhe ka paraqitur dokumentet si vijojnë:

a. bilancin e plotë të viteve 2010 dhe 2011 të shoqërisë “****” sh.p.k., vulosur nga DRT-ja Dibër më 21.1.2021. Lidhur me librat e kontabilizimit të arkës, subjekti deklaroi se nuk është ruajtur ky dokumentacion nga shoqëria pasi ka kaluar një periudhë 10-vjeçare dhe se regjistrat kontabël ruhen për një periudhë gati 5-6 vjeçare për efekt të organit tatimor dhe kontrollit prej tij;

b. dokumente mbi të ardhura të bashkëshortes së vëllait, znj. Sh. Sh.⁵³;

c. vërtetim mbi pronësinë e z. I. Sh. mbi sip. 4.750 m² tokë në ***, Fushë-Bulqizë⁵⁴.

Nga marrja në shqyrtim e këtyre dokumenteve, subjekti nuk ka vërtetuar të ardhura nga toka bujqësore prej z. I. Sh.. Po kështu, të ardhurat e ligjshme familjare të dokumentuara të vëllait I. Sh. për periudhën tetor 2007 deri 30.6.2011, janë në shumën 1.791.840 lekë, ndërkohë që shpenzimet për tre persona janë 1.536.975 lekë. Si rrjedhim, teprica prej 254.865 lekë nuk mjafton për dhënien e huas prej 9.000 USD.

Në prapësimet e tij, subjekti ka kërkuar që shpenzimet e jetesës të vëllait I. Sh. të reduktohen në masën 60.000 lekë në vit⁵⁵ duke u krijuar kështu një mundësi kursimi nga ana e tij të shumës 240.000 lekë, për periudhën 4-vjeçare 2007 – 2011. Ky pretendim nuk mund të merret në konsideratë, pasi nuk u vërtetuan të ardhura nga toka bujqësore të z. I. Sh. apo pagimi i taksës së tokës. Por, edhe nëse merret në konsideratë ky pretendim, personi tjetër i lidhur do të ishte në pamundësi financiare për të huazuar shumën 9.000 USD.

Sa i takon pretendimit se z. I. Sh. ka tërhequr shumën prej 9.000 USD nga arka e shoqërisë “****” sh.p.k., në vitin 2011 për t’ia huazuar subjektit, bazuar në të gjitha provat e administruara, rezultoi se: (i) arkëtimet e shoqërisë gjatë vitit janë në vlerën 34.991.154 lekë⁵⁶,

⁵² Listëpagesat e shoqërisë “****” sh.p.k. për vitet 2010-2011, ku evidentohet paga e administratorit I. Sh.; vërtetim nr. ***, datë 20.10.2020, mbi bazën e vlerësueshme nga ISSh-ja për të ardhurat nga pagat e z. I. Sh. për periudhën tetor 2007 – dhjetor 2011; mandatpagesa nga “Raiffeisen Bank”, ku vërtetohen pagesat e sigurimeve shoqërore dhe tatimet mbi të ardhurat për të punësuarit e shoqërisë “****” sh.p.k.

⁵³ Vërtetim nga ISSh-ja Bulqizë për pagën e viteve 2010 - 2011; vërtetim nr. *** prot., datë 18.1.2021, nga Bashkia Bulqizë për pension invaliditeti nga viti 2007 e në vijim; vërtetim nr. ***, datë 14.1.2021, nga ISSh-ja Bulqizë, ku rezultoi se shtetasja Sh. Sh. figuron e siguruar si e vetëpunësuar në bujqësi në periudhën 1993 – 2003.

⁵⁴ Shihni vërtetimin nr. *** prot., datë 15.1.2021, nga ASHK-ja Bulqizë, vënë në dispozicion me pyetësonin nr. 5.

⁵⁵ Subjekti i referohet aktit të vlerësimit të Ministrisë së Bujqësisë për vitin 2020 për tokën e tij dhe sipërfaqes së tokës së vëllait prej 4.750 m² ose rreth 1.000 m² më pak se ajo e subjektit. Nisur nga këto të dhëna, subjekti kërkon që të konsiderohet në analizën financiare të Komisionit për vëllain e tij I. Sh., të paktën ½ e të ardhurave që janë marrë nga toka e subjektit në vitin 2020 për periudhën 2007 – 2011 (4 vjet).

⁵⁶ Kjo e dhënë është e pasqyruar te pjesa e bilancit *pasqyra e fluksit monetar* zëri “mjete monetare të arkëtuara nga klientët”.

(ii) zëri “TVSH, debitore, kreditorë të tjerë” në bilancin e vitit 2011, është në vlerën 3.656.346 lekë. Por, nuk ka një provë që vërteton marrjen e huas nga z. I. Sh. në vlerën 9.000 USD nga arka e shoqërisë, si dhe shlyerjen e këtij detyrimi ndaj shoqërisë.

Bazuar në të gjitha sa më sipër, në përfundim të procesit, Komisioni vlerësoi se subjekti nuk ka vërtetuar burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e huas prej 9.000 USD nga personi tjetër i lidhur, z. I. Sh., në vitin 2011, referuar fakteve dhe provave si vijojnë:

i) Shoqëria “***” sh.p.k., nuk ka shpërndarë dividend gjatë vitit 2011.

ii) Nuk u vërtetuan të ardhura të tjera personale të familjes së z. I. Sh. të mjaftueshme për dhënien e huas.

iii) Nuk ka pasur asnjë provë konkrete që të vërtetojë marrjen e shumës prej 9.000 USD nga arka e shoqërisë prej z. I. Sh.. Fakti që shoqëria ka pasur të arkëtuara vlera të konsiderueshme monetare gjatë vitit 2011, si dhe fakti që zëri “TVSH, debitore, kreditorë të tjerë” në bilancin e vitit 2011, është gjithashtu në vlerë të konsiderueshme, nuk vërtetojnë që ky shtetas ka marrë nga arka e shoqërisë shumën 9.000 USD në formë huaje. Vetëm librat e kontabilizimit do të ishin prova që do të vërtetonin transaksionin financiar për shumën 9.000 USD, për të cilat subjekti pretendoi se nuk ka mundur t’i sigurojë për shkak të kohës së gjatë e që ka kaluar. Ky pretendim nuk qëndron, pasi, koha e ruajtjes së këtyre dokumenteve është 10 vjet pas mbylljes së vitit ushtrimor, pra periudha e ruajtjes se tyre, do të ishte fundi i vitit 2021⁵⁷.

Së dyti, lidhur me konstatimin mbi pamundësinë financiare të subjektit për të shlyer shumën prej 4.000 USD në vitin 2011, subjekti ka prapësuar se kjo pagesë është bërë nga kursimet e vitit 2011, të cilat kanë qenë në shumën 800.000 lekë shtuar edhe ato të mbartura nga viti 2010 në shumën 200.000 lekë. Pretendimet e subjektit nuk qëndrojnë, pasi nga verifikimi i DPV-ve për vitet 2010 dhe 2011, duket se më 31.12.2011 subjekti ka pasur gjendje *cash* në shumën 1.000.000 lekë⁵⁸ dhe, për këtë arsye, kjo shumë nuk mund të ketë shërbyer për të kthyer huan ndaj vëllait I. Sh. në shumën 4.000 USD gjatë vitit 2011, sikurse është deklaruar nga subjekti⁵⁹. Për rrjedhojë, kthimi i huas në shumën 4.000 USD, është pasqyruar si shpenzim në analizën financiare të vitit 2011, nga e cila duket se subjekti nuk ka pasur burime të mjaftueshme për të kryer këtë pagesë, pasi rezulton me balancës negative.

2.6.5. Burimi i krijimit: tërheqje depozite nga “Tirana Bank” në datën 21.1.2011, në shumën 3.203.000 lekë. Kjo depozitë në shumën 1.600.000 lekë është krijuar në vitin 2002 nga kursimet deri në datën 31.12.2001, shtuar me interesa dhe pagesa nga një pjesë e kursimeve. Pjesa takuese: 100%.

Sa i takon këtij burimi, gjatë hetimit administrativ, u vërtetua se: (i) në deklaratën për vitin 2003, subjekti ka deklaruar depozitë prej 1.600.000 lekësh në “Tirana Bank”, me burim kurime; (ii) sipas informacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së⁶⁰, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ⁶¹, në datën 21.1.2011, nga llogaria me nr. *** në emër të subjektit është tërhequr shuma 3.203.534 lekë, e cila është konvertuar në vlerën 23.000 euro po këtë datë. Pasi subjekti ka depozituar *cash* në këtë llogari dhe shumën

⁵⁷Referuar ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 17, i cili përcakton se afatet e ruajtjes së regjistrave kontabël dhe evidencave mbështetëse janë 10 vjet rresht pas mbylljes së vitit ushtrimor kontabël, të cilit i përkasin.

⁵⁸ Gjendjet *cash* janë konsideruar shumat e deklaruara nga subjekti me përshkrimin “kursime nga pagat” nisur nga rubrika *ndryshimet e interesave private, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme*, ku këto shuma janë deklaruar.

⁵⁹ Praktikisht, koha e kthimit të huas së deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2011 i takon të jetë nga data 1.7.2011, ditë kur është marrë huaja deri më 31.12.2011.

⁶⁰ Shihni aktet në aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶¹ Shihni shkresat nga “Tirana Bank”: kthim përgjigje nr. ***, datë 10.7.2020, në dosjen e Komisionit dhe nr. ***, datë 12.6.2019, në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

2.000 euro, shumën prej 25.000 euro e ka transferuar për shoqërinë “****” sh.p.k. me përshkrimin “transfertë për blerje apartamenti”.

Sa i takon origjinës së krijimit të kësaj depozite, në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti sqaroi se: “... kjo depozitë është çelur në datën 2.8.2002 fillimisht si llogari e vetme e vëllait H. Sh., ku në emër të tij është futur në depozitë edhe shuma 1.600.000 lekë që i takonte subjektit dhe në mars të vitit 2003 është shtuar edhe emri i tij si bashkëpronar në këtë llogari. Në vitin 2008 është tërhequr shuma 1.200.000 lekë dhe këtë shumë e ka mbajtur vëllai H. Sh. për nevoja të veta, pasi filloi ndërtimin e një shtëpie të re në zonën e Kënetës në Durrës. Pjesa e mbetur ka vijuar në llogari të përbashkët deri në datën 11.1.2010, kur kjo depozitë u mbyll. Në këtë moment, pasi u likuidua vëllai H. për pjesën e mbetur të depozitës dhe interesat e akumuluar, shuma prej 3.080,000 lekësh kaloi në llogarinë e subjektit. Kjo shumë, bashkë me interesat e akumuluar është tërhequr në datën 20.1.2011 dhe llogaria me këtë bankë është mbyllur përfundimisht ...”.

Për të vërtetuar këto pretendime, subjekti ka vënë në dispozicion vërtetimin nga “Tirana Bank” dhe ekstrakt bankar, për nxjerrjen e llogarisë për periudhën 2002 – 2011, nga verifikimi i të cilave vërtetohet se depozita bankare daton më 30.8.2002, kur vëllai i subjektit H. D. Sh. e ka çelur në shumën fillestare 3.200.000 lekë, e cila më 5.3.2003 është bërë dyemërore. Kjo depozitë është investuar vazhdimisht deri në datën 21.1.2011, fakte që përputhen me deklaratimet e subjektit.

Sa i takon deklaratimeve të kësaj depozite, nga verifikimi i DPV-ve ka rezultuar se subjekti ka kryer deklaratime të rregullta në lidhje me shtesat e likuiditetit në këtë depozitë për shkak të interesave bankare, por është konstatuar se në disa raste këto shtesa nuk janë deklaruar saktësisht, për të cilat subjektit i është kërkuar të japë shpjegime. Edhe pse subjekti nuk ka dhënë shpjegime, në përfundim të procesit Komisioni çmoi se për sa kohë janë evidentuar ndryshimet në depozitë nëpërmjet informacionit bankar, pasaktësitë në deklaratime nuk kanë sjellë ndonjë pasojë.

Duke qenë se kjo depozitë ka qenë e përbashkët me vëllain H. Sh., gjatë hetimit administrativ është verifikuar mundësia financiare me të ardhura të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për krijimin e shumës 1.600.000 lekë deri më 30.8.2002, e cila përfaqëson pjesën takuese të investimit fillestar, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën vijuese që i përket periudhës para vitit 2003.

Përshkrimi	Deri në fund të vitit 2002
PASURI (LIKUIDITETE)	1 629 439
shtesa/pakësime/likuiditete	1 629 439
TË ARDHURA	3 376 406
Të ardhura nga pagat, subjekti i rivlerësimit	2 892 642
Të ardhura nga pagat, bashkëshortja	454 325
Të ardhura nga interesa “Tirana Bank”	29 439
SHPENZIME	2 637 032
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së ⁶²	2 637 032
Mundë sia për kursime	-890 065

Në përfundim të hetimit administrativ, subjektit i kaloi barra e provës për të kundërshtuar pamundësinë e justifikimit me të ardhura të ligjshme të pjesës së tij takuese në investimin

⁶² Shpenzimet e jetesës janë llogaritur sipas metodologjisë së ndjekur nga Komisioni për përlllogaritjen e shpenzimeve përpara vitit 2003.

filleshtar të shumës prej 1.600.000 lekësh, për shkak të balancës negative -890.065 lekë. Sa i takon pjesës takuese të personit tjetër të lidhur, vëllait H. Sh., në shumën 1.600.000 lekë, investuar në vitin 2002, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar me dokumente shkresore të ardhura të ligjshme të tij në momentin çeljes së kësaj depozite.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

Së pari, sa i takon burimit të ligjshëm të shumës 1.600.000 lekë, në parashtrimet e tij, subjekti ka deklaruar se ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e depozitës duke pretenduar se:

i) Në analizë duhet t'i përfshihen edhe të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes deri në shtator të vitit 2002, pretendim i cili u mor në konsideratë pjesërisht. Sa i takon të ardhurave para martese, ato i ishin marrë në konsideratë. Sa i takon të ardhurave të bashkëshortes, në analizën e rishikuar u përfshinë si të ardhura kursimet saj para martese në shumën prej 134.710 lekësh⁶³.

ii) Për mënyrën e përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës, subjekti pretendoi që të reduktohen për shkak të përdorimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale, ndërkohë që ka kërkuar t'i shtohen të ardhura nga toka bujqësore. Ky pretendim i është marrë pjesërisht në konsideratë, duke reduktuar shpenzimet e jetesës për shkak të të ardhurave nga toka bujqësore⁶⁴, trajtuar hollësisht në rubrikën *analiza financiare çështja 7*, të këtij vendimi.

Pas rishikimit të analizës financiare, balanca negative nga -890.065 lekë bëhet -127.103 lekë. Pavarësisht kësaj balance negative, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni çmoi se subjekti ka pasur mundësi për të kontribuar me shumën 1.600.000 lekë për krijimin e depozitës në vitin 2002.

Së dyti, sa i takon pjesës takuese të personit tjetër të lidhur, z. H. Sh., në parashtrimet e tij subjekti sqaron se së bashku me vëllain H. Sh. kanë hapur një llogari të përbashkët⁶⁵ për të përfituar interesa më të larta, të cilat rriteshin në raport me vlerën dhe afatin e depozitës. Po kështu, subjekti ka pretenduar se nuk i takon atij barra e provës për të provuar burimin e të ardhurave të tij me të cilat ka kontribuar në llogarinë bankare të përbashkët në bazë të ligjit (pika 4, e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016), pasi kjo marrëdhënie nuk është as marrëdhënie huaje as dhurimi, por një marrëdhënie tipike bashkëpronësie.

Sa i takon këtij pretendimi, Komisioni vlerësoi se subjekti nuk ka qenë tërësisht bindës në argumentim, pasi shuma prej 3.203.000 lekësh që subjekti ka tërhequr nga "Tirana Bank" datë 21.1.2011, për ta përdorur për pagesën e një kësti për blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi, është më e madhe se 1/2 pjesë takuese e tij dhe, për këtë, shkak subjekti ka pasur një detyrim prej 800.000 lekësh ndaj vëllait H. Sh., ashtu sikurse deklaroi edhe në seancë dëgjimore⁶⁶. Veç kësaj, duke qenë se subjekti për të paguar një këst për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi, ka përdorur një depozitë dyemërore të tij dhe vëllait të tij, me qëllim heqjen e çdo dyshimi se e gjithë depozita mund të ketë qenë e tij (subjektit), Komisioni vlerësoi të kryejë verifikime mbi burimin e ligjshëm të pjesës takuese të vëllait H. Sh.. Në lidhje me këtë, subjekti ka sqaruar se

⁶³ Mundësia për kursime e bashkëshortes është vlerësuar nga viti 1994 kur ajo ka punuar, deri në datën e martesës 15.6.1997, duke konsideruar të ardhurat nga paga dhe duke zbritur shpenzimet e jetesës për një person.

⁶⁴ Periudha nëntor 1993 – dhjetor 1999, shpenzimet e jetesës janë konsideruar në masën 30% të të ardhurave nga pagat e bashkëshortëve, ndërsa nga viti 2000 e në vijim sipas standardit të ILDKPKI-së.

⁶⁵ Depozitë të përbashkët me kushtin që çdo tërheqje do të bëhej në prezencë të të dyve.

⁶⁶ Duke ndjekur ecurinë e depozitës në "Tirana Bank", konstatohet se në dhjetor të vitit 2007 depozita së bashku me interesat ka arritur në shumën 4.000.000 lekë dhe secilit prej vëllezërve do i takonte shuma nga 2.000.000 lekë. Ndërkohë që sipas deklarimeve të subjektit, shuma prej 1.200.000 lekësh e tërhequr në tetor të vitit 2008 i është dhënë vëllait H. Sh.. I pyetur në seancën dëgjimore të datës 19.3.2021, se çfarë ka ndodhur me diferencën prej 800.000 lekësh që i takojnë vëllait H. Sh., subjekti u përgjigj se ia ka dhënë këtë diferencë vëllait të tij gjatë viteve 2009-2010.

të ardhurat e vëllait H. Sh., vijnë nga shitja e një banese private të tij në Bulqizë, në shumën 1.050.000 lekë, në datën 10.1.2002. Pjesa tjetër, sipas tij, është siguruar nga puna e vëllait dhe e familjes së tij. Subjekti ka vënë në dispozicion disa dokumente shkresore⁶⁷, të cilat nuk kanë vërtetuar të ardhura të ligjshme të vëllait të tij H. Sh..

Sa më sipër, subjekti nuk arriti të kundërshtojë barrën e provës sa i takon burimit të ligjshëm të të ardhurave të vëllait për krijimin e shumës 1.600.000 lekë. Por, referuar dinamikës së gjithë veprimeve, Komisioni nuk mund të arrijë në konkluzionin se e gjithë depozita ka qenë në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Ndërsa sa i takon shumës prej 3.203.000 lekë, të tërhequr nga depozita në “Tirana Bank” në datën 21.01.2011, nuk u provua tërësisht burimi i ligjshëm i saj, përderisa pjesë përbërëse e kësaj depozite, është dhe shuma 800 000 lekë, që i takon vëllait H. Sh., për të cilën si më sipër rezultoi nuk u provua burimi i ligjshëm.

3. Garazh me sip. 15.5 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, prenotuar me të njëjtën kontratë sipërmarrjeje me apartamentin e sipërpërmendur, në të njëjtën adresë nga i njëjti sipërmarrës, datë 12.3.2010, kontratë shitjeje datë 2.9.2015. Vlera: 5.000 euro. Paguar në datën 12.4.2012. Burimi i krijimit: hua nga shtetasi P. B. (pa u deklaruar shuma) vërtetuar me kontratë huaje, datë 13.9.2012. Kjo shumë është tërhequr më parë për t’u përdorur nga subjekti dhe, më pas, është nënshkruar kontrata.

Në lidhje me këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konstatuar: konfirmohet nga ZVRPP-ja garazhi i deklaruar dhe pagesat e kryera, fillimisht me transfertë bankare dhe më pas në shoqërinë e ndërtimit.

Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri

3.1 Në lidhje me statusin aktual të pasurisë

ZVRPP-ja Tiranë⁶⁸ ka informuar se në emër të z. Bari Shyti rezulton e regjistruar pasuria me nr.***, e llojit garazh me sip. 15.50 m². Në lidhje me mënyrën e krijimit dhe deklarimet ndër vite, ato janë të njëjta me pasurinë apartament me nr. pasurie ***, trajtuar në pikën 2 më sipër, pasi të dyja pasuritë janë porositur dhe blerë me të njëjtat akte nga shoqëria “****” sh.p.k.

3.2 Në lidhje me burimin e krijimit

Në deklaratën *Vetting*, si burim krijimi për këtë pasuri është deklaruar hua nga shtetasi P. B.. Me kontratë huaje nr. ***, datë 3.9.2012⁶⁹, z. Bari Shyti ka marrë nga z. P. L. hua në shumën 5.000 euro. Sipas kontratës, kjo hua është dhënë për një periudhë kohore që ka filluar në datën 2.4.2012 deri më 28.12.2013 dhe është deklaruar në DPV-në e vitit 2012 si burim për pagimin e këstit të fundit për blerjen e apartamentit në Tiranë në shumën 10.000 euro, vërtetuar me mandatarkëtimin nr. ***, datë 12.4.2012.

Siç vërehet, subjekti në deklaram i referohet huadhënësit P. B., ndërsa kontrata e huas është e lidhur me shtetasin P. L.. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se shtetasi P. L. dhe shtetasi P. B. është i njëjti person, djali i dajës së subjektit, i cili jeton në Itali, por pa e vërtetuar këtë fakt me prova shkresore. Gjithashtu, nuk ka vërtetuar me dokumente shkresore burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit për dhënien e huas në prill të vitit 2012. Për

⁶⁷ Deklaratë dore (dorëshkrim) e shtetasit H. Sh., në të cilën deklaroi se në vitin 2002 ka depozituar në “Tirana Bank” shumën prej 1.600.000 lekësh (krijuar nga shitja e banesës private në Bulqizë dhe kursimet familjare deri në vitin 2002), të cilat i ka tërhequr në vitin 2008, pjesën më të madhe ku nisi të ndërtojë një shtëpi në zonën e kënetës në Durrës; deklaratë noteriale nr. ***, datë 8.10.2020 të shtetasit M. L., në të cilën deklaroi se në vitin 2002 ka blerë shtëpinë e z. H. Sh. në vlerën 1.050.000 lekë, dhënë atij dorazi në prezencë të bashkëshortes. Duke qenë se shtëpia nuk ishte e regjistruar në hipotekë, me qëllim vërtetimin e faktit të pagimit të çmimit, i ka marrë atij një deklaratë dore, të cilën e ka ruajtur e po e vë në dispozicion; deklaratë dore e shtetasit H. Sh., në të cilën deklaroi marrjen e shumës prej 1.050.000 lekësh si çmim shitje të shtëpisë së tij në lagjen e re në Bulqizë.

⁶⁸Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 13.2.2019, nga ZVRPP-ja Tiranë, në dosjen e Komisionit.

⁶⁹ Shihni aktet në aneksin 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

të vërtetuar të kundërtën e këtyre fakteve, subjektit i ka kaluar barra e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

Në parashtrimet e datës 13.10.2020, subjekti, për të provuar të ardhurat e huadhënësit, ka vënë në dispozicion një ekstrakt bankar të shtetasit P. L. nga “B. P. d. V.” për vitet 2010 dhe 2012, dokumente të cilat ishin të paqarta dhe jo në formën e kërkuar nga ligji⁷⁰. Sa i takon mbiemrit të huadhënësit, subjekti ka sqaruar se P. B. dhe P. L. janë i njëjti person, por pa e vërtetuar këtë me dokumente shpresore.

Pas riçeljes së hetimit administrativ, duke qenë se dokumentet e paraqitura nga subjekti nuk kanë qenë të plota e shteruese, subjektit iu kërkua përsëri të vërtetojë me dokumente që P. B. dhe P. L. janë i njëjti person, si dhe, të paraqesë dokumente që provojnë të ardhurat ligjore të tij për periudhën deri në prill të vitit 2012 kur është dhënë huaja⁷¹. Në përgjigjet e pyetësorëve nr. 4 dhe nr. 5, si dhe në parashtrimet e datës 15.3.2021 subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur disa dokumente shpresore, nga marrja në shqyrtim e të cilave, në përfundim të procesit të rivlerësimit, është vërtetuar se:

i) P. B. dhe P. L. janë i njëjti person.

ii) Familja e shtetasit P. L. ka pasur të ardhura *neto* prej 27,484 euro nga janari i vitit 2011 deri në prill të vitit 2012 kur është dhënë huaja, ndërkohë që shpenzimet e jetesës për dy persona, për të njëjtën periudhë, janë në shumën 12,578 euro sipas EUROSTAT-it⁷². Në këto rrethana, mundësia për kursime në vlerën 14,906 euro, duket se është e mjaftueshme për dhënien e huas në shumën 5.000 euro në datën 12.4.2012 dhe, për rrjedhojë, kjo hua është përfshirë si e ardhur e ligjshme në analizën financiare përfundimtare për vitin 2012, vit i cili bëhet me një balancë pozitive, rezultati i së cilës ndryshoi nga -437,376 lekë, dërguar me rezultatet e hetimit, në +49,304 lekë.

Sa i takon shlyerjes së huas në shumën 5.000 euro, shtetasit P. L./B., në DPV-në për vitin 2013, subjekti ka deklaruar shlyerjen e detyrimit në shumën 3.500 euro dhe në DPV-në për vitin 2014 ka deklaruar shlyerjen e pjesës së mbetur të detyrimit, prej 1.500 euro. Në përfundim të procesit u vërtetua se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për shlyerjen e huas, pasi analiza financiare finale për vitet 2013 dhe 2014 ka rezultuar me balancë pozitive⁷³, pasqyruar në tabelën përmbledhëse në fund të vlerësimit të kriterit të pasurisë.

Rezultat përfundimtar në lidhje me apartamentin e banimit 2+1, me sip. 107 m² dhe garazh me sip. 15.5 m², në rrugën “J. M.”, Tiranë

Në përfundim të procesit të rivlerësimit u vërtetua se subjekti: (i) ka kryer deklarime të pasakta; si dhe (ii) nuk ka justifikuar pagimin me të ardhura të ligjshme të shumës prej 80.000 euro gjatë viteve 2010 – 2012 për blerjen e apartamentit të banimit dhe garazhit në rrugën “J. M.” Tiranë, sipas pikës 3, të nenit D, të Kushtetutës dhe germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, për shkak të balancave negative të rezultuara pas marrjes në konsideratë të disa prej pretendimeve të subjektit, pasqyruar në tabelën vijuese. Për rrjedhojë, është në kushtet e pamjaftueshmërisë në deklarime, sipas parashikimit të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016 dhe ndaj tij duhet të merret masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

⁷⁰Dokumentet e paraqitura ishin të papërkthyer, të panoterizuara dhe pa vulë apostile. Llogaria bankare ku shtetasi P. L. merr pagën rezulton të jetë llogari dyemërore me llogarimbajtës shtetasit P. L. dhe R. L. (vëllai i z. P. pasi atësia është e njëjtë). Gjithashtu, subjekti ka vënë në dispozicion fotokopje në gjuhën italiane të CUD 2011, që përfaqëson të ardhurat e vitit 2010.

⁷¹Subjektit iu kërkua të vinte në dispozicion: vërtetim nga ISSH-ja (Istituto Nazionale di Previdenza Sociale) ose busta paga, ose deklarata të të ardhurave vjetore të tij (CUD), si dhe çdo dokument tjetër që provon të ardhura të tij.

⁷² https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=ilc_li01&lang=en

⁷³ Viti 2013 rezulton me balancë +7.301 lekë, ndërsa viti 2014 me balancë -31.116 lekë, e cila është e pakonsiderueshme për të mos arritur në konkluzionin se subjekti ka pasur të ardhura për shlyerjen e huas në vitin 2014.

Përshkrimi	2010	2011	2012
Pasuri	5 737 179	1 843 413	5 397 458
Apartament banimi në Durrës, lagjja nr.***			4 191 600
Apartament banimi 2+1, sip.107 m ² , Rr. “J. M.”	4 858 350	4 840 500	1 397 200
Garazh me sip. 15.5 m ² , Rr. “J. M.”			
shtesa/pakësime/likuiditete	878 829	-2 997 087	-191 342
Total likuiditete	4 190 761	1 193 674	1 002 332
Detyrime	0	-420 320	4 540 900
Shlyer huaja 9.000 USD, marrë nga vëllai I. Sh.		-420 320	
Hua në shumën 5.000 euro, marrë nga P. B.			698 600
Detyrim financiar ndaj vëllait për apartamentin në Durrës			4 191 600
Shlyer detyrimi financiar ndaj vëllait			-349 300
Pasuri neto	5 737 179	2 263 733	856 558
Të ardhura dokumentuar	1 355 050	1 566 995	1 599 653
Të ardhura nga punësimi, subjekti i rivlerësimit	990 390	1 145 068	1 326 305
Të ardhura nga punësimi, bashkëshortja	216 885	226 972	249 883
Të ardhura nga interesat bankare	147 775	194 955	23 465
SHPENZIME	1 083 100	1 415 847	693 791
Shpenzime jetese	683 100	683 100	697 740
Ulje e shpenzimeve të jetesës ⁷⁴			-130 000
Shpenzime për rivlerësimin e apartamentit në Bulqizë		26 441	
Shpenzime udhëtimi	0	306 306	126 051
Paguar vëllait, pjesa takuese e depozitës	400 000	400 000	
Mundësia për kursime	-5 465 229	-2 112 585	49 304

4. Automjet tip “Mercedes-Benz C200 CDI”, viti i prodhimit 2003, nr. shasie ***, me naftë. Vlera e blerjes 500.000 lekë, me detyrime doganore të paguara nga shitësi në vlerën 54.384 lekë me kontratë shitjeje, datë 11.8.2015. Burimi i të ardhurave për pagesë: shitje automjeti tip “Mercedes-Benz 202” blerësit A. S., vërtetuar me kontratë shitjeje, datë 25.6.2015, në shumën 300.000 lekë, si dhe kursime të vitit 2015.

Hetimi i Komisionit në lidhje këtë pasuri

4.1. DPSHTRr-ja⁷⁵ konfirmoi se shtetasi Bari D. Shyti, aktualisht ka në pronësi automjetin e deklaruar në deklaratën *Vetting* me targa AA ***, me nr. shasie ***, blerë me kontratën e shitjes nr. ***, datë 11.8.2015 nga z. I. Sh., në shumën 500.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Blerja e këtij automjeti dhe kontrata është deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2015.

4.1. Sa i takon burimeve të deklaruara në deklaratën *Vetting*, Komisioni kreu verifikimet për si vijojnë:

4.1.1. Me kontratë shitblerjeje automjeti nr.***, datë 25.6.2015, subjekti Bari Shyti ka shitur automjetin tip “Mercedes-Benz” me nr. shasie ***, në shumën 300.000 lekë, deklaruar në DPV-në e vitit 2015. Këtë automjet, subjekti e kishte blerë me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 4.5.2007, nga z. P. D. në çmimin 200.000 lekë, deklaruar në DPV-në e vitit 2007. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka shpjeguar në mënyrë bindëse duke vënë në dispozicion edhe një dokument që vërteton zhdoganimin e automjetit, se për këtë automjet ka investuar

⁷⁴ Shpenzimet e jetesës janë reduktuar për shkak të përdorimit të produkteve bujqësore, në masën që janë deklaruar në DPV-në e vitit 2012.

⁷⁵Shihni shkresat nr. *** prot., datë 6.2.2019 dhe nr. *** prot., datë 25.1.2019, nga DPSHTRr-ja në dosjen e Komisionit.

rreth 300.000 lekë. Vlera e shitjes prej 300.000 lekësh është konsideruar si e ardhur e ligjshme në DPV-në e vitit 2015⁷⁶.

4.2. Kursime të vitit 2015, në shumën 200.000 lekë, deklaruar edhe në DPV-në e vitit 2015.

Nga analiza financiare deri në datën 11.8.2015 kur është blerë automjeti, duket se subjekti nuk ka pasur mundësi për të krijuar kursimet në shumën 200.000 lekë, pasi rezulton me një balancë negative prej -169.040 lekësh, për të cilën, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën.

Përshkrimi	Datë 11.8.2015
PASURI	581 400
Blerje automjeti kontratë nr. ***, datë 11.8.2015	500 000
SHTESA/PAKËSIME/LIKUIDITETE	81 400
TË ARDHURA	1 149 088
Të ardhura nga pagat, subjekti i rivlerësimit	833 790
Të ardhura nga pagat, bashkëshortja	15 298
Të ardhura nga shitja e automjetit blerë në V.2007 dhe shitur në V.2015	300 000
SHPENZIME	736 728
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	654 138
Shpenzime udhëtimi	82 590
Mundësia për kursime	-169 040

Në parashtrimet e tij, subjekti ka prapësuar këtë konstatim, me pretendimin se në analizën financiare do të duhet të përfshihen edhe të ardhura nga toka bujqësore në vlerën 70.000 lekë, si dhe të reduktohen shpenzimet e udhëtimit nga sistemi *TIMS*. Sa i takon të ardhurave nga toka bujqësore, subjekti nuk ka vërtetuar dhe as ka deklaruar të ardhura nga toka bujqësore për vitin 2015. Ndërsa, me marrjen në konsideratë të disa prej pretendimeve në lidhje me shpenzimet e udhëtimit, trajtuar hollësisht në rubrikën *analizë financiare*, balanca negative për blerjen e automjetit bëhet nga -169.040 lekë në -120.725 lekë.

5. Tokë bujqësore me sip. 5738 m², në fshatin *, Fushë-Bulqizë, sipas aktit të regjistrimit.** Burimi i krijimit: zbatimi i ligjit nr. 7501, “Për tokën”. Gjatë hetimit administrativ, ZVRPP-ja Bulqizë⁷⁷ ka informuar se: “*Shtetasi Bari Shyti ka të regjistruara si përfaqësues i familjes bujqësore pasuritë sipas AMTP-së nr. ***: (1) pasurinë nr. ***, arë me sip. 2530 m²; (2) pasurinë nr. ***, arë me sip. 3208 m², në total 5738 m², vërtetuar me kartelat e pasurive përkatëse. Në deklaratën para fillimit të detyrës për vitin 2003, subjekti ka deklaruar ‘tokë bujqësore e ndarë në 2 parcela gjithsej me sip. 5738 m²’. Burim i krijimit: ligji nr.7501, ‘Për tokën’.*”

Në përfundim të procesit nuk kanë rezultuar problematika e dyshime në lidhje me këtë pasuri.

6. Depozitë bankare në fondin e investimeve Raiffeisen Prestige, datë 19.1.2017, në shumën 700.000 lekë. Kalim nga llogaria rrjedhëse në depozitë me interesa. Burimi i krijimit: (1) shuma 500.000 lekë nga kredia prej 1.500.000 lekësh, marrë po në “Raiffeisen Bank”, datë 5.8.2016, nga të cilat 1.000.000 lekë, tërhequr *cash* për të mbuluar shpenzimet e shkollimit për fëmijën E. Sh., ndërsa 500.000 lekë, të kaluara në llogarinë rrjedhëse; (2) shuma 200.000 lekë kursime nga paga gjatë vitit 2016. Pjesa takuese: 100%.

⁷⁶ Meqenëse vlera e shitjes së këtij automjeti është pothuajse e barabartë me atë të blerjes nuk duhet dhe është paguar tatim për të ardhurat nga shitja.

⁷⁷Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 9.2.2019, nga ZVRPP-ja Bulqizë në dosjen e Komisionit.

Në lidhje me këtë depozitë, ILDKPKI-ja ka konstatuar:

Subjekti ka fshehur në deklaratën e interesave private të vitit 2012 investimin në Raiffeisen Prestige në shumën 900.000 lekë, ku gjendja e mbetur në llogari ka qenë rreth 100.000 lekë. Gjendja është deklaruar në vitin 2013. Nuk është deklaruar pakësimi në vitin 2014.

Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë depozitë

Raiffeisen Invest⁷⁸ konfirmon se ka pasur një marrëdhënie juridike me shtetasin Bari Shyti, duke qenë investitor në fondin Raiffeisen Prestige dhe në datën 5.7.2018, i ka shlyer kuotat e investuara në këtë fond duke tërhequr shumën e investuara. Nga kjo datë e në vazhdim, gjendja e investuar nga subjekti i rivlerësimit në këtë fond është zero lekë.

Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj depozite bankare, e cila më 19.1.2017 është në shumën 700.000 lekë, në DPV-në e vitit 2016, si dhe gjatë hetimit administrativ subjekti ka deklaruar:

a. Shumën 1.500.000 lekë, marrë kredi në “Raiffesien Bank” më 5.8.2016, nga të cilat 1.000.000 tërhequr *cash*, për të mbuluar shpenzimet e shkollimit për fëmijën E. Sh., ndërsa 500.000 lekë, të kaluara në llogarinë rrjedhëse. Ky deklaram i subjektit vërtetohet plotësisht nga të dhënat e vëna në dispozicion nga “Raiffeisen Bank”⁷⁹, nga ku rezulton se shuma prej 1.000.000 lekësh është tërhequr nga kredia, ndërsa shuma prej 650.000 lekësh është investuar në Raiffeisen Prestige nga data 20.1.2017 deri në datën e maturimit 6.9.2017, duke u përfituar shuma 718.162 lekë, bashkë me interesat.

b. Shuma 200.000 lekë kursime nga paga gjatë vitit 2016. Nga hetimi administrativ rezultoi se kjo shumë përbëhet nga shuma e patërhequr e kredisë prej 500.000 lekësh dhe shuma 150.000 lekë e krijuar nga pagat e kursyera dhe të patërhequra nga llogaria bankare.

Nga verifikimi i lëvizjes së llogarisë në “Raiffeisen Bank” lidhur me burimin e këtij investimi, duket se konstatimi i ILDKPKI-së nuk qëndron pasi shuma e investuar në fondin Prestige prej 700.000 lekësh nuk e ka burimin tek investimi në këtë fond në vitin 2012, depozitë së cilës i përket gjetja e ILDKPKI-së.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit u konstatua se burimi i kësaj depozite është sikurse deklaruar nga subjekti, shuma e patërhequr nga kredia dhe kursimet nga pagat që derdhen në bankë, kështu, subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar shumën e investuar.

7. Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se subjekti ka pasur një marrëdhënie më të hershme me Raiffeisen Prestige, të cilën ai nuk e ka deklaruar saktësisht në deklaratat periodike vjetore.

Në lidhje me këtë depozitë, ILDKPKI-ja ka konstatuar: Subjekti ka fshehur në deklaratën e interesave private të vitit 2012 investimin në Raiffeisen Prestige në shumën 900.000 lekë, ku gjendja e mbetur në llogari ka qenë rreth 100.000 lekë. Është deklaruar gjendja në vitin 2013 dhe nuk është deklaruar pakësimi në vitin 2014.

6.3. Nga verifikimi i deklarameve të subjektit, konstatohet se:

a. Në DPV-në e vitit 2012, subjekti nuk ka deklaruar sipas ligjit investimin në Raiffeisen Invest, në shumën 900.000 lekë⁸⁰ dhe gjendjen e mbetur rreth 100.000 lekë. Raiffeisen Invest

⁷⁸ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 31.1.2018 (IMO, data duhet të jetë gabim, pasi duhet 31.1.2019), nga Raiffeisen Invest, në dosjen e Komisionit.

⁷⁹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 1.2.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸⁰ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 20.1.2017, nga Raiffeisen Invest në dosjen e ILDKPKI-së, e cila konfirmon investimin e subjektit në Raiffeisen Prestige për vitin 2012, në shumën 900.000 lekë dhe gjendjen e mbetur në llogari më 31.12.2012, në shumën rreth 100.000 lekë.

konfirmon investimin dhe gjendjen e depozitës në fondin Raiffeisen Prestige për vitin 2012 në shumën 900.000 lekë. Kjo depozitë është maturuar dhe tërhequr në dhjetor të vitit 2012⁸¹.

b. Në DPV-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar se ka investuar në korrik të vitit 2013 shumën 300.000 lekë në Raiffeisen Invest, e cila në vijim është shtuar me kursimet e pagës nga 60.000 lekë çdo muaj, si dhe ka përfituar interesa në shumën 25.000 lekë. Raiffeisen Invest konfirmon investimin dhe gjendjen e llogarisë së subjektit në fondin e investimit për vitin 2013 në shumën 800.000 lekë.

c. Në DPV-në e vitit 2014, subjekti nuk ka deklaruar veprime në depozitë në Raiffeisen Invest, e cila konfirmon investimin e subjektit në Raiffeisen Prestige për vitin 2014, në shumën 60.000 lekë dhe tërheqjen e shumës 1.000.000 lekë po këtë vit⁸².

Me kalimin e barrës së provës, në përfundim të hetimeve paraprake, subjektit i është kërkuar të japë sqarime në lidhje me konstatimet se duket se: (i) subjekti nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2012 investimin në Raiffeisen Prestige në shumën 900.000 lekë, ku gjendja e mbetur në këtë llogari ka qenë rreth 100.000 lekë; (ii) ndërsa është deklaruar gjendja e kësaj llogarie në vitin 2013, nuk është deklaruar sipas ligjit pakësimi i kësaj llogarie në vitin 2014.

Në parashtrimet e tij të datës 13.10.2020, subjekti ka prapësuar vetëm mbi konstatimin për mosdeklarimin e investimit në Raiffeisen Prestige në DPV-në e vitit 2012 duke deklaruar: “... janë deklaruar si kursime por janë investuar në Raiffeisen Prestige nëpërmjet depozitimit fillimisht të shumës 500.000 lekë dhe shtimit për çdo muaj duke marrë nga paga 50.000 lekë. Në fund të vitit 2012 është tërhequr shuma 850.000 lekë dhe është përdorur për të shlyer huat afatshkurtra të marra në kohën kur është paguar kësti i tretë i apartamentit në Tiranë prej 10.000 euro. Diferenca është lënë në llogari bankare dhe është mbartur në vitin pasardhës”.

Pretendimi i subjektit mbi burimin e shumës së investuar nuk qëndron, pasi në DPV-në e vitit 2012 ka deklaruar si burim për pagesën e këstit të apartamentit prej 10.000 euro, të kryer më 12.4.2012, huan e marrë në shumën 5.000 euro prej shtetasit P. L. dhe shumën 700.000 lekë kursime *cash* nga paga e tij dhe bashkëshortes gjatë këtij viti. Kështu, këto kursime *cash*, nuk mund të jenë përdorur për depozitimin fillestar të shumës 544.500 lekë në datën 25.5.2012, të investuar në vijim në Raiffeisen Prestige, pra, subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme, për të krijuar dhe investuar në fondin Raiffeisen Prestige.

Megjithatë, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni çmon se mosdeklarimi i shumës së investuar në Raiffeisen Prestige në vitin 2012 është një pasaktësi në deklarim dhe jo fshehje pasurie, për shkak se: (i) të gjitha veprimet janë kryer nëpërmjet sistemit bankar e kështu janë lehtësisht të verifikueshme; (ii) subjekti e ka deklaruar këtë depozitë në DPV-në e vitit 2013, vitin pasardhës të çeljes së saj. Po kështu, mosdeklarimi i pakësimit të kësaj depozite në vitin 2014, është gjithashtu një pasaktësi pasi të gjitha veprimet janë kryer nëpërmjet bankës nga ku verifikohet edhe destinacioni i tyre⁸³.

7. Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank” në shumën 84.990 lekë, deri në datën e dorëzimit të deklaratës. Burimi i krijimit: paga e subjektit. Pjesa takuese: 100%. Gjatë hetimit

⁸¹Nga lëvizjet e llogarisë së “Raiffeisen Bank” rezulton se shuma 544.500 lekë është depozituar në llogarinë e subjektit në datën 25.5.2012 dhe pas mostërheqjes së shumës 50.000 lekë nga çdo pagë mujore, shuma e përftuar prej 900.000 lekësh është investuar në fondin Raiffeisen Prestige. Fondi është maturuar më 13.12.2012, në shumën 800.389.29 lekë dhe është tërhequr në datat 21 dhe 28 dhjetor 2012, respektivisht në shumat 500.000 lekë dhe 300.000 lekë, ndërsa shuma 100.000 lekë ka mbetur gjendje në llogari.

⁸² Nga lëvizjet e llogarisë së “Raiffeisen Bank” rezulton se gjendja e depozitës në fondin e investimit është 800.000 lekë e trashëguar nga investimi i vitit 2013 dhe në vlerën 60.000 lekë nga kursimet e pagës në llogari në vitin 2014. Shuma e investuar prej 860.000 lekësh maturohet më 11.8.2014, në shumën rreth 1.000.000 lekë dhe tërhiqet *cash* nga subjekti pas 2 ditësh.

⁸³ Në datën 13.8.2014 janë kryer dy transaksione: është tërhequr nga subjekti shuma 500.000 lekë dhe 500.000 lekë të tjera janë transferuar te llogaria e vëllait I. Sh. me përshkrimin “kthim borxhi”.

administrativ “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 1.2.2019, konfirmon këtë llogari.

Gjithashtu, “Raiffeisen Bank” ka konfirmuar në emër të subjektit disa llogari bankare, nga verifikimi i të cilave, nuk kanë rezultuar problematika.

DETYRIME FINANCIARE

Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar :

1. Detyrimin financiar të mbetur prej 1.800 euro ndaj personit tjetër të lidhur, z. I. Sh., detyrim i lindur për shkak të marrëveshjes midis tyre për përfitimin e ½ të pasurisë në Durrës nga subjekti i rivlerësimit (trajtuar më sipër te pasuria nr. 1).

2. Kontratë kredie bankare në “Raiffeisen Bank”, datë 5.8.2016, sipas së cilës shtetasit Bari dhe E. Shyti marrin një kredi personale në shumën 1.500.000 lekë, me afat kthimi 48 muaj, me pagesë kësti mujor 36.549 lekë. Sipas kësaj kontrate, qëllimi i marrjes së kësaj kredie është përdorimi për arsye personale, pagimi i shpenzimeve për vazhdimin e studimeve në Itali të vajzës E. Sh.. Shuma e detyrimit të mbetur deri më 31.12.2016 ishte 1.401.309 lekë.

Gjatë hetimit administrativ janë kryer verifikime në lidhje me këtë kredi, në përfundim të të cilave, ka rezultuar se:

a. Sipas kontratës së kredisë bankare⁸⁴ të datës 5.8.2016, shtetasit Bari dhe E. Shyti kanë marrë në “Raiffesien Bank” kredi në shumën 1.500.000 lekë me qëllim përdorimi për arsye personale, me afat 48 muaj. Kjo kredi është deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2016.

b. “Raiffeisen Bank”⁸⁵ informon se në datën 30.11.2017 është bërë rinovimi i kësaj kredie dhe është disbursuar shuma prej 2.211.000 lekësh, një pjesë e së cilës është përdorur për të mbyllur kredinë e parë.

Lidhur me mundësinë financiare të subjektit për shlyerjen e shumës prej 109.647 lekësh (principal +interes) në vitin 2016, nga analiza financiare në përfundim të hetimit administrativ, dukej se subjekti nuk ka pasur mundësi për shlyerjen e kësaj shume, si dhe për të mbuluar shpenzimet e kryera gjatë këtij viti, pasi ky vit rezultoi me mungesë burimesh financiare të ligjshme.

Në lidhje me rezultatin financiar të vitit 2016, subjekti ka prapësuar se shuma 6.000 euro është konsideruar edhe si depozitë edhe si shpenzim për vajzën E. Shyti, ndërkohë që kjo shumë është përdorur nga vajza. Gjithashtu, sipas subjektit, edhe shpenzimet e udhëtimit janë konsideruar sikur vajza të kishte shkuar për vizitë në Itali, ndërkohë që ajo studion atje.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni çmoi se pretendimi i subjektit qëndron, pasi në analizën financiare për vitin 2016 të dërguar me rezultatet e hetimit, shuma 6.000 euro ishte konsideruar edhe si shpenzim edhe si depozitë, pra, ishte konsideruar dy herë si shpenzim. Pasi shuma 6.000 euro u vlerësua të konsiderohet vetëm si shpenzim studimi, si dhe janë riparë shpenzimet e udhëtimit (trajtuar hollësisht në rubrikën *analiza financiare* çështja 7), rezultati i vitit 2016 ndryshon nga -982 475 lekë në -34. 325 lekë. Për rrjedhojë, në përfundim të procesit është konsideruar se subjekti ka pasur mundësi për të paguar shumën prej 109.647 lekësh (principal +interes) në vitin 2016.

⁸⁴ Shihni kontratën në aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁸⁵ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 1.2.2019, kontrata e kredisë bankare hipotekore nr. ***.

Deklaratë e pasurisë së personit të lidhur

Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. E. Sh., ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka evidentuar që nuk ka pasuri veçmas të regjistruar në emrin e saj. Nga verifikimet e kryera nuk rezulton të ketë pasuri veçmas në emër të znj. E. Sh..

E bija e subjektit të rivlerësimit, E. Sh., ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave private, ku ka evidentuar se disponon pasuri veçmas të regjistruar në emrin e saj, duke deklaruar një llogari rrjedhëse, për të mbuluar shpenzimet e studimit në Udine Itali, konfirmuar me shkresën nr. *** prot., datë 4.2.2019, të “Intesa Sanpaolo Bank”.

KONSTATIME TË TJERA

1. Në deklaratën *Vetting* në rubrikën *të ardhura*, subjekti ka deklaruar shitje apartamenti 2+1 në Bulqizë. Vlera e blerjes në dhjetor të vitit 2003 rezulton në shumën 650.000 lekë. Vlera e shitjes në tetor të vitit 2014 rezulton në shumën 3.650.000 lekë.

1.1. Në lidhje me këtë pasuri ka rezultuar se:

a. ZVRPP-ja Bulqizë⁸⁶ informoi se shtetasit Bari dhe E. Shyti si bashkëpronarë kanë shitur apartamentin me sip. 74 m², nr. pasurie ***, në Bulqizë, në tetor të vitit 2014, në shumën 3.650.000 lekë, sipas aktit noterial Nr.*** Rep, nr.*** Kol, dt.08.10.2014. Nga kartela e pasurisë së paluajtshme konstatohet se kjo pasuri është blerë në vitin 1996 në vlerën 20.820 lekë nga shtetasit F. dhe L. S., e më pas ka kaluar tek shtetasi Bahri Shyti në vlerën 200.000 lekë. Gjithashtu, ky institucion ka vënë në dispozicion aktin noterial kontratë shitblerje banese datë 10.12.2003, sipas të cilës shtetasit Bari dhe E. Shyti kanë blerë nga shtetasit F. e L. S. apartamentin me nr. ***, në vlerën 200.000 lekë. Sipas kësaj kontrate, shitësit janë dakord të kryejnë derdhjen e tatimit në masën 0.5% të kësaj vlere me qëllim që ZVRPP-ja të bëjë regjistrimin e kësaj banese. Nuk ka dokumente që vërtetojnë se nga kush është paguar detyrimi tatimor për tjetërsimin e kësaj pasurie, pavarësisht se detyrimi sipas ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, është i palës shitëse.

b. Subjekti ka paraqitur në ILDKPKI një kontratë shitblerje banese nr. ***, datë 10.12.2003⁸⁷ sipas së cilës shtetasit Bari dhe E. Shyti kanë blerë nga shtetasit F. e L. S. apartamentin me nr. pasurie ***, në vlerën 650.000 lekë.

c. Me kërkesë të Komisionit, noteri N. C., vuri në dispozicion⁸⁸ kontratën e shitblerjes së banesës nr. ***, datë 10.12.2003, sipas së cilës shtetasit Bari dhe E. Shyti kanë blerë nga shtetasit F. e L. S. apartamentin me nr. ***, në vlerën 200.000 lekë.

ç. Në DPV-në e vitit 2003 është deklaruar: “*Shtëpi banimi me sip. 70 m², 2+1, me vlerë 0.25 milion lekë. Blerë me të ardhurat e familjes*”.

Nga sa më sipër, u konstatua se ka mospërputhje në deklaratimet e subjektit lidhur me vlerën e blerjes së kësaj pasurie, pasi në: (i) deklaratën *Vetting* deklarohet me vlerë 650.000 lekë; (ii) në deklaratën për vitin 2003 deklarohet me vlerë 250.000 lekë ndërkohë që; (iii) në dokumentet e ZVRPP-së dhe në kontratën e shitblerjes së paraqitur nga noteri rezulton në vlerën 200.000 lekë. Pasi u pyet në lidhje me këto mospërputhje në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti, duke qenë i paqartë dhe kontradiktor në shpjegimet e tij deklaroi se: “... *çmimi real i paguar është ai sipas kontratës së paraqitur për regjistrim në ZVRPP (pra, vlera 200.000 lekë). Fakti që është rënë dakord me çmimin prej 200.000 lekësh lidhet me amortizimin e tij. Pasi është marrë në atë gjendje janë investuar rreth 250.000 lekë të tjera, por nuk disponon dokument ligjor.*”

⁸⁶ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 8.2.2019, nga ZVRPP-ja Bulqizë në dosjen e Komisionit.

⁸⁷ Shihni aktin në aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁸⁸ Shihni aktet dërguar në rrugë elektronike më 19.9.2019, nga noteri N. C., në dosjen e Komisionit.

Vlera prej 650.000 lekësh është shënuar si çmim referencë pas investimit të kryer, bazuar kjo edhe në një dokument që ai ka ruajtur, dokument ky i nënshkruar edhe nga shitësit F. S. dhe L. S.. Në vijim ai deklaron se në momentin e plotësimit të deklaratës Vetting nuk ka pasur as deklaratën për vitin 2003 dhe as kontratën origjinale”.

1.2. Sa i takon mundësisë financiare për blerjen e pasurisë në vitin 2003, në analizën financiare të pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën vijuese, vlera e blerjes së pasurisë është konsideruar në shumën 650.000 lekë, aq sa është deklaruar nga subjekti në deklaratën Vetting dhe ashtu sikurse është pasqyruar në kontratën nr. ***, datë 10.12.2003, të paraqitur në ILDKPKI. Siç vërehet, duket se subjekti nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurisë, për shkak të balancës negative në shumën 378.529 lekë.

Përshkrimi	2003
PASURI (LIKUIDITETE)	765 092
Shtëpi banimi me sip. 70 m ² , lagjja e re, Bulqizë	650 000
shtesa/pakësime/likuiditete	115 092
TË ARDHURA	762 019
Të ardhura nga pagat subjekti	646 927
Të ardhura nga interesat bankare	115 092
SHPENZIME	375 556
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	375 456
Mundësia për kursime	-378 529

1.3. Në përfundim të hetimit administrativ, me kalimin e barrës së provës, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me konstatimet dhe duket se: (i) ka mospërputhje deklarimesh në lidhje me vlerën e blerjes së pasurisë; (ii) deklarimi i subjektit në deklaratën Vetting se vlera e pasurisë/çmimi i blerjes është 650.000 lekë, duket se është i pavërtetë, pasi ai ka paraqitur në ZVRPP Bulqizë një kontratë shitjeje, e cila parashikon një çmim të ndryshëm nga 200.000 lekë; (iii) subjekti ka nënshkruar dy kontrata shitjeje me të njëjtat ekstremitete, për të njëjtën pasuri, por që parashikojnë vlera të ndryshme të çmimit të shitjes. Bazuar në këto fakte, krijohet dyshimi se subjekti e ka nënshkruar kontratën nr. ***, datë 10.12.2003, me çmimin prej 200.000 lekësh, pasi kishte lidhur më parë kontratën në vlerën 650.000 lekë, me qëllim paraqitjen e saj në ZVRP-në Bulqizë, për të shmangur pagimin e detyrimit tatimor mbi shitjen në vlerën 650.000 lekë.

1.4. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

Në parashtrimet e datës 13.10.2020 subjekti ka deklaruar se: “... pranoj me ndërgjegje të plotë se kjo ngatërresë e cila më rendon padrejtësisht është kryer nga pakujdesia ime, por duhet të vlerësohet me arsyetim pozitiv për vetë faktin se jo vetëm që nuk kam tentuar të fsheh gjë, por kam rritur fiktivisht vlerat pa asnjë interes pasuror. Kërkoj të pranohet obsioni i dhënë si i vërtetë dhe real”. Po kështu, duke shpjeguar se mbi pasurinë kishte investuar përtej çmimit të caktuar në kontratë prej 200.000 lekësh, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se: “ ... për të shmangur ndonjë precedent siç rëndom ndodhte në atë periudhë ku shitësit ndërronin mendje duke shfrytëzuar ndonjë mangësi në hartimin e kontratave dhe kërkonin pavlefshmërinë e tyre, për të mos humbur të paktën investimin e kryer, unë mora disa masa sigurimi, duke marrë nga noteri një kopje ende të paplotësuar te rubrika e çmimit dhe shënova një çmim tjetër të cilin e kam ruajtur në arkivin tim, por që nuk kishte asnjë vlerë juridike ndaj të tretëve”.

Pra, subjekti ka dhënë përgjithësisht të njëjtat sqarime ashtu sikurse edhe gjatë procesit të rivlerësimit në lidhje me çmimin e blerjes së pasurisë, duke sqaruar e pretenduar se çmimi real

i paguar në momentin e nënshkrimit të kontratës ka qenë në vlerën 200.000 lekë. Po kështu, subjekti konfirmoi edhe nënshkrimin e një kontrate tjetër me çmimin 650.000 lekë, të cilën pohoi ta ketë plotësuar vete duke shënuar çmimin 650.000 leke në vendin e paplotësuar të rubrika e çmimit.

Sa i takon mundësisë financiare për blerjen e pasurisë, subjekti ka pretenduar dhe pranuar që investimi në total për këtë pasuri ka qenë në shumën 500.000 lekë dhe jo 200.000 lekë, pretendim i cili mbetet në nivel deklarativ. Për rrjedhojë, referuar kontratës së paraqitur në ILDKPKI dhe deklarimit në deklaratën *Vetting*, në analizën financiare përfundimtare Komisioni ka konsideruar si shpenzim për blerjen e kësaj pasurie shumën 650.000 lekë. Për këtë arsye, balanca negative e rezultuar nga analiza financiare për vitin 2003 nuk ndryshon. Megjithatë, edhe në rast se vlera e pasurisë do të konsiderohej 500,000 lekë, sipas deklarimeve të subjektit, ai përsëri nuk do të kishte patur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijuar këtë pasuri, pasi viti 2003 do të rezultonte me balancë negative prej -228 929 lekësh.

Sa i takon nënshkrimit të dy kontratave me çmime të ndryshme për të njëjtën pasuri, përtej dyshimit që ky veprim mund të jetë kryer me qëllim shmangien e pagimit të tatimit mbi shitjen, detyrim që sipas ligjit i takon palës shitëse, Komisioni vlerësoi se subjekti mund dhe duhet të shmangte nënshkrimin e dy kontratave me çmime të ndryshme, duke nënshkruar një deklaratë noteriale, në të cilën palet të deklaronin e të pranonin kryerjen e investimeve që tejkalonin çmimin e blerjes sipas pretendimit të subjektit.

2. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar të ardhura nga përdorimi i tokës bujqësore në fshatin ***, Fushë-Bulqizë, e përfituar në zbatim të ligjit nr. 7501, në shumën 1.400.000 lekë.

2.1. Nga verifikimi i deklarimeve periodike vjetore rezulton se:

a. në DPV-në e vitit 2012 janë deklaruar të ardhura nga toka bujqësore në fshatin ***, Fushë-Bulqizë, në shumën 130.000 lekë;

b. në DPV-në e vitit 2013 janë deklaruar të ardhura nga përdorimi i tokës bujqësore në pronësi në fshatin ***. Llogaritja është në bazë të përfitimeve nga produktet e mishit, frutave dhe perimeve të realizuara nga puna e tij dhe e bashkëshortes në shumën 130.000 lekë;

c. në DPV-në e vitit 2014 janë deklaruar të ardhura nga përdorimi i tokës bujqësore në fshatin Kocaj në shumën 70.000 lekë.

Siç vërehet, në DPV-të e viteve 2012 – 2014, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga përfitimi i produkteve të mishit, frutave, perimeve dhe tokës bujqësore në total në shumën 330.000 lekë, ndërkohë që në deklaratën *Vetting* deklarohet shuma prej 1.400.000 lekësh.

2.2. Në përfundim të hetimit administrativ, subjektit i ka kaluar barra e provës në lidhje me faktet e konstatuara si vijojnë: (i) ka mospërputhje midis deklarimeve në DPV-të dhe deklaratës *Vetting* sa u takon të ardhurave të përfituara nga përdorimi i tokës bujqësore në fshatin ***, Fushë-Bulqizë; (ii) subjekti nuk ka vënë në dispozicion dokumentacionin ligjor që vërteton të ardhura nga toka bujqësore, si dhe pagesën e tatimit të taksave të Bashkisë Bulqizë për tokën bujqësore ndër vite. Për këtë arsye, këto të ardhura nuk janë marrë në konsideratë si të ardhura të ligjshme në analizën financiare.

Në parashtrimet e datës 13.10.2020, subjekti nuk ka dhënë sqarime mbi pasaktësitë apo mospërputhjet në deklarime duke pretenduar se të ardhurat nga produktet e tokës bujqësore duhet të përfshihen në analizën financiare si shpenzime të zbritshme nga shpenzimet e jetesës gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit dhe jo vetëm për vitet 2012, 2013 dhe 2014, kur i ka deklaruar këto të ardhura. Me insistimin e Komisionit për të paraqitur dokumente e shpjegime

të mëtejshme, për të vërtetuar legjitimitetin e të ardhurave nga toka bujqësore sipas pretendimeve të tij, në përgjigje të pyetësorit nr. 5, subjekti ka vënë në dispozicion aktet:

- vërtetim nr. ***, datë 19.1.2021, nga Bashkia Bulqizë, e cila nuk e njeh subjektin si debitor;
- vërtetim nr. ***, datë 19.1.2021, nga Bashkia Bulqizë për pagesën e taksës së tokës bujqësore për periudhën 2015 – 2020;
- akt vlerësimi datë 20.1.2021, nga Agjencia Rajonale e Ekstencionit Bujqësor Dibër, i cili jep informacion për të ardhura nga toka gjatë vitit 2020.

Siç vërehet, pavarësisht se subjekti nuk ka rezultuar debitor në Bashkinë Bulqizë, nuk rezulton që përpara vitit 2015 të jetë paguar taksa e tokës bujqësore sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ndërkohë që informacioni për të ardhurat nga toka bujqësore i përket vitit 2020. Në këto kushte, subjekti jo vetëm që nuk ka vërtetuar të ardhura të ligjshme nga toka bujqësore, por në deklaratën *Vetting* ka deklaruar një fakt të pavërtetë e të pambështetur në prova shkresore për shkak të deklaramit të të ardhurës në shumën 1.400.000 lekë, deklarim që vjen në kundërshtim me të dhënat e DPV-e, ku si e ardhur është deklaruar shuma në total prej 330.000 lekësh, për vitet 2012, 2013 dhe 2014.

Por, në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni çmoi të mos anashkalojë deklaramet e subjektit në DPV për të ardhurat nga toka bujqësore gjatë viteve 2012, 2013 dhe 2014. Pavarësisht se shuma prej 330.000 lekësh nuk mund të konsiderohet si e ardhur e ligjshme për shkak të mungesës së çdo të dhëne që do të legjitimonte këtë të ardhur, Komisioni vlerësoi që për këto vite shpenzimet e jetesës të reduktohen me shumën e deklaruara nga subjekti në këto DPV. Për rrjedhojë, rezultati financiar për vitet përkatëse është përmirësuar, sikurse tregohet në tabelën përmbledhëse.

Në parashtrimet e datës 15.3.2021, pas riçeljes se hetimit administrativ, subjekti ka vijuar të pretendojë në lidhje me të ardhurat nga toka bujqësore duke kërkuar ulje të mëtejshme të shpenzimeve të jetesës, pretendime të cilat nuk i janë marrë në konsideratë për shkak të mosparaqitjes së asnjë prove shkresore të re e të ndryshme nga ato të paraqitura më parë.

3. Në DPV-në e vitit 2005 është deklaruar: “*Dhuratë në euro, I. Sh. tërhequr me Western Union, dokumentuar me faturë në shumën 1.200 USD*”. Pasi iu kërkuar me anë të pyetësorit nr. *** të vërtetojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. I. Sh., subjekti nuk ka vënë në dispozicion dokumente që të vërtetojnë këto të ardhura dhe, për këtë arsye, shuma 1.200 USD nuk është përfshirë si e ardhur ligjore në analizën financiare të këtij viti.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, dhurimi i pretenduar mbetet në nivel deklarativ, pasi nuk është paraqitur asnjë dokument që të vërtetojë dërgimin dhe as tërheqjen e shumës së mësipërme nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu nuk janë vërtetuar të ardhura të ligjshme të shtetasit I. Sh. për dhënien e shumës prej 1.200 USD. Për këtë arsye, me kalimin e barrës së provës, subjektit i është kërkuar të vërtetojë të kundërtën e këtyre konstatimeve.

Në parashtrimet e datës 15.3.2021, subjekti ka sqaruar se shuma prej 1.200 euro, dhuratë nga vëllai në Belgjikë, është tërhequr personalisht prej tij nga Western Union në vitin 2005, por për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, fatura e transaksionit nuk gjendet duke pretenduar se është në kushtet e pamundësisë objektive për të disponuar dokumentin, por nuk e ka vërtetuar pamundësinë me ndonjë akt shkresor. Gjithashtu, subjekti pretendon se përveç gjendjes *cash* të deklaruar për vitin 2005, 250.000 lekë + 450.000 lekë, si gjendje *cash* duhet të konsiderohet edhe shuma 1.200 euro, dhuruar nga vëllai, edhe pse nuk është deklaruar prej tij si gjendje *cash*, duke kërkuar t’i merret në konsideratë në vitet në vijim. Veç këtyre, subjekti nuk ka vërtetuar me dokumentacion shkresor të ardhura të ligjshme të vëllait në shtetin belg.

Në përfundim të procesit, shuma prej 1.200 euro nuk është përfshirë në analizën financiare si e ardhur e ligjshme, referuar fakteve: (i) nuk u vërtetua dhënia/dërgimi i shumës 1.200 euro prej z. I. Sh.; (ii) nuk janë vërtetuar të ardhura të ligjshme të tij për të dhënë këtë shumë; (iii) nuk është deklaruar si gjendje *cash* shuma prej 1.200 euro në fund të vitit 2005.

4. Në DPV-në e vitit 2013 është deklaruar: “*Pagesë kësti nga fondi i ish të përndjekurve, përfituar nga bashkëshortja si trashëgimtare e ish të burgosurve politikë, B. D., shuma 500.000 lekë.*”

Subjekti ka vënë në dispozicion të ILDKPKI-së⁸⁹ dëshmi trashëgimie nr. *** regj., datë 24.10.1994. Duke qenë se mungonte dokumentacioni ligjor financiar që vërteton marrjen e kësaj shume nga subjekti dhe bashkëshortja, kjo shumë nuk ishte konsideruar si e ardhur e ligjshme në analizën financiare për vitin 2013. Në prapësimet e datës 13.10.2020, subjekti ka paraqitur disa akte shkresore⁹⁰, nëpërmjet të cilave ka vërtetuar se bashkëshortja e tij si trashëgimtare e babait B. D., ka përfituar shumën 500.000 lekë, deklaruar në DPV-në për këtë vit, shumë e cila është përfshirë si e ardhur e ligjshme në analizën financiare të rishikuar.

5. Në DPV-në e vitit 2016 subjekti ka deklaruar: “*Shpenzimet e studimit të fëmijës E. Sh. në Udine Itali. Kaluar shuma 6.000 euro në llogari rrjedhëse të saj për të përballuar të gjitha shpenzimet për vitin akademik 2016-2017*”.

Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Nga kredia prej 1.500.000 lekësh marrë po në ‘Raiffesien Bank’ në datën 5.8.2016, 1.000.000 tërhequr cash, për të mbuluar shpenzimet e shkollimit për fëmijën E. Sh., ndërsa 500.000 lekë, të kaluara në llogarinë rrjedhëse*”.

Sipas dokumentacionit bankar të “Intesa Sanpaolo Bank” rezulton se deklaratimet e subjektit janë të sakta⁹¹. Gjithashtu, nga analiza përfundimtare financiare ka rezultuar se subjekti ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për t’i kaluar vajzës E. Sh. shumën 6.000 euro në vitin 2016.

Pas riçeljes së hetimit administrativ, subjektit iu kërkuan sqarime të mëtejshme në lidhje me studimin dhe shpenzimet e vajzës në Itali. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 4, subjekti ka dhënë shpjegime të tjera, si dhe ka vënë në dispozicion disa dokumente shkresore nga marrja në shqyrtim e të cilave rezultoi se: (i) vajza e subjektit E. Sh. ka ndjekur studimet në universitetin e Udines në periudhën 2016 – 2019; (ii) është vërtetuar kalimi i shumës 6.000 euro nga llogaria e subjektit në atë të vajzës në Itali dhe se e gjithë shuma është shpenzuar gjatë vitit nga vajza E. Sh.. Ndërsa, nga kërkimet në faqen zyrtare të Ministrisë së Jashtme italiane⁹², rezulton se qytetarët e vendeve jashtë BE-së, të cilët dëshirojnë të studiojnë në Itali, duhet të kenë të ardhura të paktën në shumën 448.07 euro/muaj për një vit akademik, me një total prej 5.824,91 euro/vit, kusht i plotësuar nga subjekti.

6. Gjatë hetimit administrativ shtesë, Komisioni kreu verifikime në drejtim të evidentimit të ndonjë rasti konflikti të mundshëm interesi, duke kërkuar nga gjykatat, ku subjekti ka ushtruar detyrën, informacione për çështje të shqyrtuara prej tij, me palë pjesëmarrëse shtetasit me të cilët ka qenë në marrëdhënie juridiko-civile apo shtetasit me të ciët ka udhëtuar, referuar të

⁸⁹ Shihni aktin në aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁹⁰ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 9.10.2020, e shtetasit M. D. (vëllai i bashkëshortes së subjektit), në të cilën deklaroi se ai dhe motra e tij si trashëgimtarë të babait të tyre B. D., ish i përndjekur politik, kanë përfituar dëmshpërblim nga shteti, nga të cilat i ka kaluar motrës së tij shumën *cash* prej 500.000 lekësh, më 11.4.2013, shumë të cilën e ka tërhequr nga BKT-ja, siç vërtetohet me *statement* bankar; *statement* nga BKT-ja nga i cili vërtetohet që në datën 11.4.2013, ka kaluar në llogari të z. M. D. shuma prej 541.5000 lekësh me përshkrimin “Dëm për ish të dënuar politik, kalim kësti i dytë”. Kurse në datën 19.4.2013 z. M. D. ka tërhequr nga llogaria e tij shumën prej 541.000 lekësh.

⁹¹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 4.2.2019, nga “Intesa Sanpaolo Bank”, nga ku rezulton se në datën 26.7.2016 është depozituar *cash* në llogarinë e vajzës së subjektit E. Sh., shuma 6.050 euro dhe në datën 31.8.2016 shuma prej 6.000 euro është transferuar në një llogari të vajzës E. Sh. me përshkrimin “transferim fondi për studime”.

⁹² <https://studyinitaly.esteri.it/visa>

dhënave të sistemit *TIMS*. Në përfundim të procesit të rivlerësimit u evidentua se në tri raste të gjykimit të çështjeve civile me palë pjesëmarrëse në proces, shoqërinë “***” sh.p.k., subjekti ishte në kushtet e konfliktit në dukje të interesit (trajtuar në rubrikën *rivlerësimi i aftësive profesionale*).

ANALIZA FINANCIARE

Në përfundim të hetimit administrativ, me ndihmën e Njesisë së Shërbimit Ligjor, Komisioni ka kryer analizë financiare për të gjithë periudhën e vlerësimit, 2003 – 2016, e cila kishte rezultuar me një balancë negative totale në shumën -10.185.687 lekë.

Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit administrativ dhe atij shtesë, duke kundërshtuar analizën e kryer nga Komisionim subjekti ka paraqitur një analizë financiare e cila rezulton me një balancë pozitive në shumën 1.619.081 lekë për të gjithë periudhën e rivlerësimit. Në vijim paraqiten në mënyrë të shkurtuar të gjitha pretendimet në lidhje me analizën financiare, të cilat janë trajtuar hollësisht në këtë vendim. Konkretisht, subjekti ka prapësuar:

1. Gjendjen dhe ndryshimin e likuiditeteve *cash*, e cila është rishikuar nga subjekti duke interpretuar deklaratimet e tij periodike, pretendim i cili nuk është marrë parasysh, bazuar në praktikën tashmë të konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit lidhur me deklaratimet e gjendjes *cash*⁹³.
2. Rishpërndarjen në kohë të pagesës së çmimit 1.400.000 lekë për blerjen e apartamentit në Durrës për pjesën takuese të tij, midis viteve 2005 dhe 2007, pretendim i cili nuk është marrë parasysh sikurse është trajtuar më sipër.
3. Përfshirjen si e ardhur e ligjshme e shumës 21.000 USD të përfituar nga shitja e kromit në vitin 2008, si dhe konsiderimin e kësaj shume si gjendje *cash* në fund të vitit 2008, e mbartur deri në vitin 2010, kur është përdorur si burim për të paguar një këst për blerjen e pasurisë në vitin 2010, pretendim i cili nuk është marrë në konsideratë, sikurse trajtuar më sipër.
4. Marrjen në konsideratë të huas së marrë nga vëllai I. Sh. në vitin 2011, në shumën 9.000 USD, pretendim i cili nuk është marrë parasysh sikurse është trajtuar më sipër.
5. Përfshirjen si të ardhur të ligjshme në vitin 2010, të shumës 18.500 euro përfituar nga shitja te vëllai I. Sh. të pjesës takuese të tij, pretendim i cili nuk është marrë parasysh sikurse trajtuar më sipër.
6. Përfshirjen në rubrikën të *ardhura* të interesave nga depozita në “Tirana Bank”, paguar në janar të vitit 2011, në shumën 194.955 lekë, pretendim i cili është marrë parasysh duke u përfshirë në analizën e vitit 2011.
7. Rishikimin e shpenzimeve të udhëtimit sipas sistemit *TIMS* për vitet 2008, 2009 dhe 2011–2016, duke pretenduar se shpenzimet janë përballuar nga pala pritëse e duke vënë në dispozicion disa dokumente shkresore. Pasi u kryen verifikimet për sa pretendon subjekti bazuar në aktet shkresore që ka vënë në dispozicion⁹⁴, shpenzimet e udhëtimeve janë rishikuar nga Komisioni bazuar në metodologjinë tashmë të konsoliduar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit⁹⁵ dhe konkretisht: (i) për vitin 2009 është marrë i mirëqenë fakti se subjekti dhe familja e tij kanë qenë për vizitë te vëllai I. Sh. në Belgjikë; (ii) për vitin 2013 udhëtimet në Maqedoni, Kosovë dhe Mal të Zi janë konsideruar si udhëtime 1-ditore dhe jo 14 dhe 22-ditore sikurse ishin përlllogaritur nga Komisioni për dy nga udhëtimet. Pretendimi i subjektit qëndron

⁹³ Shihni vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit referuar deklaratimeve të gjendjes *cash*: nr. 6/2018, nr. 8/2018, nr. 9/2018, nr. 11/2018, nr. 12/2018, nr. 5/2019, nr. 19/2019, nr. 20/2019 (JR) nr. 27, datë 22.10.2020.

⁹⁴ Disa lejeqëndrimi të personave pritës por jo deklarata të tyre, si dhe disa fotografi të bëra në Belgjikë, të cilat subjekti i ka vënë në dispozicion me parashtrimet e rezultateve shtesë dhe në seancën dëgjimore.

⁹⁵ Vendimi (JR) nr.11/2019, datë 22.5.2019, i KPA-së.

pasi përputhet me deklaratimet në pyetësorin standard, si dhe nga vulat kufitare në pasaportë; (iii) për vitin 2015 kur subjekti ka udhëtuar në Bruksel-Belgjikë, është konsideruar se ka qëndruar te vëllai I. Sh.; (iv) për vitin 2016, për vajzën e subjektit janë konsideruar vetëm shpenzimet e biletave dhe jo të akomodimit pas shtatorit 2016, pasi ajo studion në Itali; (v) nuk janë marrë në konsideratë pretendimet e subjektit sa i takon shpenzimeve të udhëtimit për vitet 2008, 2011 dhe 2012 dhe pretendimet mbi koston e kartonit jeshil, pasi këto pretendime mbeten në nivel deklarativ. Bazuar në sa më sipër, në total, shpenzimet e udhëtimit janë reduktuar në vlerën 649.186 lekë, duke ndikuar përkatësisht në rezultatin financiar të viteve 2009, 2013, 2015 dhe 2016, ndryshime të cilat subjektit i janë bërë me dije me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ shtesë.

8. Rishikimin e shpenzimeve të jetesës, për të cilat, në parashtrimet pas rezultateve të hetimit administrativ, gjatë hetimit administrativ shtesë, si dhe në parashtrimet për rezultatet e hetimit shtesë administrativ, subjekti ka kundërshtuar mënyrën e përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës nga Komisioni, për të gjitha vitet duke vënë në dukje disa elemente si: jetesa në fshat dhe në qytetin e Bulqizës, përdorimi i produkteve nga toka bujqësore, përbërja e vogël familjare, kursimet në energji elektrike dhe eliminimi i shpenzimeve të tjera për shkak të lëvizjeve të kufizuara nga klima e ashpër, etj. Meqenëse subjekti është zotërues i tokës bujqësore prej 5.7 dynym, ka pretenduar se ka siguruar të ardhura nga produktet bujqësore dhe ato blegtorale të cilat sipas tij, minimalisht kanë mbuluar 70% të nevojave për ushqim gjatë gjithë periudhës. Këto të ardhura subjekti i ka përlllogaritur me një vlerë mesatare vjetore prej 70.000 lekësh, duke kërkuar që kjo shumë të zbritet nga shpenzimet e jetesës të përlllogaritura sipas standardit të ILDKPKI-së, për të gjitha vitet, për shkak të përdorimit të produkteve nga toka bujqësore. Gjithashtu, subjekti pretendon se shpenzimet e jetesës duhen reduktuar në masën 21%, e cila përfaqëson diferencën e koston së jetesës midis Bulqizës dhe Tiranës bazuar në rezultatet e anketës së matjes së nivelit të jetesës dhe anketës së buxhetit të familjes, të kryera nga INSTAT-i. Në veçanti për vitin 2016, subjekti ka kërkuar respektimin e numrit të anëtarëve të familjes, pasi vajza e tij ka shkuar me studime në Itali.

Referuar këtyre pretendimeve dhe në analizë të tyre, si dhe bazuar në aktet shkresore që subjekti ka paraqitur për të vërtetuar pretendimet e tij, në përfundim të procesit, Komisioni ka vlerësuar që shpenzimet e jetesës t'i konsiderojë si vijon: (i) nga nëntori i vitit 1993 deri në fund të vitit 1999, shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur në masën 30% të të ardhurave familjare; (ii) në periudhën 2000 – 2016, janë marrë sipas standardit të ILDKPKI-së referuar gjithnjë INSTAT-it, pasi këto shpenzime janë të mesatarizuara në shkallë vendi dhe nuk mund të reduktohen; (iii) shuma prej 330.000 lekësh e deklaruar si e ardhur nga toka bujqësore në DPV-të e viteve 2012 – 2014, është zbritur nga shpenzimet e jetesës për këto vite; (iv) sa i takon pretendimeve për shpenzimet jetike për vitin 2016, ishin përlllogaritur në mënyrë të saktë nga Komisioni.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, pasi janë marrë në konsideratë disa nga pretendimet e subjektit, trajtuar në mënyrë të detajuar në këtë vendim, rezultati financiar përfundimtar për të gjithë periudhën e rivlerësimit është përmirësuar në shumën + 810,321 lekë dhe balanca negative totale është ulur nga -10 185 687 lekë në -9 375 366 lekë.

	1	2	3	4	5	6
Përshkrimi	PASURI	DETYRIME	PASURI NETO (1-2)	TË ARDHURA	SHPENZIM E	Mundësia për kursime (4-5-3)
<i>para vitit 2003</i>	1 629 439		1 629 439	3 241 696	1 697 345	-85 088

2003	765 092		765 092	762 019	375 856	-378 929
2004	343 922		343 922	986 600	540 618	102 060
2005	1 960 213		1 960 213	1 539 815	438 228	-858 626
2006	518 835		518 835	947 771	502 136	-73 200
2007	-734 500		-734 500	960 187	929 166	765 521
2008	722 835		722 835	972 977	788 551	-538 409
2009	456 094		456 094	1 067 484	907 243	-295 853
2010	4 337 179		4 337 179	1 355 050	2 483 100	-5 465 229
2011	1 843 413	-420 320	2 263 733	1 372 040	1 415 847	-2 307 540
2012	5 397 458	4 540 900	856 558	1 599 653	693 791	49 304
2013	-172 027	-981 435	809 408	1 968 359	1 151 650	7 301
2014	-1 238 591	-3 750 000	2 511 409	4 398 750	1 918 457	-31 116
2015	89 707	-96 355	186 062	1 268 730	1 313 904	-231 236
2016	496 775	1 428 455	-931 680	1 379 889	2 345 895	-34 325
Total	16 415 845	721 245	15 694 600	23 821 022	17 501 788	-9 375 366

Sa më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar pasuritë dhe për të kryer shpenzimet gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit, për shkak të një pamundësie financiare në shumën -10.299.552 lekë, e cila përfaqëson shumën e balancave negative të të gjitha viteve.

Metodologjia e përdorur

Në analizën financiare, për çdo pasuri të krijuar dhe/ose shpenzim të kryer, është analizuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, duke krahasuar në çdo rast informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore me deklaratimet e subjektit. Kjo analizë është kryer duke marrë në konsideratë:

Të ardhurat

- Të ardhurat nga punësimi, të dokumentuara, të subjektit dhe bashkëshortes.
- Të ardhurat nga paga e subjektit nga data e emërimit në detyrë, në vitin 1993 dhe deri në fund të periudhës së rivlerësimit, viti 2016.
- Të ardhurat nga paga e bashkëshortes duke filluar nga data e martesës datë 15.6.1997⁹⁶ dhe kursimet nga paga të akumuluar nga viti 1994 deri në datën e martesës.
- Të ardhurat e përfituara nga interesat bankare⁹⁷.
- Të ardhura të përfituara nga bashkëshortja e subjektit në vitet 2005 dhe 2013, si trashëgimtare e të dënuarit politik.
- Të ardhura nga shitja e pasurive: apartamenti në Bulqizë në vitin 2014 dhe automjeti në vitin 2015.

Nuk janë përfshirë si të ardhura të ligjshme: shuma prej 1.200 euro dhuruar nga vëllai në vitin 2005; shuma prej 21.000 USD në vitin 2008 e përfituar nga mbledhja e mineralit të kromit;

⁹⁶ Vërtetim nga OSHEE-ja; vërtetimi nga Zyra Vendore e Punësimit; vërtetim nr. *** prot., nga Zyra Vendore e Punësimit; vërtetim nr. ***, datë 27.10.2016, nga spitali Bulqizë; vërtetim nga sigurimet shoqërore Bulqizë; vërtetim nr. ***, datë 27.10.2016 si punonjëse e shoqërisë "****" sh.p.k.; vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

⁹⁷ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 7.2.2019, të "Tirana Bank", administruar në dosjen e Komisionit.

shuma 18.500 euro paguar nga vëllai I. Sh. për blerjen e pjesës takuese të apartamentit në plazh në vitin 2010.

Shpenzimet

- Shpenzimet e jetesës janë përlogaritur sipas përbërjes familjare dhe bazuar në standardin e ILDKPKI-së nga viti 2000 e në vijim⁹⁸.

Shpenzimet e jetesës janë reduktuar për shkak të përdorimit të produkteve bujqësore nga toka e subjektit për vitet 2012,2013 dhe 2014 që subjekti ka deklaruar të ardhura nga toka.

- Shpenzimet e udhëtimit janë bazuar në raportin e sistemit *TIMS* dhe sqarimeve të dhëna nga subjekti gjatë procesit të hetimit administrativ. Metodologjia e përlogaritjes së këtyre shpenzimeve është ajo e përcaktuar në vendimin (JR) nr. 11, datë 22.5.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

- Shpenzimet e shkollimit për vajzën në vitin 2016.

- Shpenzime të tjera në të cilat përfshihen shpenzime mobilimi, pagesë interesash për kredinë bankare, shpenzime për rivlerësim pasurie, depozitime të kryera nga subjekti në llogari të personave të tretë, sikurse janë evidentuar nga lëvizjet bankare dhe çdo faturë/mandat i administruar gjatë procesit të rivlerësimit.

Pasuritë

- Përfshihen të gjitha pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi dhe bashkëpronësi të subjektit dhe bashkëshortes.

- Likuiditetet trajtohen si pjesë e pasurive, në një zë të veçantë. Këtu janë përfshirë gjendjet e llogarive bankare⁹⁹ në fund të çdo viti/date të analizuar dhe gjendjet *cash* sikurse janë deklaruar nga subjekti në DPV-të dhe sqarimet e dhëna gjatë procesit të rivlerësimit.

- Ndryshimi i likuiditeteve, pakësimi ose shtesa nga viti në vit, është pasuria e krijuar nga subjekti për çdo vit.

- Vlera e çdo pasurie është marrë nga kontratat e porosive, shitblerjeve, deklaratat noteriale, si dhe çdo provë tjetër e administruar nga Komisioni, e ballafaquar me deklaratën *Vetting* dhe DPV-të.

- Shuma në fund përbën totalin e pasurisë së akumuluar nga subjekti nga fillimi i detyrës deri në fund të periudhës së vlerësimit.

Detyrimet

- Huatë e marra nga personat e tjerë të lidhur.

- Kredia e marrë nga subjekti në “Raiffesin Bank” në vitin 2016.

Vlerësim përfundimtar në lidhje me kriterin e pasurisë

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të kriterit të pasurisë u vërtetua se subjekti i rivlerësimit Bari Shyti: (i) ka kryer deklarime të pasakta e që vijnë në kundërshtim me ligjin, si dhe në disa raste janë konstatuar mospërputhje të deklarimeve gjatë procesit të rivlerësimit me DPV-të dhe

⁹⁸ Për vitet 1993 – 1999 shpenzimet e jetesës janë përlogaritur si 30% e të ardhurave familjare nga pagat; duke filluar nga viti 2000 e në vijim është konsideruar standardi i ILDKPKI-së në varësi të numrit të anëtarëve të familjes dhe pikërisht: nga 1 janar deri më 22.5.2000 për 3 persona; nga kjo datë me lindjen e djalit të subjektit e deri më 30.5.2006, për 4 persona; nga kjo datë me lindjen e djalit tjetër e deri më 31.12.2016 për 5 persona.

⁹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 4.2.2019, nga “Intesa Sanpaolo Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 31.1.2018, nga Raiffeisen Invest; shkresë nr. *** prot., datë 1.2.2019, nga “Raiffeisen Bank” sh.a.; shkresë nr. *** prot., datë 7.2.2019, nga “Tirana Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 22.2.2019, nga “Credins Bank”.

akte të administruara gjatë hetimit administrativ (germa “a”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016); (ii) ka mungesë të burimesh të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit, për shkak të balancave negative në total prej -10.299 552 lekësh (germa “b”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016); (iii) subjekti është ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit në dukje (germa “d”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016).

Për sa më sipër, Komisioni krijoi bindjen se subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet pikës 5, të nenit 33, të këtij ligji, që përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Vlerësimi nga DSIK-ja

1. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 29.1.2019, ka përcjellë raportin e Grupi i Punës me nr. *** prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Bari D. Shyti, i deklasifikuar plotësisht, nga ku rezulton se: (i) subjekti i rivlerësimit, z. Bari Shyti, ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si të deklaruara apo të paraqitura në deklaratën për kontrollin e figurës; (ii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Në konkluzion të këtij raporti, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Bari D. Shyti.

Hetimi i Komisionit

2. Pavarësisht konkluzionit të DSIK-së, Komisioni kreu hetime të pavarura në lidhje me figurën e subjektit të rivlerësimit, si vijon:

2.1. Është verifikuar pranë organeve ligjzbatuese çdo informacion i administruar për subjektin e rivlerësimit, z. Bari Shyti.

2.2. DSIK-së iu kërkua përditësimi i informacioneve për subjektin e rivlerësimit dhe në rast se kishte vend, rishikimin e raportit të kontrollit të figurës. Në përgjigje të kësaj kërkesë, DSIK-ja vuri në dispozicion¹⁰⁰ të Komisionit raportin e dytë mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Bari D. Shyti, i deklasifikuar pjesërisht me vendim nr. ***, datë 7.2.2019, të KDZh-së. Nga përmbajtja e këtij raporti, rezulton se: *“Disponohen të dhëna të vitit 2015, ku për subjektin e rivlerësimit ngrihen dyshime të arsyeshme për përfshirje në veprime korruptive në një çështje në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”*. Sipas të dhënave ngrihen dyshime të arsyeshme mbi përfshirjen në korrupsion dhe ushtrim të ndikimit të paligjshëm nga dy avokatë ndaj gjykatësit Bari Shyti, për një çështje gjyqësore, me objekt ankimin e një gjobe, vënë nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan.

¹⁰⁰ Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 11.2.2019, nga DSIK protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 11.2.2019, në dosjen e Komisionit.

mundshëm interesi, nga të cilat nuk rezultuan të dhëna¹⁰⁴ për çështje të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit me palë këta shtetas.

2.6. Në përfundim të hetimit administrativ shtesë, me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektivit iu kërkua të japë sqarime mbi konstatimin e DSIK-së, pas rishikimit të raportit të parë.

Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se informacioni i referuar më sipër nga DSIK-ja, është vënë në fokus të një hetimi disa mujor nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, në përfundim të të cilit ka rezultuar se informacioni i dhënë nuk qëndron. Për këtë arsye duke qenë se nuk u provua asnjë rrethanë paligjshmërie në rastin për të cilin dyshohej, sipas tij, konstatimi i DSIK-së për papërshtatshmërinë e tij për të vijuar detyrën e gjyqtarit nuk qëndron.

2.7. Në përfundim të procesit të rivlerësimit në lidhje me kontrollin e figurës, Komisioni nuk evidentoi elemente që cenojnë figurën e subjektivit të rivlerësimit duke vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, z. Bari Shyti, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektivit të rivlerësimit, z. Bari Shyti, bazuar në:

1. Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektivit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 25.6.2019, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 28.6.2019, nga ku rezultuan gjetjet si vijon:

1.1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Gjyqtari Bari Shyti ka njohuri në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Tri dokumentet e përzgjedhura prej tij dhe pesë dosjet gjyqësore konfirmojnë njohuritë në të drejtën administrative. Të tri dokumentet e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit nuk janë të rregullt nga pikëpamja formale, pasi nuk plotësojnë ekstremitetet e një akti zyrtar (neni 3/2 e ligjit nr. 84/2016). Në këto dokumente mungon emri i gjyqtarit apo i trupës gjyqësore dhe nënshkrimi i tyre në fund të dokumentit dhe nuk ka as njësim të këtyre dokumenteve me origjinalin.

b) Arsyetimi ligjor

Gjyqtari Bari Shyti ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara përgjithësisht janë të kuptueshme, përmbajnë pretendimet e palëve, analizën e provave dhe të ligjit, për të treguar lidhjen midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Megjithatë, në një rast është vërejtur se gjyqtari citon numrin e aktit ligjor apo nënligjor, por jo titullin e aktit dhe vitin e miratimit të tij, duke sjellë vështirësi në kuptimin e vendimit për sa i përket interpretimit të tyre në raport me aktin administrativ të marrë për shqyrtim (shihni dosjen nr. 3).

Përmbajtja e vendimit përgjithësisht është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Subjekti i rivlerësimit jo në çdo rast i kushton vëmendje arsyetimit të vendimit në rastet kur akti administrativ objekt kundërshtimi, përmban detyrim në të holla më pak se 20-fishi i pagës minimale në shkallë vendi, ndaj referuar nenit 45/a të ligjit nr. 49/2012, vendimi

¹⁰⁴ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 3.12.2020, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 7.12.2020, nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 7.12.2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, në dosjen e Komisionit.

është ligjërishit i paankimueshëm. Kështu në dosjen nr. 5 ky lloj arsyetimi mungon, ndërsa në dosjen nr. 4 arsyetohet rregullisht në këtë drejtim.

Subjekti i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, të cilat përgjithësisht citojnë dhe shkaku ligjor, duke i kushtuar kujdes edhe revokimit të vendimit për gjykimin në mungesë të palës ndërgjyqëse dhe rishpalljen e trupit gjykues për këtë palë (shihni dosjen nr. 2).

1.2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Për periudhën e rivlerësimit 15.3.2016 – 8.10.2016, rreth 7 muaj, gjyqtari Bari Shyti ka përfunduar 186 çështje gjyqësore, nga të cilat 122 çështje administrative dhe 66 marrëdhënie pune.

Në interpretim të germën “c”, të pikës 3, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari administrativ i shkallës së parë, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 150 gjykime në vit. Duke zbatuar këtë rregull, në rastin e gjyqtarit Bari Shyti duhet që për 3 vjet të ketë gjykuar 450 çështje. Konstatohet se për një periudhë 2 vjet, 4 muaj dhe 11 ditë, ka pasur ngarkesë sasiore dyfish mbi standardin minimal. Në aspektin sasior, gjyqtari i i dhomës civile të Gjykatës së Apelit ka gjykuar si relator në jo më pak se 200 çështje në vit¹⁰⁵. Duke zbatuar këtë rregull, në rastin e gjyqtarit Bari Shyti konstatohet se për një periudhë 7-mujore gjyqtari ka pasur ngarkesë sasiore mbi standardin minimal.

Konstatohet se gjyqtari Bari Shyti është eficient në kryerjen e veprimtarisë gjyqësore dhe përballimin e ngarkesës në punë, si dhe nuk ka respektuar afatin standard minimal 1-mujor të gjykimit në të pesë rastet e vëzhguara, por në këtë aspekt ka ndikuar edhe ngarkesa sasiore e lartë. Pavarësisht se gjykimet janë tej afatit 1-mujor, sipas Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve, gjyqtari ka bërë përpjekje për të përfunduar gjykimin e çështjeve brenda një afati të arsyeshëm dhe gjykimi respekton standardin e procesit të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 6 të KEDNj-së. Gjithashtu, gjyqtari Bari Shyti i ka kushtuar rëndësi kohës së arsyetimit të vendimeve gjyqësore, duke arsyetuar brenda afatit ligjor në 4 nga 5 dosjet e vëzhguara. Në asnjë rast nuk është zbatuar parashikimi ligjor për shpalljen e arsyetuar të vendimit gjyqësor, referuar neneve 42/1 dhe 55/1 të ligjit nr. 49/2012. Duket të ketë ndikuar ngarkesa e lartë sasiore e përballuar nga gjyqtari.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Gjyqtari Bari Shyti ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Përgjithësisht, gjyqtari dokumenton veprimet e kryera dhe shprehet me vendime të ndërmjetme mbi kërkesat e palëve duke ndjekur radhën e veprimeve procedurale, siç përcaktohet nga ligji, deri në shpalljen e vendimit përfundimtar.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si kërkesëpapia, procesverbali i veprimeve përgatitore, i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare, fletëthirrjet, provat etj.

¹⁰⁵ Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve nuk ka specifikim për ngarkesën sasiore të gjyqtarit të gjykatës administrative të apelit, pasi Sistemi i Vlerësimit është miratuar në vitin 2010, ndërsa kjo gjykatë është ngritur dhe funksionon sipas ligjit nr. 49/2012. Për rrjedhojë, zbatohet kriteri sasior për gjyqtarin e apelit të dhomës civile si relator.

1.3. Etika dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Bari Shyti janë paraqitur gjithsej 6 ankesa në Inspektoratin e KLD-së, nga të cilat 3 ankesa në vitin 2014, 1 ankesë e vitit 2015 dhe 1 ankesë në vitin 2016, janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor, kurse një ankesë e vitit 2015 e verifikuar për zvarritje është arkivuar, pasi pretendimi është i pabazuar. Përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

b) Integriteti

Për subjektin e rivlerësimit nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nuk është evidentuar asnjë rast i konfliktit të interesit të gjyqtarit, apo të jetë kërkuar a paraqitur dorëheqja e tij nga gjykimi i çështjes. Nga ana tjetër, nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e gjyqtarit, që lidhen me respektimin e rregullave procedurale dhe me standardin e gjykatës së paanshme.

1.4. Aftësitë personale dhe angazhimin profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Gjyqtari Bari Shyti komunikon me etikë me pjesëmarrësit në proces dhe jashtë tij, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e gjyqtarit Bari Shyti për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Nuk është evidentuar fillim me vonesë i seancave dhe as dështim i seancave të planifikuara apo vonesa në arsyetimin e vendimeve, që tregon se bashkëpunimi i tij me administratën gjyqësore dhe kolegët në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Gjyqtari Bari Shyti i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka marrë pjesë në 11 seminare, gjithsej 9 ditë, ndërsa është certifikuar në 9 seminare. Lënda e trajnimeve ku ai ka marrë pjesë ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit administrativ.

2. Informacioni i marrë nga burime të ligjshme, ku si të tilla janë konsideruar:

2.1. Informacioni i marrë nga tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, nga analiza e të cilave prej Komisionit rezultuan gjetje të evidentuara edhe nga KLGj-ja në raportin e saj.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit shtesë, subjektit iu kërkua të japë sqarime për disa problematika të evidentuara në raportin e KLGj-së që lidheshin kryesisht me: parregullsitë formale të tri dokumenteve të paraqitura nga subjekti, të cilat nuk plotësonin ekstremitetet e një akti zyrtar (neni 3/2 e ligjit nr. 84/2016), pasi në to mungonte emri i gjyqtarit apo i trupës

gjykuese, nënshkrimi i tyre në fund të dokumentit, si dhe njësimi me origjinalin; mosrespektimin e afatit standard minimal 1-mujor të gjykimit në të pesë rastet e vëzhguara; moszbatimit të parashikimit ligjor për shpalljen e arsytuar të vendimit gjyqësor, referuar neneve 42/1 dhe 55/1 të ligjit nr. 49/2012.

Në parashtrimet e tij, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë sqarime në lidhje me parregullsitë formale të dokumenteve të paraqitura prej tij. Në lidhje me konstatimin se jo në çdo rast subjekti i kushton vëmendje arsytimit të vendimit në rastet kur akti administrativ objekt kundërshtimi përmban detyrim në të holla më pak së 20-fishi i pagës minimale në shkallë vendi, ai është shprehur se është një gabim njerëzor.

Për sa i takon kohëzgjatjes së gjykimeve tej afatit standard minimal 1-mujor të gjykimit, subjekti ka sqaruar se sipas tij, afati i gjykimit në shkallë të parë nuk është i përcaktuar në ligj, pasi ligji nr. 49/2012 nuk parashikon ndonjë afat konkret nga data e regjistrimit të çështjes deri në dhënien e vendimit, por nga afatet e kryerjes së veprimeve procedurale varion nga 1.5 - 3 muaj apo më shumë dhe kjo në varësi të kompleksitetit të çështjes dhe të veprimeve përgatitore që duhet të kryhen si ekspertime, këqyrje etj. Ndërkohë, sipas tij, në shkallë të dytë afati vërtet është një muaj, por respektimi i këtij afati ka qenë i pamundur që në muajt e parë të fillimit të funksionit të gjykatave administrative, për shkak të mbingarkesës duke çuar në pamundësinë objektive të shqyrtimit të çështjeve në afatin 1-mujor.

Për sa i takon moszbatimit të parashikimit ligjor, lidhur me shpalljen e arsytuar të vendimit gjyqësor, referuar neneve 42/1 dhe 55/1 të ligjit nr. 49/2012, në parashtrimet e tij subjekti ka deklaruar se ky është një fakt i vërtetë, por ndryshe nga sa përcaktohet në ligj një gjë e tillë është objektivisht e pamundur, për shkak të ngarkesës dhe kohës në dispozicion që parashikon ligji për dhënien e vendimit, menjëherë pas mbylljes së shqyrtimit gjyqësor.

Vlerësimi i Komisionit

Referuar problematikave të evidentuara dhe sqarimeve e dhëna nga subjekti, pavarësisht se subjekti jo për të gjitha ka dhënë sqarime, Komisioni vlerëson se:

- në lidhje me parregullsitë formale të dokumenteve të paraqitura nga subjekti, si mungesa e nënshkrimit apo njësimi i tyre me origjinalin, për të cilat subjekti nuk ka dhënë sqarime, në kuptim pikës 2, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, të gjitha dokumentet e paraqitura nga subjekti në kuadër të procesit të rivlerësimit, duhet të jenë të rregullta si nga pikëpamja formale edhe ajo material, pasi janë akte mbi bazën e të cilave do të bëhet vlerësimi i aftësive profesionale. Megjithatë kjo mbetet një parregullsi e llojit formal që nuk ka pasoja në vlerësimin tërësor të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

- në lidhje me mosrespektimin e afatit standard minimal 1-mujor të gjykimit, është e vërtetë që ligji organik nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nuk përcakton ndonjë afat maksimal për gjykimin e çështjeve në shkallë të parë, kurse për gjykimin në apel parashikon afatin 30-ditor, por në nenin 3 të tij, ky ligj, sanksionon si parim të përgjithshëm gjykimin brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, çka do të thotë që gjykimi i çështjeve, pavarësisht shkaqeve, nuk mund të zgjatet në pafundësi. Pavarësisht këtij përcaktimi, duke mbajtur në konsideratë ngarkesën sasiore mbi standardin, të përballuar nga subjekti për periudhën 4.11.2013 – 15.3.2016, referuar raportit të KLGj-së, si dhe duke qenë koshientë për ngarkesën me të cilën përballlet gjykata administrative, problematika e evidentuar nuk mund të përbëjë shkak për penalizim të subjektit të rivlerësimit. Në të njëjtën linjë shkon arsytimi i Komisionit edhe sa i takon moszbatimit të parashikimit ligjor lidhur me shpalljen e arsytuar të vendimit gjyqësor. Referuar neneve 42/1 dhe 55/1 të ligjit nr. 49/2012, gjyqtari ka detyrimin e shpalljes detyrimisht të arsytuar të vendimit,

pavarësisht formës së gjykimit. Pavarësisht këtij përcaktimi, duke mbajtur në konsideratë ngarkesën e përbulluar nga subjekti i rivlerësimit për periudhën e caktuar, kjo problematikë nuk mund të përbëjë shkak për penalizim të subjektit.

2.2. Informacioni i marrë nga 20 (njëzet) denoncime nga publiku të administruara për subjektin e rivlerësimit, në 14 prej të cilëve, pretendimet e denoncuesve lidheshin me korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes dhe në këtë kuptim, bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, del jashtë tagrit të Komisionit të gjykojë mbi korrektësinë e vendimit dhe themelit të çështjes, tagra këto të cilat janë në kompetencë të një gjykate më të lartë. Ndërsa sa i takon pretendimeve për korrupsion të subjektit, të ngritura në dy denoncime, pas verifikimeve të kryera u konstatua se ato në asnjë rast nuk shoqëroheshin me prova. Ndërkohë, Komisioni thelloi hetimin administrativ për denoncimet si vijojnë:

2.2.1. Denoncim anonim në të cilin denoncuesi ngrinte pretendime se subjekti i rivlerësimit Bari Shyti : (i) ka ndërtuar një pallat banimi në Bulqizë, ***, para “Raiffeisen Bank”; (ii) ka një galeri në minierat e kromit në Bulqizë; (iii) po ndërton një hidrocentral në fshatin e tij ***, Fushë-Bulqizë, për të cilat sugjeron të shihen kronikat e televizionit të Bulqizës para 3-4 muajsh të këtij viti. Sipas tij, të gjitha këto investime subjekti i ka bërë dhe po i bën në emër të vëllait të tij I. Sh., i cili ka qenë një punëtor i thjeshtë dhe në kushte të vështira ekonomike për të bërë investime të tilla.

Nga verifikimi i këtij denoncimi, u konstatua se denoncuesi, nuk kishte bashkëngjitur dokumente shkresore apo prova që vërtetonin pretendimet e tij. Pavarësisht kësaj, gjatë hetimit administrativ, pas kërkesës së Komisionit, ASHK-ja Bulqizë¹⁰⁶ informoi se z. I. Sh. ka të regjistruara pasuritë: pasuria nr. ***, ndërtesë 4-katëshe me sip. 169 m², në bashkëpronësi me znj. Sh. H. Sh. (ndërtuar në vitin 2011 sipas lejes së ndërtimit nr. ***, datë 28.9.2011 në emër të z. I. Sh.); pasuria nr. ***, arë me sip. 1125 m², sipas AMTP-së nr. ***; pasuria nr. ***, arë me sip. 2250 m², sipas AMTP-së nr. ***; pasuria nr. ***, pemëtore+truall me sip. 1375 m², sipas AMTP-së nr. ***. Për këto pasuri, nuk u konstatuan lidhje me subjektin e rivlerësimit Bari Shyti. Po kështu, ZVRPP-ja Bulqizë¹⁰⁷ nuk informoi për pasuri të tjera të paluajtshme, përveç atyre të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit.

Në përfundim të hetimit administrativ, nuk u provuan pasuri apo lidhje me pasuri të tjera, të subjektit të rivlerësimit në qytetin e Bulqizës.

2.2.2 Denoncim nga shtetasja Dh. K.¹⁰⁸, e cila denonconte subjektin e rivlerësimit, z. Bari Shyti, duke ngritur pretendime, së pari, për zvarritje të procesit gjyqësor për çështjen e saj, e cila është regjistruar në Gjykatën e Apelit në datën 12.4.2017 dhe gjyqtari nuk ka caktuar asnjë datë për fillimin e procesit gjyqësor dhe së dyti pretendon se ka bërë kërkesë për përshejtim dhe nuk ka marrë asnjë përgjigje, por pa paraqitur dokumente bashkëngjitur denoncimit.

Gjatë hetimit administrativ, me qëllim verifikimin e pretendimeve të denoncueses, pas kërkesës së Komisionit, Gjykata Administrative të Apelit Tiranë¹⁰⁹ informoi se çështja gjyqësore me palë paditëse Dh. K. dhe palë e paditur DRSSH-ja Tiranë dhe ISS-ja Tiranë, është gjykuar në Gjykatën Administrative të Apelit me vendimin nr. ***, datë 6.12.2019 dhe pas komunikimit të vendimit të kësaj gjykate, nga ana e sekretarisë gjyqësore, dosja gjyqësore është dërguar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në datën 26.12.2019. Kjo gjykatë ka vënë në dispozicion të Komisionit : (i) kopje të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit; (ii)

¹⁰⁶ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 18.1.2021, nga ASHK-ja Bulqizë në dosjen e Komisionit.

¹⁰⁷ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 8.2.2019, nga ZVRPP-ja Bulqizë, në dosjen e Komisionit.

¹⁰⁸ Shihni denoncimin nga znj. Dh. K., protokolluar me nr. *** prot., datë 19.1.2018, të Komisionit, në dosjen e Komisionit.

¹⁰⁹ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 16.12.2020, nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, në dosjen e Komisionit.

fotokopje të fletës së regjistrit; dhe (iii) printim të procesverbalit të shqyrtimit të çështjes nga sistemi *ISMIS*.

Nga përmbajtja e këtyre dokumenteve konstatohet se çështja gjyqësore me palë paditëse denoncuesen Dh. K. është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 12.4.2017 dhe seanca gjyqësore e shqyrtimit të çështjes është zhvilluar në datën 22.10.2019. Çështja është përfunduar me vendimin nr. ***, datë 6.12.2019, nga trupi gjykues i përbërë nga Bari Shyti - kryesues dhe R. S. e A. L. - anëtarë.

Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me këtë çështje u konstatua se nga regjistrimi i çështjes në datën 12.4.2017, deri në datën e dhënies së vendimit më 6.12.2019, gjykimi ka zgjatur rreth 2.5 vjet, jashtë afatit 30-ditor të gjykimit në apel të parashikuar në nenin 48 të ligjit nr. 49.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë sqarime për kohëzgjatjen e gjykimit të kësaj çështjeje për një periudhë 2.5 vjet. Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se respektimi i afatit 1-mujor ka qenë tërësisht jashtë mundësive të gjykimit nga e gjithë trupa e gjykatës së apelit dhe, sipas tij, ky është një fakt i bërë publik edhe në media. Lidhur me rastin konkret, çështja është gjykuar jashtë radhe, duke marrë në konsideratë kërkesën e palës paditëse, por përsëri siç është konstatuar nga Komisioni, është shkelur hapur afati ligjor, madje edhe afati i arsyeshëm i elaboruar nga Gjykata Kushtetuese në disa vendime.

Për sa është parashtruar nga subjekti i rivlerësimit, vërehet se subjekti ka pranuar tejkalimin e afatit ligjor dhe tejkalimin e afatit të arsyeshëm të gjykimit, por nuk ka dhënë asnjë arsye për tejzgjatjen e këtij gjykimi.

2.2.3. Denoncim nga shtetasi V. E.¹¹⁰, i cili denonconte gjyqtarin Bari Shyti se ka dhënë një vendim të padrejtë lidhur me pronën e tij, ka marrë rryshfet nga pala tjetër, ka zvarritur procesin gjyqësor dhe se nuk ka pasur dijeni për procesin gjyqësor që po zhvillohej ndaj tij. Denoncuesi nuk ka paraqitur dokumente bashkëlidhur denoncimit.

Gjatë hetimit administrativ, me qëllim verifikimin e pretendimeve të denoncuesit, u kërkua nga Gjykata Administrative të Apelit Tiranë dosja gjyqësore, e cila informoi se¹¹¹ çështja gjyqësore me palë paditëse V. E., të paditur V. H., G. T., L. H., M. H., M. H., etj., është gjykuar në Gjykatën Administrative të Apelit me vendimin nr. ***, datë 21.11.2017, ku pas komunikimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, nga sekretaria gjyqësore, dosja gjyqësore është dërguar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës në datën 27.12.2017. Kjo gjykatë ka vënë në dispozicion të Komisionit: (i) kopje të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit; (ii) fotokopje të fletës së regjistrit; dhe (iii) printim të procesverbalit të shqyrtimit të çështjes nga sistemi *ISMIS*.

Nga përmbajtja e këtyre dokumenteve konstatohet se çështja që i përket denoncuesit V. E., është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, në datën 19.5.2015 dhe seanca gjyqësore e shqyrtimit të çështjes, është zhvilluar në datën 21.11.2017. Çështja është përfunduar me vendimin nr. ***, datë 21.11.2017, nga trupi gjykues i përbërë nga Bari Shyti - kryesues dhe L. S. e A. L. - anëtarë.

Në përfundim të hetimit administrativ u konstatua se nga regjistrimi i çështjes në datë 19.5.2015 dhe deri në datën e dhënies së vendimit 21.11.2017, gjykimi ka zgjatur rreth 2.5

¹¹⁰ Shihni denoncimin nga z. V. E., protokolluar me nr. *** prot., datë 13.12.2017, nga Komisioni, në dosjen e Komisionit.

¹¹¹ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 16.12.2020, nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, në dosjen e Komisionit.

vjet, pra, jashtë afatit 30-ditor të gjykimit në apel të parashikuar në nenin 48 të ligjit nr. 49.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë sqarime për kohëzgjatjen e gjykimit të kësaj çështjeje për një periudhë 2.5 vjet. Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se respektimi i afatit 1-mujor ka qenë tërësisht jashtë mundësive të gjykimit nga e gjithë trupa e gjykatës së apelit dhe, sipas tij, ky është një fakt i bërë publik edhe në media. Sipas tij është shkëlur hapur afati ligjor, madje edhe afati i arsyeshëm i elaboruar nga Gjykata Kushtetuese në disa vendime. Për sa është parashtruar, vërehet se subjekti ka pranuar tejkalimin e afatit ligjor dhe tejkalimin e afatit të arsyeshëm të gjykimit, por nuk ka dhënë asnjë arsye për tejkalimin e këtij gjykimi.

2.2.4. Denoncim nga shtetasi Gj. Gj.¹¹², i cili në denoncimin e tij të titulluar kërkesë ankimore “kronologji nga viti 2009 – 2019”, denoncon prokurorët dhe gjyqtarët që kanë marrë pjesë në trajtimin e çështjes së tij me objekt grabitje e pronës. Në lidhje me subjektin e rivlerësimit, z. Bari Shyti, pretendon se: së pari –me vendimin nr. *, datë 19.11.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, ky gjyqtar ka rrëzuar si të pabazuar në prova ankimin e tij; së dyti - ky gjyqtar kur kishte shkuar në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, pavarësisht se kishte dhënë dorëheqjen nga çështja, kishte nënshkruar në faqen e fundit të vendimit të kësaj gjykate lidhur me këtë çështje, konkretisht vendimin nr. ***, datë 5.5.2017. Për më tepër që gjyqtari e kishte dhënë dorëheqjen vetëm pas ankimit të denoncuesit se e kishte shqyrtuar çështjen edhe në shkallë të parë.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga denoncuesi u konstatua se me vendimin nr. ***, datë 19.11.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, gjyqtari Bari Shyti, kishte vendosur rrëzimin e padisë së ngritur nga paditësi Gj. Gj. si të pabazuar në prova. Me vendimin nr.***, datë 5.4.2017, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga R. S., A. L. dhe L. S., ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 19.11.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Në faqen e fundit të këtij vendimi u konstatua se mungonte emri i L. S. dhe në vend të saj ishte emri i Bari Shyti, por ky vendim është i panënshkruar.

Duke qenë se vendimi i vënë në dispozicion nga ana e denoncuesit ishte i panënshkruar, me kërkesë të Komisionit, u administrua nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë¹¹³, kopja e njehsuar me origjinalin e vendimit nr. ***, datë 5.4.2017. Nga verifikimi i këtij vendimi, përkundër sa pretendohet nga denoncuesi, rezultoi se ky vendim ishte i nënshkruar nga të tri anëtarët e trupës gjykues A. L., L. S. dhe R. S. dhe jo nga subjekti Bari Shyti. Në këto kushte, u konstatua se pretendimi i denoncuesit nuk qëndronte.

2.3. Pas informacionit të marrë në rrugë ligjore, Komisioni administroi nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës¹¹⁴ dosjen gjyqësore nr.*, përfunduar me vendimin e datës 10.2.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës me palë ndërgjyqëse shoqërinë “****” sh.p.k. (paditës) dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Elbasan (të paditur), mbyllur me vendimin nr. ***, datë 21.9.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit, nga aktet e së cilës u konstatua se:**

¹¹² Shihni kërkesën ankimore nga shtetasi Gj. Gj. protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 6.2.2019, në dosjen e Komisionit.

¹¹³ Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 4.12.2020, nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, në dosjen e Komisionit.

¹¹⁴ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 20.1.2021, dhe dosjen bashkëngjitur nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, në dosjen e Komisionit.

2.3.1. Shqyrtimi administrativ i çështjes:

a. Me aktin “njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore” nr. *** prot., datë 18.11.2014, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan, i janë njoftuar shtetasit A. D. detyrimet e papaguara dhe penalitetet, bazuar në të dhënat e raportit të kontrollit të ushtruar nga kjo drejtori në shoqërinë “****” sh.p.k., në vlerën 7.194.091 lekë.

b. Pas njoftimit të këtij akti në datën 12.12.2014, shoqëria “****” sh.p.k., ushtroi të drejtën e ankimit administrativ pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë (protokolluar me nr. *** prot., datë 15.12.2014, nga kjo drejtori), duke kërkuar shpalljen absolutisht të pavlefshëm të njoftim vlerësimit tatimor nr. ***.

c. Ndërkohë, Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 26.12.2014, “Urdhër bllokimi i llogarive bankare”, i është drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë që të bllokojnë të gjitha llogaritë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k.

ç. Me vendimin nr. *** prot., datë 22.1.2015, Drejtoria e Apelimit Tatimor Tiranë, ka vendosur refuzimin e ankimit administrativ, për anulimin e detyrimeve të përcaktuara në aktin administrativ “njoftim vlerësimi nr. *** prot., datë 18.11.2014”, të nxjerrë nga DRT-ja Elbasan, pasi subjekti nuk ka paguar dhe nuk ka lënë garanci bankare për aktin administrativ objekt ankimi.

2.3.2. Shqyrtimi gjyqësor i çështjes

a. Me kërkesëpadinë, datë 13.1.2015, përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, shoqëria “****” sh.p.k., përfaqësuar nga avokat A. K.¹¹⁵ ka paditur Drejtorinë Rajonale Tatimore Elbasan, duke kërkuar: (i) marrjen e masës së sigurimit të padisë “pezullimin e zbatimit të aktit administrativ, “njoftim vlerësimi tatimor nr. *** prot., datë 18.11.2014”, duke pezulluar ekzekutimin dhe të gjitha procedurat administrative në lidhje me këtë akt deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes” ; (ii) shpalljen absolutisht të pavlefshëm të aktit administrativ “njoftim vlerësimit tatimor nr. *** prot., datë 18.11.2014”, të DRT-së Elbasan dhe të gjitha akteve të tjera të mëvonshme të nxjerra në zbatim të tij. Nga shoqëria “****” sh.p.k. është paraqitur si provë, ndër të tjerash, edhe ankimi i datës 18.11.2014 paraqitur pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë.

b. Çështja është regjistruar në gjykatë në datën 13.1.2013 dhe me shortin e datës 14.1.2015 i ka kaluar për shqyrtim gjyqtarit Bari Shyti, i cili ka zhvilluar katër seanca gjyqësore, përkatësisht në datat 16.1.2015, 20.1.2015, 4.2.2015 dhe 10.2.2015.

c. Kundër vendimit nr. ***, datë 10.2.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, paraqitën ankim pala e paditur DRT-ja Elbasan dhe Avokatura e Shtetit dhe me vendimin nr. ***, datë 21.9.2017, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, vendosi ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 10.2.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe rrëzimin e kërkesëpadisë. Në vendimin e saj kjo gjykatë ka vlerësuar se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, është marrë në zbatim të gabuar të ligjit dhe se nuk ka elementë të pavlefshmërisë absolute, të akteve objekt gjykimi.

2.3.3. Nga analiza e akteve të mësipërme rezultoi se:

a. Në datën 12.12.2014, shoqëria “****” sh.p.k., ushtroi të drejtën e ankimit administrativ pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë, ndaj aktit administrativ “njoftim vlerësimit tatimor nr.

¹¹⁵ Sipas autorizimit të datës 0.1.2015, shoqëria “****” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori A. D., ka emëruar përfaqësues të posaçëm av. E. P. dhe av. A. K..

*** prot., datë 18.11.2014”, të DRT-së Elbasan, sipas nenit 106¹¹⁶ të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b. Pa u shprehur ende me vendim Drejtoria e Apelit Tatimor¹¹⁷, në datën 13.1.2015, shoqëria “***” sh.p.k., ka depozituar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës kërkesëpadi me objekt marrjen e masës për sigurimin e padisë dhe shpalljen e pavlefshmërisë së aktit administrativ.

c. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, pasi u njoh me provat e paraqitura nga paditësi, ndër të cilat edhe me ankimin administrativ pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë, por pa një vendim nga kjo e fundit, mori në shqyrtim kërkesëpadinë e datës 13.1.2015 të shoqërisë “***” sh.p.k., e cila kishte kërkuar edhe marrjen e masës së sigurimit të padisë. Pasi shqyrtoi kërkesën për sigurim padie sipas nenit 28 “sigurimi i padisë”, të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative...”, me vendimin e datës 20.1.2015, e pranoi atë dhe pasi kreu veprime përgatitore urdhëroi kalimin e çështjes në seancë gjyqësore.

ç. Në datën 22.1.2015, Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë, me vendimin nr. *** prot., vendosi refuzimin e ankimit administrativ për anulimin e detyrimeve të përcaktuara në aktin administrativ “njoftim vlerësimi nr. *** prot., datë 18.11.2014”, të nxjerrë nga DRT Elbasan. (ky vendim nuk gjendet i administruar në dosjen gjyqësore).

d. Seanca gjyqësore e radhës është zhvilluar në datën 4.2.2015, në të cilën nuk konstatohet të jetë administruar si provë ky vendim. Ndërsa, në datën 10.2.2015 gjykata vendosi: (i) pranimin e padisë së ngritur nga paditësi shoqëria “***” sh.p.k.; (ii) shpalljen absolutisht të pavlefshëm të aktit administrativ njoftim vlerësimi tatimor nr. *** prot., datë 18.11.2014, të DRT-së Elbasan; si dhe (iii) ligjërimin e masës së sigurimit të padisë.

2.3.4. Konstatime në përfundim të hetimit administrativ

Duket se subjekti i rivlerësimit, si gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, në shqyrtimin e kërkesëpadisë mbi pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ të DRT-së Elbasan, ka qenë në kushtet e mungesës së juridiksionit, pasi nuk është shteruar më parë ankimi administrativ, sipas parashikimit të nenit 16 të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, sipas të cilit: “1. *Padia ndaj veprimit administrativ mund të ngrihet vetëm pas shterimit të ankimit administrativ*”.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim.

Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se referuar neneve 9 dhe 16, të ligjit nr. 49/2012, gjykata administrative investohet në shqyrtimin e një kërkesë padie administrative vetëm kur pala që pretendon se është cenuar në të drejtat apo në interes të saj nga akti apo veprimi administrativ, ka shteruar të gjitha mjetet e ankimit administrativ, përveç kur ligji nuk parashikon mundësinë e kontrollit të brendshëm të veprimit apo aktit administrativ ose kur ligji parashikon të drejtën e ankimit drejtpërdrejt në gjykatë. Sipas tij, rasti i kundërshtimit të akteve që kanë të bëjnë me detyrimet fiskale (tatimore apo doganore), është rasti tipik, ku ligji ka

¹¹⁶ 3. Tatimpaguesi e dorëzon ankimin në drejtorinë e apelit tatimor brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur vlerësimi ose vendimi i administratës tatimore është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpaguesi.

¹¹⁷ 2. Tatimpaguesi mund ta kundërshtojë vendimin e drejtorisë së apelit tatimor ose Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore në gjykatë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni për këtë vendim. Nëse drejtoria e apelit tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore nuk shprehet brenda 60 ditëve nga data e marrjes së ankimit, tatimpaguesi mund të ankohet drejtpërdrejt në gjykatë. 3. Vendimi i Drejtorisë së Apelit Tatimor ose i Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore është i detyrueshëm për zbatim nga organi i administratës tatimore që ka bërë vlerësimin tatimor dhe nuk apelohej prej tij.

përcaktuar mundësinë e ankimit administrativ para se subjektet t'i drejtohen juridiksionit gjyqësor.

Subjekti ka sqaruar se në fushën e tatimeve dhe doganave, ka një praktikë të bollshme gjyqësore ku gjykatat kanë mbajtur në mënyrë këmbëngulëse qëndrimin që, kur pretendohet pavlefshmëria absolute e një akti që përmban detyrime tatimore apo doganore, shterimi i ankimit administrativ nuk është kusht pa të cilin palët nuk mund ti drejtohen autoritetit gjyqësor, duke sjellë në vëmendje të Komisionit raste nga praktika e Gjykatës së Lartë, konkretisht: vendimin nr. ***; vendimin nr. ***, ku Kolegji Administrativ ka mbajtur qëndrimin se shterimi i ankimit administrativ nuk është kusht për t'iu drejtuar gjykatës.

Nga përmbajtja e vendimeve të Gjykatës së Lartë, të referuara nga subjekti konstatohet se:

a. Në vendimin nr. ***, datë 10.5.2017, të çështjes që iu përket palëve: paditës – shoqëria “****” sh.p.k.; e paditur – Dega e Doganës Durrës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Tiranë, me objekt “konstatimin e pavlefshmërisë së vendimit nr. ***, datë 19.3.2015, si dhe aktet administrative që rrjedhin nga ky vendim ...”, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se: “... kolegji vlerëson për rastet kur pretendohet për pavlefshmëri absolute të aktit administrativ, çdo person i interesuar ka të drejtë t'i drejtohet drejtpërsëdrejti gjykatës. Këtë gjë mund ta bëjë edhe organi që ka nxjerrë aktin me nismën e tij pa ia kërkuar askush, mjafton që ta konstatojë pavlefshmërinë e aktit. Por kjo nuk pengon personin e interesuar t'i drejtohet gjykatës për konstatimin e pavlefshmërisë së aktit administrativ. Një akt absolutisht i pavlefshëm nuk ka fuqi detyruese ndaj subjektit që i drejtohet.

Gjykata që shqyrton çështjen nuk i hyn shqyrtimit të themelit të vendimmarrjes administrative, por shqyrton vetëm shkaqet e pavlefshmërisë absolute që mund të jenë: nxjerrja e aktit 'kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar, kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore, apo kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji' (neni 116 i Kodit të Procedurave Administrative)”.

b. Në vendimin nr. ***, datë 21.11.2013, të çështjes që iu përket palëve: paditës – shoqëria “****” sh.a.; të paditur – Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, Drejtoria e Apelimit Tatimor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me objekt “konstatimi i pavlefshmërisë absolute të një pjese të Njoftim Vlerësimit Tatimor nr. ***, datë 23.2.2012, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, sa i takon zërave TVSH (1.2.3), respektivisht të viteve 2008, 2009 dhe 2011. Për të njëjtat zëra, konstatimi i pavlefshmërisë absolute pjesërisht edhe të vendimit nr. ***, datë 15.6.2012, të Drejtorisë së Apelimit Tatimor; konstatimi i pavlefshmërisë absolute të Njoftim Vlerësimit Tatimor nr. ***, datë 23.2.2012, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, për sa i përket zërit tatimfitimi (4), siç pasqyrohet në tabelën e Njoftim Vlerësimit Tatimor”;

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se: “... Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se është vendi të ritheksojë qëndrimin tashmë të konsoliduar në praktikën gjyqësore se, nëse kërkohet direkt në gjykatë nuliteti i aktit administrativ të nxjerrë nga organi tatimor që ngarkon subjektin tatimpagues me detyrime tatimore, gjykata e mban çështjen në juridiksionin e saj gjyqësor, ndërkohë që objekt i gjykimit të çështjes nga gjykata janë dhe duhet të mbeten rigorozisht vetëm vërtetimi ose jo i njërit prej shkaqeve të parashikuara shprehimisht nga ligji për pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ, si p.sh, ato të nenit 116 të Kodit të Procedurës Civile, në lidhje edhe me respektimin ose jo nga organi administrativ të kompetencave, kushtet e procedurat që parashikohen nga ligjet e posaçme për nxjerrjen e aktit administrativ që kundërshtohet direkt në gjykatë, p.sh. nenet 106 dhe 107, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Në konkluzion, sqarimet e subjekti të rivlerësimit, vlerësohen bindëse nga Komisioni dhe të mbështetura në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë referuar më sipër, e cila ka mbajtur një qëndrim të konsoliduar, që nëse kërkohet direkt në gjykatë nuliteti i aktit administrativ të nxjerrë nga organi tatimor që ngarkon subjektin tatimpagues me detyrime tatimore, gjykata e mban çështjen në juridiksionin e saj gjyqësor, ndërkohë që, objekt i gjykimit të çështjes nga gjykata janë dhe duhet të mbeten rigorozisht vetëm vërtetimi ose jo i njërit prej shkaqeve të parashikuara shprehimisht nga ligji për pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ.

Sa i takon vendimmarrjes së subjektit Bari Shyti mbi pranimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë, apo shpalljen e pavlefshmërisë absolute të aktit, e cila është bërë objekt gjykimi nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë duke u ndryshuar prej saj, Komisioni, duke mbajtur në konsideratë (i) vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit¹¹⁸, në të cilin orientohet që gjykimi apo vlerësimi mbi zgjidhjen e një çështjeje gjyqësore nga ana e subjekteve nuk mund të jetë një alternativë vlerësimi e përdorur prej organeve të rivlerësimit, për sa kohë që ky vendim lidhet me vlerësimin e çmimit e provave dhe mbështetet mbi bindjen e brendshme të magjistratit, si dhe, (ii) referuar pikës 4, të nenit 72 të ligjit nr.96/2016, çmon se në rastin konkret, një vlerësim i tillë nuk është i një natyre procedurale por lidhet me themelin e çështjes dhe si e tillë është jashtë tagrit të vlerësimit të tij.

2.4. Informacioni i marrë nga burimet arkivore të KLGj-së, ku sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Bari Shyti janë paraqitur gjithësej 6 ankesa në Inspektoratin e KLD-së (3 ankesa në vitin 2014, 2 ankesa në vitin 2015 dhe 1 ankesë në vitin 2016), të cilat janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor, me përjashtim të një ankesë të vitit 2015, e cila pasi është verifikuar për zvarritje është arkivuar, pasi pretendimi është i pabazuar.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Bari Shyti përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

2.5. Pas riçeljes së hetimit administrativ, Komisioni kreu verifikime në drejtim të evidentimit të ndonjë rasti konflikti të mundshëm interesi, duke kërkuar nga gjykatat ku subjekti ka ushtruar detyrën informacione për çështje të shqyrtuara prej tij, me palë pjesëmarrëse shtetasit me të cilët ka qenë në marrëdhënie juridiko-civile, apo shtetasit me të cilat ka udhëtuar referuar të dhënave të sistemit *TIMS*.

2.5.1. Nga verifikimi i informacionit të vënë në dispozicion nga Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë¹¹⁹, u konstatua se subjekti ka qenë pjesë përbërëse e trupës gjykuese që ka shqyrtuar të tria çështje civile, ku palë pjesëmarrëse ka qenë shoqëria “***” sh.p.k., pranë së cilës subjekti ka porositur në vitin 2010 një apartament banimi në Tiranë në rrugën “J. M.” dhe,

¹¹⁸ Shihni vendimin nr. 28, datë 23.10.2020, të KPA-së, për subjektin F. V.: *Kolegji çmon se gjykimi apo vlerësimi mbi zgjidhjen e një çështjeje gjyqësore nuk mund të jetë një alternativë vlerësimi e përdorur prej organeve të rivlerësimit, për sa kohë që ky lidhet me vlerësimin e çmimit e provave dhe mbështetet mbi bindjen e brendshme të magjistratit. Në rastin konkret, pikërisht vlerësimi i aftësive profesionale të magjistratit, duke gjykuar e vlerësuar logjikën apo bindjen e tij të brendshme të formuar e shpalosur si pjesë e vendimmarrjes në trupën gjykuese përkatëse, duke arsyetuar mbi provat e të gjitha rrethanat e çështjes së gjykuar, del jashtë misionit dhe kompetencës ligjore të organeve të rivlerësimit, prandaj edhe Kolegji vlerëson se konkluzioni se subjekti ka dhënë një zgjidhje të gabuar, duke deklaruar pafajësinë e njërit prej të gjykuarve, është një konkluzion në tejkalim të kompetencës kushtetuese të organeve të rivlerësimit dhe, si i tillë, nuk mund të përdoret për të kryer vlerësimin e tij.*

¹¹⁹ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 7.12.2020, nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, në dosjen e Komisionit.

më pas, e ka blerë më 2.9.2015. Konkretisht, subjekti ka marrë pjesë në gjykimin e çështjeve si vijojnë:

a) Çështja civile nr. *** akti, datë 21.1.2019, me palë paditëse A. T., N. T. dhe shoqëria “***” sh.p.k., i paditur Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Tirana Rurale, ZVRPP-ja Tiranë, me objekt “anulim/shfuqizim i urdhrit të anulim/shfuqizimit nr. ***, datë 10.2.2017, të Drejtorisë së ALUIZNI-t Tirana Rurale”, përfunduar me vendimin nr. ***, datë 5.3.2019, në Gjykatën Administrative të Apelit. Nga përmbajtja e vendimit konstatohet se kjo çështje është shqyrtuar nga trupa gjykuese e përbërë nga Bari Shyti - kryesues, A. G. anëtare dhe A. L. - anëtarë. Në përfundim, kjo gjykatë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 29.10.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

b) Çështja civile nr. *** akti, datë 15.3.2018, me palë paditëse 27 banorë të Njesisë Administrative M. dhe shoqata “***”, i paditur KRT-ja Tiranë (Agjencia e Zhvillimit të Territorit si Sekretariat i KKT-së), person i tretë shoqëria “***” sh.p.k., shoqëria “***” sh.p.k., dhe Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës, me objekt “shfuqizimi i vendimit të këshillit Kombëtar të Territorit nr. ***, datë 10.11.2017, “Për miratimin e shtyrjes së afatit të lejes së ndërtimit nr. ***, datë 8.9.2016”, përfunduar me vendimin për sigurimin e padisë nr. ***, datë 6.6.2018, në Gjykatën Administrative të Apelit. Nga përmbajtja e këtij vendimi, konstatohet se kjo çështje është shqyrtuar nga trupa gjykuese e përbërë nga R. S. - kryesuese dhe A. L. dhe Bari Shyti - anëtarë. Në përfundim, kjo gjykatë ka vendosur “ndryshimin e vendimit nr. *** akti, datë 31.1.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, pranimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë duke urdhëruar pezullimin e punimeve në zbatim të aktit administrativ, vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. ***, datë 10.11.2017, “Për miratimin e shtyrjes së afatit të lejes së ndërtimit për objektin ndërtim i Hidrocentralit D., Komuna M., Qarku Kukës”, deri në përfundimin e gjykimit të çështjes.

c) Çështja civile nr. *** akti, datë 18.6.2015, me palë paditëse P. Ç., i paditur Autoriteti Rrugor Shqiptar, person i tretë shoqëria “***” sh.p.k., me objekt “detyrimi për të më shpronësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë për sipërfaqen e pronës së marrë për ndërtimin e rrugës publike “Unaza lindore Tiranë” që është 2.100 m², përfunduar me vendimin “mbi shqyrtimin e ankimit për sigurimin e padisë” nr. ***, datë 5.9.2016, në Gjykatën Administrative të Apelit”.

Nga përmbajtja e këtij vendimi konstatohet se kjo çështje është shqyrtuar nga trupa gjykuese e përbërë nga A. L. - kryesues dhe Bari Shyti e L. S. - anëtarë. Në përfundim, kjo gjykatë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. *** akti, datë 18.5.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila kishte vendosur refuzimin e kërkesës së palës paditëse, lidhur me marrjen e masës së sigurimit të padisë duke marrë masën “për pezullimin e kontratës nr. ***, datë 3.6.2013, në objektin Unaza lindore Tiranë, Loti ***, segmenti i rrugës Sauk-TEG”, deri në marrjen e shpronësimit.

2.5.2 Bazuar në sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ shtesë, u konstatua se:

a. Subjekti i rivlerësimit ka pasur marrëdhënie të drejtpërdrejt juridiko-civile me shoqërinë “***” sh.p.k., për shkak të lidhjes së kontratës së porosisë në vitin 2010 dhe kontratës së shitjes në vitin 2015, ndërkohë që ka marrë pjesë në gjykimin e të tria çështjeve ku palë pjesëmarrëse ka qenë kjo shoqëri, që i përkasin viteve 2015, 2018 dhe 2019.

b. Në gjykimin e çështjes që i përket vitit 2015, deri në datën e dhënies së vendimit më 5.9.2016, subjekti ka qenë në një maredhenie juridike-civile të papërfunduar me shoqërinë “***” sh.p.k., marrëdhënie e cila kishte filluar nga viti 2010 dhe përfundoi në datën 2.9.2015, kur është lidhur kontrata e shitjes për apartamentin në rrugën “J. M.”, Tiranë.

c. Duket se subjekti me shqyrtimin e të tria çështjeve civile ku palë në proces ka qenë shoqëria “***” sh.p.k., është në kushtet e konfliktit të interesit në dukje, sipas parashikimit të gurmës

“b”, të pikës 4, të nenit 3, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publikë”.

2.5.3 Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84.2016, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim, i cili në parashtrimet e tij të datës 16.3.2021, sqaroi se në vitin 2015 me nënshkrimin e kontratës së shitjes dhe regjistrimit të pasurisë në emrin e tij, marrëdhënia juridike mes tij dhe shoqërisë “****” sh.p.k. ka përfunduar dhe, për këtë arsye, nuk e ka vlerësuar të arsyeshme të dorëhiqet nga çështjet, ku ky subjekt ka qenë palë, duke mos e konsideruar ekzistencën disa vite më parë të një raporti juridik ndërmjet tyre, si shkak për heqje dorë nga ato që përcakton neni 72 i Kodit të Procedurës Civile. Për më tepër, çmimi i apartamentit është vendosur sipas çmimeve të tregut, i cili është dukshëm më i lartë se çmimi i referencës.

Në konkluzion, subjekti deklaroi se nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit në kohën kur ka gjykuar çështje ku palë ka qenë shoqëria “****” sh.p.k. Ndërsa, në seancë dëgjimore, subjekti pretendoi se ishte emëruar gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit në mars të vitit 2016.

2.5.4 Vlerësimi i Komisionit

Për sa u parashtrua nga subjekti në seancë dëgjimore, se është emëruar gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit në mars të vitit 2016, referuar raportit të rivlerësimit profesional në pjesën “karriera në 10 vitet e fundit”, ky pretendim qëndron, pasi z. Bari Shyti është emëruar gjyqtar në këtë gjykatë në datën 15.3.2016. Ndërkohë, çështja që i përket vitit 2015 është regjistruar në gjykatë në datën 18.6.2015, ndërsa vendimi i dhënë nga trupa gjyquese ku subjekti Bari Shyti ka qenë anëtar i përket datës 5.9.2016. Duke qene se kontrata e shitjes së apartamentit është e datës 2.9.2016, është e vërtete se marrëdhënia mes tij dhe shoqërisë “****” sh.p.k., në momentin e dhënies së vendimit kishte përfunduar.

Pavarësisht faktit se marrëdhënia juridiko-civile mes tij dhe shoqërisë “****” sh.p.k., në kohën e trajtimit të tri çështjeve civile kishte përfunduar, Komisioni vlerëson se për të shmangur çdo lloj dyshimi për njëanshmëri në gjykim, si dhe për të shmangur çdo situatë konflikti në dukje të interesit, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte operuar me dorëheqje nga gjykimi i çështjeve.

Në vlerësimin e tij, Komisioni i është referuar ligjit nr. ***, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publikë”, sipas të cilit një zyrtar në ushtrimin e funksioneve të tij, me qëllim për të garantuar një vendimmarrje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publikë, duhet të parandalojë konfliktin midis interesave publikë dhe interesave private. Po kështu, ky ligj në pikën 4, të nenit 3 të tij, përkufizon konfliktin në dukje të interesit: “... konflikt në dukje i interesit është gjendja, në të cilën interesat private të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësisive të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë”.

Siç vërehet, kjo dispozitë nuk kërkon (përkundrazi e përjashton në pjesën e saj të fundit) prezencën e konfliktit apo të dyshimeve mbi ndonjë ndikim, vendimit të mundshëm të padrejtë apo paanësi, por mjaftohet vetëm me “efektin – pasojë” të perceptimit nga jashtë, se një rrethanë e caktuar mund të ndikojë tek vendimmarrësi. Në rastin konkret, Komisioni çmoi se ekzistojnë disa rrethana që të para së bashku, në kombinimin e tyre, mund të çojnë në një perceptim të ekzistencës në dukje të konfliktit të interesit, edhe pse ndikimi të vendimmarrësi mund të mos ndodhë. Thënë ndryshe, mungesa e gjendjes së konfliktit të interesit faktik apo atij të mundshëm, nuk e përjashton prezencën e konfliktit në dukje të interesit, i cili rrjedh nga

perceptimi i të tretëve mbi rrethana të caktuara dhe jo nga qëndrimi i funksionarit (në këtë rasti subjektit).

Më tej, në nenin 37 të tij, ligji përcakton mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesit duke parashikuar shprehimisht veprimet që zyrtarit për “Për parandalimin sa më të hershëm dhe sa më efikas të çdo konflikti interesi, të çdolloji qoftë ai”. Nga ana tjetër në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile përcaktohen rastet se kur gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete, ku ndër të tjerash, pika 6 parashikon: “ ... në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie”.

Në përfundim, bazuar në të gjitha dispozitat e mësipërme ligjore, Komisioni vlerësoi se gjatë ushtrimit të funksionit si gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e “konfliktit në dukje të interesit” gjatë shqyrtimit dhe vendimmarrjes në çështjet ku palë pjesëmarrëse në gjykim ka qenë shoqëria “***” sh.p.k., konflikt për të cilin nuk u vërtetua të ketë ndërmarrë ndonjë veprim për mënjanimin e tij.

3. Rivlerësimi profesional, sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Gjatë të procesit të vendimmarrjes, për sa i takon problematikës së evidentuar në drejtim të konfliktit të interesit, referuar të gjitha fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe në respektim të parimit të proporcionalitetit, Komisioni vlerësoi që kjo nuk përbën shkak për cenim të aftësive profesionale të subjektit lidhur me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale. Po kështu, për sa i takon problematikave në drejtim të tejkalimit të afatit standard 1-mujor të gjykimit, të evidentuara nga KLGj-ja në dosjet e hedhura me short, si dhe dy çështjet e referuara nga denoncimet e publikut, duke mbajtur në konsideratë faktin se ligji nr. 49/2012 nuk sanksionon ndonjë afat maksimal për shqyrtimin e çështjeve, ngarkesën e subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës së rivlerësimit, si dhe ngarkesën me të cilën përballen gjykatat administrative, Komisioni vlerësoi se subjekti nuk ndodhet në asnjërin prej kushteve të parashikuara në nenin E të Aneksit të Kushtetues dhe, për rrjedhojë, këto problematika nuk mund të përbëjnë shkak për penalizim të tij, sipas kësaj dispozite ligjore.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, sipas kriterëve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit:

- ka treguar aftësi profesionale sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016;
- ka treguar aftësi organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016;
- nuk ka treguar plotësisht etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, parashikuar nga neni 75 i ligjit nr. 96/2016, pasi është gjendur në kushte të konfliktit të interesit, për shkak të gjykimit të çështjeve civile me palë pjesëmarrëse në proces, shoqërinë “***” sh.p.k; si dhe
- ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional, sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.

Bazuar në të gjitha sa më sipër është arsyetuar, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin minimal kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

III. SEANCA DËGJIMORE

Në datën 23.3.2021, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Bari Shyti, në përfundim të së cilës, subjekti kërkoi konfirmimin në detyrë.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin e tij, duke dhënë sqarime të mëtijshme mbi rezultatet e hetimit administrativ, procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, si dhe duke iu përgjigjur pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e trupit gjykues.

Në datën 25.3.2021 u zhvillua seanca, në të cilën Komisioni shpalli vendimin për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Bari Shyti.

IV. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016.

Në komunikimet e tij subjekti është treguar bashkëpunues, por jo në çdo rast i gatshëm për tu përgjigjur brenda afateve të përcaktuara, ndërkohë që gjuha e përdorur prej tij, në ndonjë rast ka qenë me nota ironie dhe jo tërësisht e përshtatshme për një komunikim zyrtar, qëndrim i cili është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

V. KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjatë bisedimeve për vlerësimin përfundimtar të çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe në qëndrimin e subjektit të rivlerësimit për çdo çështje, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Bari Shyti, ka kryer deklaratime të pasakta dhe të pamjaftueshme për kriterin e pasurisë sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Vendimmarrja për këtë subjekt u vlerësua të bazohet vetëm në përfundimet e arritura në lidhje me kriterin e pasurisë, si dhe në vlerësimin tërësor të rrethanave, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2014.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mblodh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germenin “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Bari Shyti, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 25.3.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta Tafa (BUNGO)
Kryesuese

Firdes SHULI
Relatore

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Orianda Liçi